

BIBLIOTEKA
SHTETIT

EURIPIDI




DRAMA
ANDROMAKA
IFIGJENIA
NE TAURIDE

877.0-2

844-2
Eur

EURIPIDI



ANDROMAKA IFIGJENIA NË TAURIDË Drama


28920



I përktheu nga origjinali Sotir Papahristo

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Titulli i origjinalit:
Andromake
Ifigeneia he en Taurois



ANDROMAKA
IFIQEÑIA
NE TAURIDE
Drama

Originalna dramska predstava u dva čina sa muzičkim dopunjima po tekstu G. R. Diderota

Tirazhi 4000 kopje

Format 70 x 100/32

Stash: 2204-72

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re
TIRANË, 1977

PARATHENIE

Euripidi — i sprasmi poet tragjik i botës antike greke — jetoi në vitet 480-406 para erës sonë, në kohën kur shteti skllavopronar i Athinës njoihu, nga njëra anë, lulëzimin e vet më të madh e, nga ana tjetër, nisi të goiditej nga një krizë e thellë ekonomike, politike e shoqërore, që e çoi dalngadalë në rënien e dekompozim.

Vepra e Euripidit e pasqyrojnë nga disa anë këtë epokë kontradiktore e tranzitore, kur shoqërinë greke e brenin përbrënda kontradikta të mprehta, të cilat jo vetëm që nuk u kapërcyen me Luftën e Peloponezit (431-404), por u thelluan më tej me shkatërrimet që solli kjo lufstë e me varfërimin e mëtejshëm të masave të gjëra të punonjësve. Për pasojë, ndryshe nga Sofokliu, që ishte poeti i lulëzimit të demokracisë, skllavopronare të Athinës, Euripidi u bë poeti i krizës së këtij rendi; në vepren e tij gjetën pasqyrim idetë e reja të kohës që lidhen me ndryshimet që ndodhën në jetën ekonomike e shoqërore të polosit grek e që u zhvilluan në lufstë me shumë koncepte e ide tradicionale. Duke bashkuar në vetvete poetin dhe mendimtarin, Euripidi shtroi në vepren e tij, që u bë një farë enciklopedie e lëvizjes mendore të Greqisë në gjysmën e dytë të shek. V, shumë nga problemet e jetës sociale dhe politike të kohës, për të cilat ai dha një përgjigje që, sidoqoftë, e vë në një ra-

dhë më të përparuar se paraardhësit e tij. Kjo i dha kritikës antike të drejtën ta quajë Euripidin «filozof në skenë».

Problemi i qëndrimit ndaj ideologjisë tradicionale të polosit grek, ndaj mitologjisë dhe fesë tradicionale, ndaj demokracisë athinjote dhe të drejtave të njeriut, ndaj skllavërisë dhe lustëravë, problemi i pozitës së gruas dhe i familjes etj., në veprën e Euripidit, edhe kur nuk u zgjidhën nga pozitat më të përparuara, për shkak të mungesës së një botëkuptimi konsekuent e të kufizimeve që i vinte koha, u shtruan me një synim kritik. Në këtë synim qëndron ana e fortë e veprës së Euripidit. Ai shpesh kundërvë pikëpamje të kundërtat pa arritur të po-hojë vetë. E megjithatë, qoftë dhe duke vënë në diskutim a në pikëpyetje ide a koncepte të sistemeve ideologjike tradicionale, ai i hapte udhë një mendimi më të përparuar.

Këto probleme e këto kufizime shtrojnë e mbartin edhe tragedinë «Andromaka» e «Ifigjenia në Tauridë», që po i vihen sot në dorë lexuesit tonë. Këto dy vepra, të marra në vetvete si pjesë e atij krijimi klasik, që, siç shprehet Marks, vazhdon të na japë ende kënaqësi estetike, paraqesin për lexuesin e sotëm interes jo vetëm për nga forma artistike apo thjesht njohës, por dhe për nga idetë që mbartin, me gjithë kufizimet e kuptueshme historike, si pjellë e një epoke, kur njerëzimi ishte ende në foshnjérinë e tij.

Si gjithë autorët e antikititetit, Euripidi u nis në veprat e tij nga subjekte e figura të mitologjisë, që, si dihet, ka formuar jo vëtëm arsenalin, por edhe truallin e artit klasik grek. Përfytyrimet mitologjike për natyrën dhe shoqërinë i përgjigjeshin asaj shkalle të pazhvilluar të shoqërisë, kushteve shoqërore të papjekura, në të ci-

lat, siç shkruan Marksit, lindi arti grek. Do të shkonin shekuj që mendimi njerëzor të emancipohej nga çdo mitologjizim i natyrës e i shoqërisë e që mendimi e fantazia artistike të bëheshin të pavarura prej mitologjisë.

Për pasojë, edhe në këto dy tragedji të Euripidit nuk mund të mos trashëgohen po ato koncepte e figura që burojnë nga trualli mitologjik mbi të cilin ato janë ngritur. Por duhet thënë se Euripidi, ndryshtë nga poetë të tjera të kohës, duke i bërë jehonë në veprën e tij luftës shoqërore, politike e mendore që ziente në gjirin e shoqërisë athinjote në periudhën e krizës së shtetit të demokracisë skllavopronare, i aktualizoi shumë figurat mitologjike dhe i zbriti heronjtë mitologjikë e vetë perënditë në nivelin e njerëzve të zakonshëm, i paraqiti si bartës mendimesh e ndjenjash njerëzore. Nga kjo pikëpamje, vepra e Euripidit ishte për kohën një fenomen progresiv, që u prit ftohtë nga rrethet konservatore të shoqërisë athinjote. Ajo qëndron më afër kohëve të reja se sa shumë vepra të tjera të antikitetit grek edhe për qëndrimin ndaj perëndive. Qëndrimi kritik ndaj mitit e çoi Euripidin në një qëndrim kritik edhe ndaj idesë së plotfuqishmërisë së perëndive, bile edhe të ekzistencës së tyre, siç del qartë në tragedinë «Belerofonti», ku thuhet:

Thonë se në qiell ka perëndi,
Gjepura! Kush ka qoftë dhe dy pare mend,
S'do t'u besojë prallave të vjetra.

Duke bërë heronj të veprave të tij njerëzit me pasionet dhe dramat e tyre dhe duke i paraqitur të tillë edhe perënditë apo gjysmëperënditë, Euripidi tregoi interes të veçantë për njeriun dhe sferën shpirtërore të jetës së tij. Për këtë tipar të veprës së Euripidit dëshmon edhe «Andromaka», që ngërthen në të vërtetë dy drama, atë

të skllaves Andromakë dhe atë të Peleut, të cilat autori i ka zbuluar me forcë e thellësi psikologjike. Përmes këtyre dy dramave individuale, Euripidi ka ngritur probleme të një rëndësie të përgjithshme e ka pohuar ide që në disa drejtime nxitin mendimin e tronditit botën emocionale edhe të njeriut të sotëm.

Euripidi ishte patriot ahinjot dhe armik i Spartës. Ideja patriotike, që përshkon si një fill i kuq shumicën e tragjedive të tij, i shprehur këtu në formën e mallit të Andromakës përvendin e vet e përmes detajesh të tjera, është një vlerë e përhershme e kësaj tragjedie. Po ashtu përmes historisë së Andromakës, monologjeve të saj, autori ka dënuar pasojat e luftërave grabitqare dhe forcat miliariste; në këtë kontekst duhen kuptuar dhe urrejtja e mallkimit e Andromakës e të Peleut për Sparten, spartanët e spartanet.

Po ashtu përmes fatit të skllaves Andromakë, Euripidi, që në përgjithësi ka qenë armik i tiranisë dhe i despotizmit, i ka dënuar ato, ka dënuar padrejtësitë, lavditë e pamerritura dhe ka shtruar njëkohësisht problemin e gjendjes së skllavit. Andromaka i përket asaj kategorie skllevërish që vijnë nga luftërat, të cilat, siç thotë Engelsi, qenë një nga burimet e skllevërve. Edhe pse e ka marrë heroinën nga një kategori shoqërore të kthyer në skllevër, prapëseprapë rëndësi ka fakti që, si dhe në vepra të tjera Euripidi ka paraqitur me ngjyra të gjalla gjëndjen e skllevërve dhe ka treguar se ata nuk qëndrojnë më poshtë se njerëzit e lirë, përkundrazi, siç tregonet në rastin e Andromakës, ata qëndrojnë edhe më lart.

Në disa tragjeti të Euripidit u shtrua problemi i pozitës së gruas. «Andromaka» dhe «Ifigjenia në Tauridë» nga kjo pikëpamje kanë vlerat e tyre. Ato kanë, së pari, vlera njohëse, të cilave u janë referuar shpesh klasikët

për tē provuar pozitēn e gruas nē atē stad tē zhvillimit tē shoqērisë njerëzore. Duke lexuar «Andromakēn», pēr shembull, mund tē gjesh tē vërtetuar ç'ka thotë Engelsi pēr pozitēn e gruas nē shoqērinē skllavopronare dhe nē përgjithësi pēr pozitēn e gruas nē shoqērinē me klasa. «Nē periudhën heroike, shkruan Engelsi, ne e gjejmë gruan tē poshtëuar nga sundimi i burrit dhe nga konkurrenca e skllaveve. Lexuesin e sotëm nuk duhet ta çuditë pozita e Andromakës, që e pranon tradhtinë e burrit si diçka tē ligjshme dhe tē pashmangshme. Bashkëshortja e ligjshme, siç e ka vënë nē dukje Engelsi, duhet ta duronte monogaminë vetëm pēr burrin dhe jo pēr gruan, e tē ruante rreptësish papërlyeshmérinë dhe besnikérinë bashkëshortore».

Po nga ana tjetër, nē figurën e Andromakës Euripi ka zbuluar disa ndjenja tē mëdha njerëzore, si dashurinë pēr tē birin, që arrin gjer nē vetësakrificë etj. Po ashtu me dramën e Peleut, autori ka poetizuar virtytet e jo pasurinë e madhështinë. Fjalët e tij «më mirë i varfër e me virtyt» janë kuptimplotë nē këtë drejtim.

«Andromaka» është një tragedji ku përplasen pasionet e fuqishme e konceptet tradicionale me konceptet e përpunuara tē autorit pēr kohën.

Në idetë humane dhe nē forcën e shprehjes së tyre artistike qëndron edhe vlera e tragedisë «Ifigjenia nē Tauridë». Kjo tragedji është vijimi i subjektit tē veprës «Ifigjenia nē Aulidë», ku ideja patriotike, gatishmëria pēr tu flijuar nē emër tē interesave tē atdheut, është nē qendër.

«Ifigjenia nē Tauridë» e pohon idenë patriotike nē një kontekst tjetër, nē formën e mallit që e zhurit Ifigjeninë pēr vendin e lindjes, pēr gjirinjtë dhe bashkëdhetarët e vet.

Nga ana tjetër, nē vepér janē poetizuar ndjenja i ē tilla tē bukura si ndjenja e madhe e miqësisë dhe e besnikërisë ndaj shokut, apo virtyte tē tilla si trimëria e guximi.

Duke lexuar veprën, tē têrheq forca tronditëse e monologjeve tē Ifigjenisë si dhe forca e dialogjeve tē Orestit e Piladit apo tē këtyre tē dyve me Ifigjeninë, që zbulojnë ndjenjat që u vlojnë nē shpirt, dashurinë përvendin e lindjes, urejtjen për jetën me turp, tē cilën janë gati ta shkëmbejnë me vdekjen me nder që s'njeh tradhtinë ndaj shokut.

Konfliktet e mëdha që kanë vënë nē qendër tē tyre tragjeditë e antikitetit janë zgjidhur kryesishët nē bazë tē fatalitetit e tē ideve fikse tē paracaktuara. Euripidi me «Ifigjeninë nē Tauridë» ka bërë një hap përpara nē këtë drejtim. Heronjtë e veprës, tē ndodhur nē një pozitë gati pa rrugëdalje, me forcë tē pashembullt vullneti e iniciative, dalin nga situata dhe largohen nga toka barbare për nē atdhe. Por ky hap është gjysmak. Euripidi ka bërë nē fakt një kompromis me idenë e fatalitetit, kur e zgjidh konfliktin me ndërhyrjen e perëndeshës Athina.

Lexuesi i sotëm, duke marë nē dorë këto dy vepra tē krijuara nē shekujt e fëmijërisë së shoqërisë njerëzore, nga njëra anë, qëndron i mahnitur përpara forcës së tyre artistike, çmon idetë humane e progresive që ato mbartin e, nga ana tjetër, njeh kufizimet e naivitet që ato trashëgojnë nga ajo epokë dhe nga traditat artistike tē atij populli, tek i cili, siç shkruante Marksi, fëmijëria e shoqërisë njerëzore është zhvilluar më bukur se kudo, duke ruajtur një bukuri tē përjetshme.

JORGO BULO

ANDROMAKA

PERSONAZHET :

*Andromaka, e shoqja e Neoptolemit (dikur e Hektorit).
Hermiona, e shoqja e Neoptolemit, birit tē Akilit.
Menelau, ati i Hermionës.
Peleu, ati i Akilit, i shoqi i hyjneshës Teti.
Molosi, biri i Pirros dhe i Andromakës.
Oresti, biri i Agamemnonit, i fejuari i dikurshëm i Her-
mionës.
Teti, hyjneshë, e shoqja e Peleut dhe e ëma e Akilit.
Shërbëtorja.
Mëndesha.
Lajmetari.
Kori.*

qytetit e Trojës, qytetit e mbretit e Trojës, qytetit e Trojës, qytetit e Trojës,
qytetit e Trojës, qytetit e Trojës, qytetit e Trojës, qytetit e Trojës, qytetit e Trojës,
qytetit e Trojës, qytetit e Trojës, qytetit e Trojës, qytetit e Trojës, qytetit e Trojës,
qytetit e Trojës, qytetit e Trojës, qytetit e Trojës, qytetit e Trojës, qytetit e Trojës,
qytetit e Trojës, qytetit e Trojës, qytetit e Trojës, qytetit e Trojës, qytetit e Trojës.

A K T I

SKENA E PARË

(Andromaka — Kori — Sherbëtorja)

Andromaka

Qytet i Tebës, stoli e tokës
Aziatike⁽¹⁾, nga ku dikur
unë me pajë të pasur fort
erdha te vatr' e mbretit Priam,
si grua e t'birit Hektor!

Zili e kishin fort Andromakën
njerzit aherë, kurse sot është
grua m'e mjerë nga gjithë gratë;
tim shoq, Hektorin, pashë të vritej
prej Akilit, dhe Astianaktin,
djalin q'i linda Hektorit tim,
pashë të hidhni nga kull' e lartë,
kur Grekët morën fushën e Trojës,

1) Teba ishte qytet në rrethet e Trojës. Mbreti i këtij qyteti ka qenë Fetioni, ati i Andromakës.

Unë prej dere nga më fisiqet,
 — aherë bota, kështu më quanin —
 skllave kam ardhur këtu n'Heladë;
 mua më dhanë si shpërblim lufte,
 si pre të zgjedhur nga plaçk' e Trojës,
 Neoptolemit, q'ësht' rritur ishujve. (1).
 Banoj në fushat që janë pranë
 qytetit Ftiq edhe Farsalës (2),
 ku me Peleun jetonte Teti,
 hyjnesh' e detit, larg njerëzisë,
 larg shoqërisë. Këtë vend gjindja
 e Tesalisë e quan m'emrin
 «Tetidion», për të nderuar
 këtë martesë të pérëndeshës (3).
 Këtu e pati shtëpin' e tij
 bir i Akilit: mbret në Farsalë
 e pa Peleun, sepse nuk desh
 të merrete skeptrin, sâ rronte plaku (4).
 Dhe unë në këtë shtëpi
 i linda djale birit t'Akilit
 dhe zotit tim, duk'u bashkuar
 si burr' e grua. Edhe më parë
 vuaja, pësoja, po gjithënje
 kam pasur shpresë, se, sa t'ish gjallë,
 im bir do m'ishte si një mbështetje
 dhe ngushëllim në hidhërimë;
 po që kur zoti im u martua
 me Hermonën, vajzën spartane,

1) Neoptolemi qe rritur në ishullin Skiros.

2) Qytet në Tesali.

3) D.m.th. martesën e Tetit me Peleun atin e Akilit.

4) Neoptolemi, nipi i Peleut, e la të gjyshin në front të Farsalës, të cilin e mbajti plaku gjersa vdiq.

duke përbuzur shtratn' e një skllave,
zuni ajo keq të më ndjekë
me caakuza të mbapshta fort;
thotë se me magji të fshehta
e paskam bërë që të mos lindë
dhe kështu burri të mos e dojë;
se unë dashkam ta nxjerr me forcë
atë nga shtrati dhe në vend t'asaj
të banoj unë në këtë vatër.

Po unë shtratin, q'e kam pranuar
pa dashjen time, tani e lashë;
këtë e di i madhi Zeus
(se si pa dashje hyra aherë
në këtë shtrat). Ajo s'beson
dhe, e ndihmuar prej Menelaut,
do të më vrasë; bile tani
i ati është në shtëpi brenda;
erdhi nga Sparta apostafat
për këtë punë (1). Unë nga frika
erdha dhe ndenja në këtë tempull
t'hyjneshës Teti, që është ngnitur,
pranë pallatit, për të kërkuar
shpëtim nga vdekja. Këtë faltore
e respektojnë edhe Peleu
edhe stërnipat e tij të gjithë,
se u ndërtua për të kujtuar
martesën e bijës s'Nereut (2)
E sa për djaliin, q'e kam të vetëm,
fshehtas e çova në shtëpi tjetër,
mbasi kam frikë se mos ma vrasin.

1) D.m.th. për të vrarë Andromakën.

2) Flet për martesën e Tetit me Peleun.

Sepse i ati mua dhe djalit
s'na jep dot ndihmë, se s'ësht' këtu;
vajti në Delfi, që të kërkojë
ndjesë nga Febi pér marrëzinë
që dikur bëri dhe q'është kjo:
shkoi te Pitia dhe prej saj lypi
që Apoloni të merrte hak
kundër atij q'i vau babanë.
Orvatet që, duke kërkuar
t'i falen fajet që kishte bërë,
të sigurojë pér paskëtaj
ndihmën, përkrahjen e perëndisë.
(Nga pallati del një shërbëtore)

Shërbëtorja

Zonjë e madhe — unë s'ngurroj
të të thërrres me këtë emër,
siç të thërrisja në vatrën tënde,
kur tok banonim në fush' të Trojës,
dhe unë ty të desha fort
si dhe tët shoq, sa ishte gjallë —
edhe tani vij të të sjell
lajme të reja. Vërtet kam frikë
se mos më shohë ndonjë nga zotërit;
por ndjej dhe dhëmbje pér ty, o zonjë.
Pra, Menelau edhe e bija
plane të tmerrshme pér ty kurdisin;
duhet të ruhesh.

Andromaka

O bashkëskllave e dashur fort!
— se je dhe ti skllave me mua,

që mbretëreshë isha më parë,
kurse tani fort e mjeruar —
vallë c'po bëjnë? C'plane kurdisin
për të më vrarë mua të mjerën?

Sherbëtorja

Oh, moj e mjerë, duan të vrasin
tët bir, që fshehtas e ke larguar
jashtë pallatit.

Andromaka

E mjera unë! Paskan mësuar
se djalin tim e kam larguar?
Po qysh, aman? Medet, mbarova.

Sherbëtorja

S'e di; këto i kam dëgjuar
nga ata vetë; dhe Menelau
doli përjashta që ta kërkojë,

Andromaka

O bir, mbarova; do të të zënë,
do të të vrasin këta dy orrla;
ndërsa ai që ësht' yt atë
vazhdon të rrijë ende në Delfi.

Sherbëtorja

Siç kujtoj unë, po t'ish këtu,
kaq keq s'do hiqje; tani, s'ke miq.

Andromaka

As për Peleun s'flitet se vjen?

Shërbëtorja

Eshtë aq plak, sa s'ke dobi,
Edhe sikur t'jetë këtu,

Andromaka

Dhe e kam thirrur më se një herë.

Shërbëtorja

Ç'kujton, se lajmësit ta kanë ngenë?

Andromaka

E po aherë?
Do ti të vesh si lajmëtarë?

Shërbëtorja

Porse ç'të them, po qe se unë
një kohë të gjatë rri larg shtëpisë?

Andromaka

Pretekste gjen ti sa të duash;
se grua je.

Shërbëtorja

Eshtë rrezik; rojtar i fortë
ësht' Hermione.

Andromaka

Λε sheh, pra? Ti ndër mjerime
i braktis miqtë.

Sherbētorja

S'është e vërtetë; me kët' akuzë
mos më ngarko; ja ku do nisem;
dhe, n'e pësosfsha, jet' e një skllaveje
s'ka asnë vlerë.

Andromaka

Pra, shko; dhe unë, që kurr' s'i reshta
as lot, as vaje dhe as rënkimë,
tani në ajër do t'i përndaj;
se grat' e kanë nga vet' natyra
që ngushëllim të gjejn' ngaherë
për të këqijat q'u kanë ndodhur,
duke i zënë çdo çast në gojë.
Qaj jo për një, por për shum' gjëra;
vendi amtar, vdekj'e Hektorit,
fat' im i keq i asaj dite
kur rash' nën zgjedhë të robërisë,
që ish për mua gjë e padenjë.
Kurrën e kurrës nuk duhet thënë
«S'i lum ai», pa par' një herë
qysh do kalojë ditën e fundit
para se t'zbresë poshtë te Hadi.
Aherë kur mori Paridi
në shtratn' e tij Helenën greke,
nuk solli grua, po një murtajë
për Trojën tonë të lartë fort.

Kjo ka shkaktuar që ti, o Trojë,
të shkatërrohesh me zjarr e hekur
prej ushtris' greke, që t'u vërsul
me nj'mij' anije; pér shkak të saj
Hektorin, burrin tim, ah medet!
e lidhi prapa qerres së tij
biri i Tetit, që sundon detet,
edhe rreth murit zvarrë e hoqi (1);
nga dhom' e shtratit me forc'më nisën
mbi val't e detit edhe më vunë
mbi kryet zgjedhën e robërisë
fort të urrejtur. Më mbytën lotët,
kur unë lashë qytetin, dhomën
e shtratit tim dhe burrin tim
në kum të shtrirë. Oh' un' e mjera!
Përse të shoh dritën e diellit?
Të rroj si skllave e Hermonës?
Mbası nga kjo unë po vuaj,
lutëse erdha pranë statujës
së perëndeshës; e përqafoj
dhe po derdh lot, si ai ujët
që pikë-pikë prej shkëmbit rrjedh.
(Në skenë hyn kori i përbërë prej
15 grash nga qyteti Ftia)

1) Euripidi ndjek këtu legjendën që e përmend më vonë edhe Virgilii (Eneida, I, 483, ndërsa Homeri (XXIII, 16) thotë se Akili e solli kufomën e Hektorit tri herë rreth varrit të Patroklit.

SKENA E DYTË
(Andromaka—Hermiona—Shërbëtorja—Kori

Kori

Strofa I:

Grua, që prej shumë kohe
rri në tempullin e Tetit
dhe s'largoresh prej këtej!
Unë, ndonse jam nga Ftia,
te ti, që je nga Azia,
erdha që të gjej, në mundsha,
ndonjë bar për dhembjen tënde,
dhembje q'është fort e rëndë.
Se një grindje e tmerruar
midis teje, moj e mjerë,
dh'Hermionës është ndezur
për të birin e Akilit,
shtratin e të cilit ju
që të dyja bashk' e keni.

Antistrofa I:

Dije fatin që të ra,
shih ç'e keqe të ka zënë.
Ti, që je grua trojane,
ime t'ët zotër po lufton,
që në Spartë kanë lindur.
Lëre vendin që pret delet (1),
tempullin e perëndeshës,
q'është sundimtar' e detit,
ç'dobi vallë i sjell vetes,
po qe se ti, e tmerruar
nga prapsitë e t'ët zotërve,
trupin tënd me lot e lag,

1) Do të thotë për altarin ku shpinin kafshët për t'i fliuar.

e shëmton edhe e prish?
Të shtyp forc' e më të fortit;
je një hiç; pse të mundohesh?

Strofa II:

Po lëre banesën
e bukur t'hyjneshës,
bijës së Nereut.

Kupto se je skllave
në një dhe të huaj,
në qytet të huaj,
ku nga miqt' e tu
nuk shikon asnje,
ti, moj më e mjera
nga të gjitha nuset.

Antistrofa II:

O grua trojane,
erdhe në shtëpi
te zotrit e mi,
dhe më shpirtin tim
më ngjalle mëshirë
të madhe për ty.
Mirëpo nga frika
rri qetë, s'lëviz,
ndonse mua më dhimbshesh.
Trembem se mos biri
i bijës së Zeusit
e merr vesh se kam
simpati për ty.

Hermiona

Këtu kam ardhur me një stoli
t'artë, të ndritur mbi kryet tim
edhe me rrobë të zbuluar
në trupin tim; s'janë dhurata
që i kam marrë që nga shtëpia

e vct' Akilit a e Peleut,
po i kam sjellë nga tok' e Spartës;
the Menelau; im at, m'i dha
me pajë shumë, shumë të pasur (1);
prandaj, pra, mund të flas lirisht.
Ja këto fjalë kisha për ju.

(*Andromakës*)

Ti, grua skllave dhe plaçkë lufte,
do të më nxjerrësh nga kjo shtëpi
dhe zonj' e saj të bëhesh ti.
Ti me magjité e tua bëre
që burri im të më urrejë:
ti je shkaktare që gjiri im
u bë i fishkur, barkthatë mbeta.
Se shpirt' i femrës Aziatike
është i aftë për të këtilla.
Po këto plane do t'i prish unë
dhe as kjo dhomë e Nereidës,
as ky altar, as kjo faltore
s'të shpëton dot, por do të vdesësh.
Po në do dikush nga njerëzia
ose nga hyjtë të të shpëtojë,
duhet të heqësh dorë nga mburrjet
për pasurinë që dikur pate
dhe të përulesh, të më përgjunjesh,
të më fshish dhomat, m'enë të artë

1) Simbas Homerit (Odisëa) Menelau gjatë udhëtimit të tij, kur u kthye nga Troja, kishte grumbulluar pasuri të mëdha.

të sjellësh ujë prej Akelout (1)
dhe më në fund të marrësh vesh
se në ç'vend ndodhesh. Nuk ke të bësh
as me Hektorin, as me Priamin
ose me arin, kamjen e tij;
ti tani ndodhesh në qytet grek.
Ti, moj e mjerë, aq u marrose,
saqë guxon të flesh me birin
e atij që vrau tët shoq (2)
dhe me një vrasës të bësh fëmijë.
Gjithë barbarët të tillë janë;

nër ta bashkohen ati me bijën,
biri me nënën, vëllai me motrën;
madje dhe njerëz shumë të afërt
me shoq-shoq vriten pa u ndaluar
fare prej ligjit (3). Këto zakone
mos u orvat të na i sjellësh
edhe këtu; se për një burrë
s'ka fare hije frenat e dy
grave të mbajë; porse ata
që dëshirojaë të qeverisin
shtëpinë mirë, këta mjaftohen
në shtrat të shohin vetëm një grua (4)

-
- 1) Akelou (Akeloos) lumi që ndan Akarnaninë nga Etolia dhe derdhct në detin Jon.
 - 2) Siç dihet, Akili, ati i Neoptolemit, vrau Hektorin, të shoqin e Andromakës.
 - 3) Kambisi, mbreti i Persisë, mori për grua të dy motrat e tij. Ndër Magët (fis nér Medët) lejohej të kishin marrëdhënie seksuale me nënët e me bijat e tyre.
 - 4) Monogamia konsiderohej prej grekëve si shenjë qytetërimi, që i dallonte nga barbarët.

Kori

Femra gjithmonë është xheloze;
sidomos shemrat fort i urren.

Andromaka

Medet! Medet!

Ësht' gjë e keqe mosha e re (1),
dhe në rini t'jesh i padrejtë,
cilido qoftë ai njeri.

Unë kam frikë — përgjersa jam
skllave e jotja — se mos s'do mund
të të përgjigjem, ndonëse shumë
kam për të thënë, fjalë të drejta;
po dhe në rast se do të t'mund,
trembem se mos prap' e pësoj.
Se nuk durojnë mëndjemëdhenjtë
kur arësyet e më të voglit
janë të drejta dhe më të forta;
megjithatë askush s'do shohë,
që unë veten të tradhëtoj.

Thuajmë, pra, ti, nus'e e re:
kush më ka bindur të të dëboj
nga shtrat' i ligjshëm? Mos Sparta është
qytet m'i ulët ng'ata të Frigve?
Mos un' nga ti kam fat më shumë?
Mos më në fund më sheh të lirë?

1) Se, simbas Skoliastit, është e rrëmbyer ndër mendimet e ndër veprimet.

Mos, duk' u mburrur me trup të ri
e të shëndoshë, me pasuri
të madhe fort, si dhe me miq,
dua të marr shtëpinë tënde
dhe ty prej saj të të largojo?
Përse? Mos vall' që në vend tënd
unë të lind fëmijë skllevër
edhe të shtoj barrën e brengave?
Kush do durojë që djemt e mi
— në rast se ti nuk bën fëmijë —
të jenë mbretër në tokn' e Ftijës?
Patjetër grekët më duan mua
vetëm për hatër t'Hektorit tim;
dhe unë vetë në syt' e tyre
një hiç kam qenë dhe në Frigji
s'isha princeshë. Yt shoq t'unren
jo se e shtyjnë magjit' e mia,
po se ti s'di t'jetosh me të,
ashtu si duhet. Dhe për këtë
kjo ësht magjia: burrat, moj grua,
i kënaq tepër jo bukuria,
porse virthytet. Ndërsa kur ti
për diçka ndizesh, «Sparta ësht', thua,
qytet i madh; s'vlen gjë Skiroja;
midis të varfërvë e pasur jam
dhe Menelau ësht' mbi Akilin.»
Prandaj t'urren edhe yt shoq.
Porse një grua duhet që burrin,
qoftë dhe i lig, ta dojë fort
dhe të mos thotë, duke u mburrur,
se ësht m'e pasur a më fisnike.
Po qe se ti merrie për burrë
një mbret nga Traka, zbardhur prej bore,


ku burri merr në shtratn' e tij (1)
jo një, po shumë gra një pas një,
ti do t'i vrisje? Po ti aherë
do të shkaktoje që t'akuzohej
seksi femror si i pushtuar
tepër nga epshet. Nga kjo sëmundje
më shumë vuajnë femrat se meshkujt;
porse të paktën dimë ta fshehim.
Përkundër unë, Hektor i shtrenjtë,
në dashuritë që kishe ti,
merrja pjesë dhe unë vetë (2);
shum' herë bile u jepja gji
edhe fëmijëve që kishe pasur
me gra të tjera; këtë e bëja
që zemrën tënde mos ta lëndoja.
Ja, pra, kështu fitoja zemrën
e burrit tim: ndërsa ti s'lë
— nga që ke frikë — as pikë vese,
që bie nga qielli, tët shoq ta lagë.
Jot' ëmë, grua, i deshte burrat;
ti mos kërko t'ia kalosh;
se një fëmijë q'është me mend,
sjelljet e liga të nënës saj
nuk duhet kurrë t'i imitojë.

Kori (Hermionës)

Në mos të duket rëndë, moj zonjë,
bindu, pajtohu me këtë grua.

28320

- 1) Në një fragment të Menandrit një trakas thotë: «Në vendin tonë
çdo burrë ka dhjetë, njëmbëdhjetë e shumë herë dympëdhjetë gra».
2) Kundrejt grave, që dashurojnë dhë unë tregojat dashuri.



Hermiona (Andromakës)

Pse flet me mburrje? Ç'kahesh me mua,
sikur veç ti qenke e pastër
dhe unë jo?

Andromaka

Nga sa po thua, nuk del e tillë.

Hermiona

Kurr' mos mendofsha si ti, o grua!

Andromaka

Ti, e re, thua fjalë të turpshme.

Hermiona

Ti vërtet s'thua, po kundër meje
ç'të mundësh bën.

Andromaka

S'do durosh, pra, në heshtje vuajtjet
e dashurisë?

Hermiona

Si?

Kudo për gratë s'ësht' dashuria
gjëja m'e parë, gjëja m'e mirë?

Andromaka

Vetëm kur mirë e përdorojnë;
ndryshe nuk është aspak e mirë.

Hermiona

Qyteti ynë s'rron me zakone
popujsh barbarë.

Andromaka

Gjëja e turpshme, edhe atje,
edhe këtu të turpëron.

Hermiona

Më je e ditur, e ditur shumë;
megjithatë duhet të vdesësh.

Andromaka

Statujn' e Tetit a nuk e sheh
që syt' mbi ty i ka mbërthyer?

Hermiona

Ajo urren atdheun tënd,
mbasi aty u vra Akili.

Andromaka

Atë e vrou jot' ëm, 'Helena,
dhe aspak unë.

Hermiona

Prap' i përmend shallet e mia?

Andromaka

Ja, pra, po hesht, po e mbyll gojën.

Hermiona

Për një gjë vetëm do të më thuash,
për t'cilën erdha deri këtu (1).

Andromaka

Po t'them që ti s'ke mend sa duhet.

Hermiona

A nuk largohesh prej këtij vendi
të shenjtëruar të zonjës detit?

Andromaka

Vetëm në vdeksha; përndryshe s'tundem.

Hermiona

Kjo ka marrë fund, s'e pres tim shoq.

Andromaka

Po edhe unë, s'të dorëzohem
pa ardhur ky.

1) Erdhi këtu që ta dëbojë nga faltorja e Tetit.

Hermiona

Do t'të vë flakën, për ty s'do pyes.

Andromaka

Digjmë, pra; hyjtë këto i shohin

Hermiona

Plagë të tmerrshme në trupin tënd
do të shkaktojnë dhembje të sorta.

Andromaka

Thermë, spërkate me gjak altarin
e perëndeshës; kjo do t'të ndjekë.

Hermiona

Ç'pjellë barbarësh, ç'guxim i egër!
 Duron, pra, vdekjen ta përballosh?
 Po nga ky vend do të të bëj
 të dëlësh shpejt me dashjen tënde;
 ta kam karremin. Po hesht, s'po flas;
 se shpejt vet' puna do ta tregojë.
 Mos luaj vendit se rrotull teje,
 sikur të kesh dhe plumb të shkrirë,
 do të të ngre pa ardhur edhe
 bir' i Akilit, ku ti mbështet
 shpresat e tua.

(*Hermiona kthehet në pallat*)

Andromaka

Vërtet tek ai i mbështes shpresat;
 po një gjë është për t'u çuditur:
 ndonjë nga hyjtë i dha njerëzisë
 barëna kundër gjarpinjve t'egër,
 mirëpo kundër gruas së keqe,
 që ja kalon nepenkës, zjarrit,
 askush gjer sot s'ka gjetur bar;
 e keq' e madhe qenkemi gratë
 për njerëzinë!

Kori

Strofa I:

Derte të mëdha filluan
 kur në bjeshk'.të Idës erdhi (1)
 Bir i Majës dhe i Zeusit (2),
 duke prirë të tre mëzat
 e karrocës madhështore:
 sillte kjo të tri hyjneshat (3),
 t'armatosura të tria
 për një garë të urrejtur,
 për garën e bukurisë.
 Erdhën te stallat e qeve,
 te lopari djaloshar (4),
 që jetonte në vetmi
 pranë vatrës së shkretuar.

1) Ida: mal në veri-perëndim të Azisë së Vogël.

2) D.m.th. Hermesi

3) Është fjala për perëndeshat Hera, Atena dhe Afërdita, që hareshin së cila ishte më e bukura: Paridi gjykatës çmimin ia dha Afërditës.

4) D.m.th. Paridi.

Antistrofa I:

Kur arritëm mu te bjeshkët,
trupin bardhë si dëbora
në ujet malor e lanë;
pastaj van' te Priamidi,
dhe përfisnin bukurinë,
që kish njëra edhe tjetra,
me ca fjalë fort të ashpra.
Më në fund fitoi Kiprida (1)
me ca fjalë dredharake;
por të ëmbla në t'dëgjuar,
që u bënë shkak të prishen
në mënyrë fort të hidhur
dhe qyteti i Frigjisë
edhe krejt muret trojane.

Strofa II:

Makar nëna e Paridit
ta kish hedhur sa po lindi,
para se të shkonte ky
në shkëmbinjt e malit Ida,
Bash aherë kur Kasandra (2),
pranë larit profetik (3),
«Vriteni — thosh — këtë djalë»,
mbasi ky qytetn' e madh
të Priamit do ta prishë».
Profetesha ku nuk vajti?
Kujt prej pleqve s'iut lut
që ta vrisnin këtë foshnjë (4)?

1) D.m.th. Afërdita; Quhej kështu se adhurohej sidomos në ishullin Qipro.

2) Bija e Priamit profeteshë e dëgjuar.

3) Thotë mbasë për larin (dafinën) që ish rreth altarit në oborrin e Priamit.

4) Pleqtë (demogerontes) ishin këshilltarët e mbretit.

Antistrofa II:

Se aherë grat' e Trojës
as që do të kishin hyrë
nën zgjedhë të robërisë;
dhe ti, grua, do të rrige
në pallatet mbretërore;
dhe Helada të shpëtonë
nga mjerime të mëdha
që pësoi djalëria,
kur qëndroi e armatosur
përreth Trojës dhjetë vjet;
gratë s'do humbisnin burrat,
edhe pleqtë bijt e tyre.

(*Hyn Menelau me djalin e Andromakës*),

SKENA E TRETE

(*Kori — Andromaka — Menelau*)

Menelau (Andromakës)

Ja erdha, grua; mora me vete
dhe djalin tënd, të oilin ti
në shtëpi tjeter e kishe çuar
fshehtas, pa marrë vesh imë bijë.
Për veten tënde prisje shpëtim
nga kjo statujë e perëndeshës
dhe përkëtë (1) ng'ata q'e fshehën;
porse u duk që je, moj grua,
më pak e mençme se Menelau.

1) D.m.th, për djalin e saj.

Pra, po s'u shporre prej këtij vendi,
për ty do theret ja ky këtu.

Mendohu, pra: do vdesësh ti
a ky këtu, për shkak të fajit
që bën ndaj meje dhe sime bije?

Andromaka

Famë, o famë! Mijëra njerëz
që s'patën vlerë ke lartësuar.
Nga ana ime quaj të lumtur
ata që kanë famë mbështetur
mbi të vërtetë; sa për ata
që me gënjeshtra fituan famë,
duken se kanë, porse nuk kanë.
Ti dikur prive grekë të zgjedhur
dhe ia more Priamit Trojën,
ti një njeri kaq i pazot!

Ti që nga fjalët e bijës sate
— foshnjë nga mendja — aq fort u ndeze,
sa kundër meje, një grua skllave,
grua fatkeqe, ke shpallur luftë.
As ti i denjë s'je më për Trojën,
as kjo për ty (1) (Ata që duken
se kanë mend, kanë shkëlqim
vetëm të jashtëm; ndërsa përbrenda
janë njësoj si gjithë njerëzit,
përveç në shquhen për pasuri,
që është për ta fuqi e madhe).

1) D.m.th., ti s'meritoje të mundje trojanët dhe të shkatërrroje Trojën; edhe kjo meritonte të prishej nga ndonjë tjetër dhe jo nga ti.

Pra, Menela, haj ta mbarojmë
këtë bisedë: zëre se vdiqa,
zëre se bija jote më vau;
në këtë rast ajo s'shpëton
nga njoll' e vrasjes; po edhe ti
në sy të botës do jesh përgjegjës;
do quhesh vrasës, mbasi ndihmove
në këtë vrasje. Zëre se unë
ishmangem vdekjes; tim bir do vrissni?
Aq leht' i ati do të durojë
vdekjen e djalit? Troja këtë
nuk e ka quajtur kaq frikacak;
po do të sillet ashtu si duhet.
Do të tregojë se vepron bash
siç i ka hije gjyshit Peleut
edhe Akilit, atit të tij.
Ai tët bijë do ta dëbojë
nga vatr' e tij; e ti pastaj,
kur do përpinqesh që ta martosh
me burrë tjetër, vallë ç'do thuash?
Se urtësia e vajzës sate
s'mund të durojë burrë të keq?
Një gjë e tillë është gënjeshtër.
E kush e merr atë për grua?
Apo kërkon ta mbash në vatër
q'aty të plaket e ve, pa burrë?
O burr' i mjerë, si s'parasheh
sulmin e aq fatkeqësive?
Oh, sa më tepër do dëshiroje
që bija jote të tradhëtohet
shpesh nga i shoqi, sesa të vuajë
ato që them. Po nuk duhet

për disa gjëra fare të vogla
të shkaktosh dhembje fort të mëdha;
nëse ne gratë jemi nj'e keqe
shumë e madhe, s'duhet ju, burrat,
të na përngjani. Po qe se unë
me ca magjira — sikundër thotë
tani jot bijë — e bëj të shterpë
barkun e saj, me dashjen time
dhe jo me forcë, do të largohem
nga kjo statujë, do t'i nënshtrohem
atij dënim i që do caktojë
vet' dhëndri yt; se dhe këtij
i shkaktoj dëm bile të madh,
se e ndaloj të lërë prapa
trashëgimtarë. E tillë grua
unë, pra, jam; e sa për ty,
një gjë më tremb; për grindje grash
edhe qytetin e mjer' të Frigve
e shkatërrrove.

Kori (Andromakës)

Një burni ti i flet më shumë
sesa i ka hije një femre;
dhe urtësia e mendjes sate
hodhi shigjetat fort përentej cakut (1).

Menelau (Andromakës)

Të vogla janë këto, moj grua,
dhe, siç po thua, s'i kanë hije

1) E kapërceve masën që duhet të ketë fjala e një femre, sidomos kur i drejtohet një mashkulli.

pushtetit tim edhe Greqisë.
Po dije mirë se ajo gjë
q'i nevojitet ndonjë njeriu,
i vlen këtij më fort sesa
pushtim' i Trojës. Kështu dhe unë:
ndih time bijë, se, siç gjykoj,
ësht gjë e madhe t'humbasë burrin.
Se për një grua vuajtjet e tjera
s'peshojnë fort; po humbjë burrit
është njëloj m'humbjen e jetës.
Skllevërit e mi duhet ai
t'i urdhërojë, ata të tijtë
unë së bashku me fisin tim;
miqtë, në qofshin miq të vërtetë,
gjë të veçantë s'duhet të kenë,
porse të mirat t'i kenë bashkë.
Po qe se unë punët e mia
s'i rregulloj si ësht' më mirë,
po pres të kthehen ata q'jan' larg (1),
do jem **njeri** pa mend, i vogël,
Po ik, largohu **nga** kjo faltore
e perëndeshës; po vdiqe ti,
ky biri yt shpëton **nga** vdekja;
po në mos daç të vdesësh ti,
do vras këtë; **nga** ju të dy
njëri patjetër duhet të vdesë.

Andromaka

Medet! Medet!
Më vë përpara një short të hidhur:

1) Thotë për Neoptolemin, i cili s'ndodhej aty.

të bëj një zgjedhje të hidhur jete;
po sido që të bjerë shorti,
unë do jem gjithmon' e mjerë.
O ti që bën gjëra të rënda
për shkak të vogël; bindur, dgjo:
pse do më vrasësh? Për ç'faj, për ç'krim?
Cilin qytet kam tradhëtar?
Nga djemt' e tu olin kam vrarë?
Ç'shtëpi kam djegur? Hyra në shtratin
e zotit tim, por përdhunisht;
për këtë, pra, mua do m'vrasësh
dhe jo atë që ka shkaktuar
këto të gjitha? Po ti kështu
e lë mënjanë shkakun, dhe merr
vetëm pasojën që rrjedh prej tij,
që vjen më vonë. E mjera unë,
atdheu im, atdhe i shkretë,
ç'tmerre po vuaj! Pse t'bëj fëmijë,
dhembjes që kam t'i shtoj një tjetër,
dhe hidhërimin ta dyfishoj?
Po ç'qaj pér to dhe s'mendoj, s'shoh
këto mjerime që kam pérpara?
Me syt' e mi pashë Hektorin
të therur prej rrotash karroce;
unë kam parë — pamje vajtuar —
Trojën të djegur, të përvëluar;
mua së fundi pér flokësh m'hoqën,
n'anijet greke skllave më shpunë.
Erdha në Ftijë; më merr pér grua
ai që vau Hektorin tim.
Ç'shije ka mëjeta pér mua?
Nga t'i hedh sytë? Te fat' i sotëm,

a tek ai i kohës shkuar? Vetëm ky djalë më mbeti sot, ky është syri i jetës sime⁽¹⁾; porse këtë duan ta vrasin; kanë vendosur. Po kjo s'do ndodhë; të vdes' ai, që të rroj unë. Ky në shpëtoftë, do ketë shpresë; ndërsa për mua do jetë turp, po të mos vdes për birin tim. Ja ku e ke këtë altar; po dorëzohem, që të më therni, që të më vrissni, që të më lidhni, që të më varni. O biri im, nëna që t'lindi po shkon te Hadi, që të shpëtosh nga thonjt e vdekjes; e, në shpëtofsh, kujto tët ëmë, kujto se ç'fund të hidhur pati; edhe tyt eti — pasi me mall ta përqafosh, pasi ta puthësh — me lot në sy ke për t'i thënë se si veprova. Për gjithë njerëzit fëmijët qenkan shpirti i tyre; Ai njeri që më qorton, ngaqë këtë s'e ka provuar,⁽²⁾ ai vërtet vuan më pak, por' është fatkeq në lumturi.

Kori

Duke dëgjuar fjalët e tua,
ndjej dhembursi për ty, o grua;

1) Syri i jetës, ngushëllimi i jetës sime.

2) Se s'ka provuar se ç'domethënë fëmijë, se s'ka qenë prind.

të gjithë njerëzit ndjejnë mëshirë
për një që vuan qoft' ky i huaj.
Detyra jote, o Menela,
ësht' ta pajtosh me vajzën tënde
këtë të mjerë, kështu që kjo
të mos pësojë, të mos mundohet.

Menelau

(*Andromakës*)

Ju, shërbëtorë, zërmani gruan,
lidhjani duart se kjo tanë
nuk do dëgjojë fjalë të mira.
Un' me qëllim që të t'larroja
ng'altar' i pastër i perëndeshës,
thash' që tët bir do të ta vrisja;
me këtë fjalë të detyrova
n'duant e mia që të më biesh
që të vras. Dije, ky është,
pra, fati yt. Sa për tët bir,
vet' imë bijë do të gjykojë,
në duhet vrarë, a s'duhet vrarë.
Tani, pra, ti shko në shtëpi,
që të mësosh se ti, një skllave,
s'duhet të shash njerzit e lirë.

Andromaka

Ah, me dredhi më ke gënjiyer;
rashë në grackë.

Menelau

Shpalte kudo; nuk e mohoj.

Andromaka

Ju, t'Eurotës (1), kësaj i thoni
zgjuarësi?

Menelau

Dhe ju të Trojës: kush fyhet, fyen.

Andromaka

Mos beson q'hyjtë nuk janë hyj
dhe nuk veprojnë me drejtësi?

Menelau

Kur do veprojnë, përgjigjem unë;
ty, sidoqoftë, do të të vras.

Andromaka

Mos do të vrashësh edhe këtë
zogëz të shkulur nga krahu im?

Menelau

*Io simë bëje do t'ia jap;
kjo le ta vrasë, po që se do.*

Andromaka

Ah, biri im: Pse nuk të qaj
që këtë çast

1) Eurota — lumi i Spartës.

Menelau

Vërtet, për 'të s'ka shumë shpresë.

Andromaka

O ju, spartan, fis m'i urryer
 nga gjithë bota. Ju, këshilltarë
 plot me dredhira, mjeshtër për rrena,
 shpikës të ligash; mendimet tuaja
 nuk kanë qenë kurrë të drejta,
 po gjithënjë janë të shtrembëra.
 Padrejtësish, pra, ju në Greqi
 rroni të lumtur. Me të vëntetë:
 ç'gjë s'ndodh ndër ju? A s'bëhen vrasje
 herë pas here? S'bëni fitime
 pa pikë turpi? S'mendoni tjetër,
 dhe tjetër thoni? Vdekshi! U shofshi!
 Për mua vdekja s'ësht 'aq e rëndë
 sa kujton ti; se jam e vdekur
 që kur u prish Troja e mjerë,
 që kur m'u vra burr' i dëgjuar,
 i cili ty shpesh të ka ndjekur
 me shtiz' në dorë dhe prej ushtari
 të ktheu në detar frikash (1).
 Po tani ti, ushtar i vrullshëm,
 kërkon të vrashësh një copë grua?
 vritmë; porse nga goja ime
 s'ka për të dalë lajkë për ty,
 as për tët bijë. Se në je ti //

1) Hektori shpeshherë e ndoqi Menelaun në fushën e luftës dhe e shtrëngoi të kërkonte strehë në anijet.

i madh në Spartë, në Trojë jam
dhe un' e madhe; në jam tani
grua fatkeqe, ti mos u mburr,
se mund të bëhesh dhe ti i tillë.

(*Shërbëtorët e Menelaut heqin nga
skena Andromakën me të birin; Me-
nelau u vete pas*).

SKENA E KATËRT

Kori

Strofa I: Nuk do lavdëroj
kurre ata burra
që marrin dy gra,
as ata fëmijë
q'janë prej dy nënash;
se janë burim
grindjesh në shtëpi,
dhembjesh të këqia.
Burri të kënaqet
me një grua vetëm,
dhe kjo mos ket' pasur
burr' tjetër më parë
Edhe në qytetet
më lehtë durohet
një pushtet se dy (1)
Pushtet i dyfishtë
me grindjet që sjell

1) Tërthorazi kritikon regjimin e Spartës, ku, siç dihet, pushteti i kishin dy mbretër.

ua dyfishon
dhembjet qytetarve;
edhe Muzat vetë
kënaqen të ndezin
grindje edhe sherr
midis dy poetësh
që hartojnë këngë,
këngë edhe himne.

Strofa II:

Kur era e fortë
i bie anijës,
po që se dy veta
drejtojnë timonin
dëm do të shkaktojnë;
një tog dëjtarësh
të mbledhur së bashku
është më i dobët
nga m'e dobëta mendje
e atij njeriu
q'c sundon ky vetë;
shtetet e shtëpitë,
në daçin t'jetojnë
dhe të përparojnë,
duhet një të vetëm
sundimtar të kenë.

Antistrofa II:

Këtë e provon
kjo vajzë nga Spanta,
bij' e Menelaut,
kryekomandantit;
kjo, e ndezur fort
për shtratn' e një tjetre,
rreh, kërkon të vrasë
një vajzë trojane,
vajzë të mjeruar

bashkë me të birin,
për shkak të një grindje,
fort të tepëruar:
vrasje kjo e egër,
vrasje e padrejtë,
vrasje e tmerruar!
Po ti, moj princeshë,
dikur do pendohesh
për këtë veprim.
Ja para pallatit
po shoh këtë çift (1)
të lidhur shtrënguar;
vdekja e këtij
është e vendosur.
O grua fatkeqe,
dhe ti djal' i mjerë!
Ti po vdes, mbaron
për shkak të martesës
që bëri jot' ëmë.
Ti s'je i përzjerë
në ndonjë veprim
kundër mbretit t'vendit.

(*Andromakën dhe të birin i sjellin lidhur*)

Andromaka

Strofa:

Me duar plot gjak
nga prangat e forta
ja tani po zgres
poshtë nënë dhe

1) D.m.th., *Andromaka* dhe i biri Molosi.

Molosi

Nënëzë e shtrenjtë,
dhe unë me ty
do zgres i mbuluar
me krahët e tu.

Andromaka

Ësht' një fli e tmerrshme,
o krerë të Ftijes (1).

Molosi

Atë, at' im,
cja t'u ndihmosh
t'dashurve të 'tu.

Andromaka

Bir, o bir i shtrenjtë,
do të prehesh, pra,
në gjit' e sat' ëme,
posht' mën dhe i vdekur
me mua të vdekur.

Molosi

Medet! ç'mund të bëj?
Ah, i mjeri unë!
Mjerë dhe ti, nënë!

1) Qytet dhe krahinë në Tesali, atdheu i Akilit.

Menelau

Zbrisni, pra, nën dhe,
ju që keni ardhus
nga qytet armik.
Vdekja ju të dyve
ju vjen nga dy veta:
unë jam, o grua,
që ty të dënoj,
ndërsa djalin tënd
bija, Hermiona.
Marrëzi e madhe
ësht' të lë të gjallë
armiq bij armiqsh,
kur e kam në dorë
t'i vras e t'i zhduk
e kështu shtëpinë
ta liroj nga tmerri.

Antistrofa:

Andromaka

O burri im,
o burri im,
bir' i Priamit!
Sikur t'më jepte
ndihmë tani
ai krahu yt
dhe shtiza jote!

Molosi

C'këngë të gjej
i mjeri unë
që të shpëtoj,
t'i shëmangem vdekjes?

Andromaka (Duke treguar Menelaun)

Lute t'ët zot
bjeri në gjunjë
o biri im.

(Molosi i bie Menelaut në gjunjë)

Molosi

I dashur mbret,
i dashur mbret,
lërmë të rroj.

(Menelau e shtyn)

Andromaka

Nga sytë derdhen
lotët si breshër;
po qaj, e mjera,
e po derdh lot,
si pikon ujët
në vend pa diell
nga shkëmb i pjerrët.

Molosi

I mjeri unë!
Si t'i bëj ballë
së keqes sime?

Menelau

Ç'më bie në gjunjë?
Eshtë njëlloj

sikur t'i lutesh
valës plot shkumë,
shkëmbit të detit.
Këtu kam ardhur
t'u ndih të mive;
dhembje për ty
nuk ndiej asfare,
se, që të marr
t'ët ëm' e Trojën,
pjesë të madhe
të jetës humba;
që ta shijosh
tani t'ët ëmë,
dhe ti do zbresësh
te Hadi poshtë.

(*Menelau nxjerr shpatën*)

Kori

Po shoh pranë Pelendë vjetë;
po vjen këtu duke nxituar
me çap prej plaku.

(*Peleu, hipur mbi karrocë, afrohet dhe, pa zbritur edhe, fillon të flasë.*)

Peleu

Ju po ju pyes dhe ty atje
që kryeson këtë therore:
ç'është, ç'po ndodh? Ç'ësht' kjo sëmundje
q'i ra shtëpisë? Po i dënon
pa i gjykuar? Ej, Menela!

qëndro, mbaj dorën; mos u nxito,
pa bërë gjyq; (Karrocierit) ti nga më shpejt;
se, siç më duket, koha nuk pret;
as ndonjëherë s'kam dëshiruar
të merrja forcat e djalënisë,
sesa tani. Së pari, pra,
kësaj këtu do t'i fryj unë,
siç i fryn pluhurit era e mirë (1);
thuaj: me ç'gjyq t'i lidhën duart
me këto pranga dhe po të heqin
ty e tët bir? Se ti po vdes
mu si një dele me qengjin bashkë,
në kohën kur s'ishim këtu,
un' dhe yt shoq.

Andromaka

Këta, or plak, siç sheh dhe vetë,
m'heqin me djalin që të na vrasin.
E ç'të të them? Jo nj'herë vetëm,
me mijra herë të lajmërova;
e di, besoj, e ke dëgjuar
se në shtëpi vajz' e këtij
grindet me mua; se prej këtyre
po humbas jetën. Tani këta,
pasi më shkulën që nga altari
i perëndeshës Teti që ti
e nderon tepër, se e ke nënë
të djalit tënd të shquar font —

1) D.m.th., do t'i jap kurajo, do ta forcoj.

m'heqin me forcë që të më vrasin;
as më gjykuan dhe as nuk pritën
gjersa të kthehen njerzit e mi
që ndodhen larg; po pikërisht
kur morën vesh që jemi vetëm
un' e im bir, q'ësht' i pafajshëm,
duan të vrasin mua të mjerën
bashkë me të. Prandaj, o plak,
të lutem fort, të bie nér gjunjë
— se mjekrën tënde shumë të dashur
nuk më lejohet ta prek me dorë —
për emër t'hyjve shpëtona, t'lutem;
përndryshe, ne të dy do vdesim:
porse kjo vdekje, ndërsa për ne
mjerim do jetë, për ju, or plak,
do jetë turp.

Peleu

Un' urdhëroj të zgjidhen prangat,
para se dikush prej jush të qajë,
dhe të çlirohen duant e saj.

Menelau

Unë s'lejoj, dhe pse m'i dobët
se ti nuk jam, dhe pse mbi të
unë më shumë të drejta kam.

Peleu

Si?

Këtu ke ardhur t'administrosh
shtëpinë time? S'të është mjaft
q'je mbret i Spartës?

Menelau

Unë e solla skllave nga Troja

Peleu

Po si shpërblim im nipi e mori (1).

Menelau

E, pra, të miat s'jan' dhe të tijat,
të tijat, prapë, s'janë të miat (2)?

Peleu

Po që t'i sillë mirë, jo keq,
edhe me forcë të mos e vrisni.

Menelau

Këtë nga dora nuk ma shkul dot.

Peleu

E sheh kët' shkop? Ta gjakos kokën.

Menelau

Prekmë, afrohu, e do të shohësh.

1) D.m.th., Neoptolemi.

2) Menelau i quan të përbashkëta (sendet që kanë të dy familjet) mbasi të bijën Hermionën e kishte marrë për grua Neoptolemi.

Or frikacak, bir frikacakësh:
nër burrat veten e numëron?
A ke ndonjë vetijë burri?
Burrë je ti që ta rrëmbeu
gruan një Frigas, q'e le shtëpinë
hapur, pa kyçe, pa shërbëtorë (1),
duke pandehur se në shtëpi
ke lënë grua t'urtë, të ndershme,
ndërsa kjo ishte femra m'e keqe
nga gjithë gratë? Po vajz'e Spartës,
edhe në dashtë, s'mund t'jet e ndershme;
sepse këto, duke i lënë
vatrat të shkreta, bëjnë ushtrime
bashkë me djemtë nëpër palestrat
e nëpër stadet, që un's'i dua,
me peple (2) ngritur kofshëzbulluar
E, pra, si është për t'u çuditur
që ju nuk rritni femra të uarta?
Për këto duhej pyetur Helena,
e cila iku, e la shtëpinë,
e la Zeusin, që e mbron jetën
bashkëshortore, (3) dhe me një burrë
të ri u largua në tokë tjetër
për të défryer. Dhe ti aherë
për shkak të saj mbodhë nga grekët
ushtri të madhe, të cilën kundër
Trojës e shpure. Për një të tillë

1) Shërbëtorët kishin për detyrë ta ruanin shtëpinë.

2) Petk luksoz i grave greke

3) Zeusi ishte mbrojtës (filios) i martesave dhe i jetës së bashkëshortëve.

grua tē keqe s'duhej tē rrokje
armët nē dorë, po ta përbuzje,
e ta braktisje atje ku shkoi;
bile tē jepje edhe tē holla,
që tē mos kthehej kurër n'atdhe;
porse pér një mendim tē tillë
nuk tē drejtoi era e mirë.

Ti je shkaktar që kanë humbur
aq shum' tē rinj; që nëna plaka
mbetën pa djem; q'etër tē thinjur
humbën fëmijët; një nér ta jam
dhe un'i mjeri; ty, pra, tē quaj
vrasës tē mbrapshtë t'Akilit tim.
Ti je i vetmi q'erdhe nga Troja
pa asnë plagë; ti ato armë,
që ndritnin fort, q'i kishe vënë
në një këllëf shumë tē bukur.
siç i ke shpënë, ashtu i solle.

I thosha nipit, kur do martohej,
as tē mos bëjë krushqi me ty,
as tē mos sjellë në shtëpi time
bijën e një nëne tē keqe,
se këto vajza sjellin me vete
veset e nënës. Po ju drejtohem
juve, o djem, që do martohi:
zgjidhni pér grua vajzat që kanë
nëna tē mira. Përveç kësaj,
ti tët vëlla a s'e ke fyer,
duke i thënë tē therë bijën
si një i marrë (1) Oh, sa u trembe

1) Menelau e kishte bindur Agamemnonin që tē flijonte bijën e vet,
Ifigjeninë, pér tē qetësuar detin, që i pengonte grekët tē lundronin
në Trojë.

se mos humbasësh një bashkëshorte
aqë të keqe! Kur ra pastaj
qytet'i Trojës — se dhe këtu
do të të ndjek — gruan s'e vrave,
ndonëse kjo të ra në dorë;
po, me të parë gjirin e saj,
e hodhe shpatën, ajo të puthi.
e përkëdhele, ore i dobët,
bushtren që ty të tradhëtoi,
duk' u munduar prej Afërditës (1).
Si erdhe në shtëpi, në vatër
të djalit tim, po e shkreton
këtë shtëpi, bash kur ai
s'ndodhet këtu; kërkon të vrasësh
pa pikë turpi gruan e mjerë
edhe të birin; porse ky djalë
— qoftë edhe tri herë doç —
do t'jua marrë hakun dhe ty,
dhe bijës sate; siç dihet, shpesh
toka e thatë prodhon më shumë
sesa e majmja; kështu ngjet bash
edhe me doçërit: shumë ng'ata
ua kalojnë bijve legalë.
Merre, pra, vajzën (2); për njerëzinë
është më mirë të kenë krushq,
të kenë miq njerëz të varfër,
po të virtytshëm, sesa të pasur,
po pa virtyt; e sa për ty,
ti s'vlen asgjë,

1) D.m.th. prej dashurisë.

2) Hermionën.

Kori

Shpeshherë gjuha për gjë të vogël
shkakton nér njerëzit grindje të madhe;
prandaj ata q'janë me mend
rrahin t'i shmangen grindjes me miqtë.

Menelau

Si mund t'i quash të mençur pleqtë
dhe ata që dikur nér grekët
shkonin për njérëz me mend, të ditur,
kur ti, Peleu, q'je bir i një
ati të shquar dhe që ke bërë
krushqi me mua, thua ca fjalë
që edhe ty të turpërojnë,
edhe për mua janë një sharje,
sharje e rëndë? Dhe pse këto?
Për shkak të një femre barbare,
të cilën duhej ta kishe zbuar
përtej lumenjve t'Nilit e Fasit⁽¹⁾,
duke kërkuar dhe ndihmën time.
Eshtë një grua aziatike,
nga ai vend ku kanë rënë
mijëra grekë duke luftuar;
edhe për vrasjen e djalit tënd
është dhe kjo bashkëfajtore.
Sepse Paridin, atë që vau
tët bir Akilin, e kish vëlla
Hektori, burri i kësaj femre.

1) Fasis: lumë në Kolkidë; krahanë e Azisë së vogël midis Arme-nisë dhe Detit të Zi.

Tani, pra, ti me këtë grua
nën të përbashkët strehë banon,
e merr në sofër, lejon të lindë
në shtëpi tënde fëmij t'urrejtur.
Ja pse, or plak, dua ta vras;
ësht' për të mirën tënde dhe timen;
megjithatë kërkon nga duart
të ma rrëmbesh. Më thuaj pra:
— s'ësht' turp ta themi — në qoftë se
pra, vajza ime nuk do të lindë,
dhe kjo këtu do lindë djem,
do t'i vësh mbretër të Ftiotidës?
Këta barbarë mbi ne helenët
do të sundojnë? Mend, pra, ti paske,
dhe s'paskam unë, unë q'urrej
padrejtësinë? Po tani
merr parasysh edhe këtë:
zëre se ti marton tët bijë
me ndonjë nga djemt' e qytetit
dhe se ajo vuán tamam
si ime bijë; ti ç'do të bëje?
Vallë do rrije pa folur gjë?
Nuk e besoj: e tani shan
njerëzit e fisi të këtë grua,
grua të huaj? Porse të njëjta
të drejta kanë burri dhe gruaja:
kjo, kur i shoqi e përdor keq,
ai, kur ka në shtëpi grua
q'është mendjelehtë.
Burri fuqinë e ka në krahët,
gruaja mbështetet mbi miqt' e prindët.
S'ësht', pra, e drejtë t'u ndih të mive?
Plak je, je plak, po dije mirë

se strategjinë time në Trojë
do lavdërosh shumë më tepër,
po qe se flet, sesa po t'heshtësh.
Helena vuajti, s'e deshi vetë;
hyjtë e deshën; po me këtë
që bëri kjo, Greqis'i solli
dobi të madhe, se ndërsa grekët
më parë ishin të pastërvitur
n'armët, në luftrat, faj i Helenës
i bëni trima, se më çdo gjë
prova, stërvitja bëhet mësues
i njerëzisë. Është e vërtetë
se gruan time unë s'e vrava
kur kjo më doli përpara syve,
po kjo provon q'aherë unë
me mend veprova; do dëshiroja
edhe ti Fokon të mos e vrisje (1).
Këto t'u thashë, jo nga imati,
po pse të dua; ti, në rrëmbëhesh
nga zemërimi; provon se gjuhën
s'e përmban dot; kurse për mua
urtia është fitim i madh.

Kori

Pushoni, pra — kjo ësht' më mirë —
fjalët e kota, mbasi këto
mund që t'ju shpienë të dy në faje.

1) Simbas Apolodorit (III, 12,6); Peleu dhe Telamoni, bijtë e Eakut, mbretit të Egjinës, vranë të vëllanë, Fokon, se ky kishte qenë më i mirë se ata. Për këtë krim u zemërua Eaku dhe dëboi nga Egjina Peleun me Telamonin.

Peleu

Medet, sa keq mendojnë grekët!
Kur një ushtri e mund armikun
dhe ngreh trofe, s'thonë se puna
është e ushtrisë, po gjenerali
e merr lavdinë. Një është ky,
shtizën e tund bashkë me shumë,
shumë të tjërë, s'vepron më shumë
se një ushtar; megjithatë,
më t'madhin nam e fiton ky.
Këta, të shtrirë nëpër kolltukët
dhe nëpër zyrat e një qyteti,
ndonëse janë një hiç, një zero,
mburren se kanë më shumë mend
sesa lauzi. Përkundër, ky
një mijë herë është m'i mençur,
po i mungon vetëm guximi
edhe vullneti.
Kështu dhe ti me tët vëlla
rrini të fryrë, mburreni fort
me fatn' e Trojës dhe me komandën
e ushtris' greke që aty patët;
të tjér' u lodhën, të tjérë hoqën,
ju po krenohi. Po tani unë
do t'të mësoj që asnjëherë
të mos kujtosh se ke Paridin,
barin' e Idës, më t'madh armik
se sa Peleun, nëse në çast
nuk do qërohesh nga kjo shtëpi
ti edhe bija jote barkthatë;
po edhe ky, qësh *gjaku im* (1),

1) Flet për djalin e Andromakës.

pasi ta kapë atë për flokësh,
do ta dëbojë prej kësaj vatre.
Se kjo mëshqerrë, barkthatë vetë,
s'duron të lindë një grua tjetër;
në paska kjo fatin e keq
të jetë shterpë, duhet as ne
djem të mos kemi? Ju, shërbëtorë,
hiquni larg kësaj këtu (1),
që të shoh kush do më ndalojë
t'ia zgjidh duart.

Ti, grua, ngreu; ndonëse mua
më dridhen duart, këtë litar
fort të përdredhur kam për ta zgjidhur.
Këshfu ia vrave, ore i lig,
duart kësaj? Mos ke kujtar
se lidhje ka ose luam
me këto pranga? Apo u trembe
se mos rrëmbejë shpatën kjo grua
të mbrojë veten nga sulmi yt?
Eja ti, djali nën krahun tim (2),
ndihmë të zgjidhim prangat e nënës.
Unë në Ftijë do të të rrit,
që ti të bëhesh dikur për ta
armik i madh. Juve të Spartës,
po t'ju mungonte fama në armët
dhe trimëria nëpër betejat,
dijeni mirë se në të tjerat
ju më të lartë nga kushdo tjetër
nuk jeni kurrë

1) D.m.th., Andromakës.

2) Djali i Andromakës.

Kori

Ësht' i rrëmbyer brezi i pleqve;
kur zemërohen, ësht' zor të truhesh.

Menelau

Ti për të sharë je shum' i zoti;
po unë q'erdha për hall në Ftijë,
s'dua të bëj, as të pësoj
ndonjë të keqe. Tani, pra, mbasi
nuk kam as kohë, do shkoj n'atdhe;
se afër Spartës ësht' një qytet,
që kish më parë miqsi me ne,
porse tani si armik sillet;
kundër këtij m'ushtri do sulem,
që ta pushtoj; e si të kryej
punët aty ashtu si dua,
do kthehem prapë; aherë unë
ballë për ballë me dhëndërin tim
do t'i them hapur ç'kam për të thënë
dhe do dëgjoj ç'do të më thotë.
Po ta dënojë këtë këtu (1)
dhe paskëtaj po qe se sillet
mirë me ne, të njëjtën sjellje
ka për të gjetur nga ana jonë;
po në u ndeztë nga zemërimi,
dhe ne të ndezur do të na gjejë;
shkurt, si do bëjë, ashtu do gjejë.
Dhe, sa për fjalët e tua, plak,
leht' i duroj; se ti vërtet
ke zë **dhe flet, po je një hije**
dhe je i zoti vetëm për fjalë.

1) D.m.th., Andromakën.

Peleu

Eja, o bir, nën krahun tím
dhe shko përpara; kështu dhe ti,
grua e mjerë; pasi të rrahu
stuhi e egër, në fund arrive
në port të qetë.

Andromaka

Hyjtë, or plak, ty dhe të tuve
ua shpërblefshin me plot të mira!
Se më shpëtove djalin dhe mua,
mua të mjerën. Po shoh se mos
këta këtu, pasi të fshihen
në një nga pjesët e shkreta t'udhës,
mos na sulmojnë dhe më rrëmbejnë
duke shikuar se ti je plak,
unë e dobët dhe djali foshnjë;
shiko, pra, mirë, se ne vërtet
tani mund t'ikiim, po pak më vonë
mund të na zënë.

Peleu

Nga goja nxjerr ca fjalë, grua,
që kallin frikë, ashtu siç bëjnë
të gjitha gratë. Po shko përpara;
e kush prej jush do të guxojë
ta prekë gruan? Sigurisht, ky
me lot do qajë, nëse e prek.
Me hir të hyjve, në Ftijë këmi
një kalori e një ushtri
shumë të madhe. Unë jam edhe

me trup tē drejtë dhe plak nuk jam
siç kujton ti. Ndonëse jam
në mosh' i shkuar, burrë tē tillë
si ky këtu, me një tē parë
do ta rrëzoj; plaku me zemër
është m'i fortë nga shum' tē rinj:
se një frikashi ç'dobi i sjell
forca e trupit?

(*Dalin Peleu me Andromakën dhe Molosin*)

(*SKENA E PESTË*)

Kori

Strofa: Ng' ana ime lus
që ja tē mos lindem,
ja tē lindem, po
prej prindësh tē mirë
dhe tē rrjedh prej dere
me kamje tē madhe.
Se në rast që ndodh
ndonjë gjë e keqe,
atyre që rrjedhin
prej dere tē tillë
nuk do t'u mungojnë
ndihma dhe fuqia (1);
gjithashtu këta
që janë prej fisi,

1) Do tē thotë mbasë për Molosin, birin e Neoptolemit dhe nipin e Akilit.

gjithmonë i ndjek
nderi dhe lavdia;
se gjurmët që lënë
njerëzit e mirë
koha nuk i zhduk (1);
virtutyi i tyre
ndrit edhe pas vdekjes.

Antistrofa: Èsht' shumë më mirë
 të mos kesh fitore
 me turp të mbuluar,
 sesa drejtësinë
 ta shkelësh me forcë
 edhe me urrejtje.
 Një fitor' e tillë
 hëpërhc për njerëzit
 ësht' vërtet e ëmbël;
 po kjo ëmbëlsi
 me kohë venitet,
 thahet edhe bëhet
 njollë e shtëpisë.
 Unë ja se ç'jetë
 lavdëroj dhe dua:
 si nëpër shtëpitë,
 ashtu dhe në shtët,
 të mos ketë fare
 pushtet e fuqi
 pa pasur për shoqë
 drejtësinë vetë.

1) Flet për Akilin.

Epoda:

O plak, Eakid (1),
fare mir' e di
se ti me lapitët (2)
Centaurve iu turre (3)
bash me atë shtizën
shumë të dëgjuar (4);
kur biri i famshëm
i Zeusit erdhi
dhe rrëthoi Trojën
me rrjetën e vdekjes,
ti me këtë bashkë
e ndave lavdinë
dhe n'Evrop' u ktheve. (5)

(*Nga pallati del mëndesha e Hermionës*)

-
- 1) Peleu.
 - 2) Lapitë: popull luftëtar; banonin në Tesali rrëth lumi Peneios. Këta, të ndihmuar edhe prej Peleut, luftuan me Centaurët dhe i mundën.
 - 3) Centaurë: popull luftëtar; banonin në Tesali rrëth maleve Pelion dhe Osa; e famshme ka qenë beteja midis këtyre dhe lapitëve.
 - 4) Thotë për shtizën që ia kishte dhuruar Keironi, mësuesi i Akilit
 - 5) Në një frangment të Pindarit bëhet fjalë se si Peleu mori pjesë në ekspeditën e Herakliut (birit të Zeusit e të Alkmenës) kundër Trojës. Për këtë ekspeditë flitet shpesh në Iliadën (v. 638 etj.)

A K T I I I

S K E N A E P A R È

(Mëndesha — Hermione — Kori)

Mëndesha

O gra tē shtrenjta, sa tē këqija
njëra pas tjetrës po ndodhin sot!
Zonj' e shtëpisë — dua tē them
për Hermionën — kërkon tē vdesë;
së pari, pse e la i ati,
pastaj mendon se ç'krim ka bërë
duk' u orvatur tē vrasë djalin
e Andromakës dhe këtë vetë.
Prandaj, pra, dridhet se mos i shoqi,
kur ta mësojë se ç'plan ka pasur,
me turp e zbon nga kjo shtëpi.
a mos e vrasë; mbasi kjo deshi
tē vras' ata, tē cilët kjo
s'duhej t'i vriste. Tani shërbyesit,
q'jamë ngarkuar ta ruajn' atë,
mezi e mbajnë që tē mos varet,
mezi ia hoqën nga duart shpatën.

Aq shumë vuan! Aq shum' e ndjen
se ç'krim do bënte. Un', o mikesha,
mjaft u përpoha të mos e lë
të varë veten; më kot u lodha;
prandaj ju hyni më këto dhoma
që të shpëtoni gruan nga vdekja;
se, kur ndërhyjn një mik i ri,
më fort këtij i bindet botë,
sesa atij mikut të vjetër.

Kori

Dëgjoj një britmë; del nga shtëpia
e zonjës sate; britma del mbasë
nga shërbëtorët; e vërteton
lajmin që solle. Si duket, do
të na tregojë e mjera grua
se sa pëson nga të këqijat
që do të bënte; del nga shtëpia,
ikën nga duart e shërbëtorëve;
s'do të jetojë; kërkon të vdesë.
(*Në skenë hyn Hermione, duke shkulur
flokët dhe duke çjerrë fytyrën*).

Hermiona

Strofa I:

E mjera unë!
Do ti shkul flokët,
do çjerr fytyrën
me këta thonj.

Mëndesha

Ç'do bësh, moj bijë?
vetë ti trupin
do copëtosh?

Antistrofa I:

Hermiona

Medet! Medet!
Ti, mbules' e hollë,
fluturo në erë,
qëndro larg e larg
nga flokët e mia.

Mëndesha

O bijë, mbulo,
mbulo krahërorin
dhe ujdise rrobën.

Hermiona

Strofa II:

Pse ta mbuloj
gjoksin me rrobën?
Ato që bëra
kundrejt tim shoqi
nuk fshihen dot,
janë të qarta.

Mëndesha

Vallë mos vuan
mbasi ke dashur
të vrasësh shemrën?

Antistrofa II:

Hermiona

Qaj e rënkoj,
sepse tregova
guxim të tmerrshëm;
për njjerëzinë
jam e mallkuar,
jam e mallkuar.

Mëndesha

Po këtë faj
do të ta falë
vetë yt shoq.

Hermiona

Pse ma rrëmbeve
shpatën nga dora?
Nëma; e dashur,
nëma ta ngul
në kraharor.
Pse s'ma le lakun
ta shkoj rrëth qafës?

Mëndesha

Ti je pa mend;
si, pra, të t'lija
të vrasësh veten?

Hermiona

Oh, fat i zi!
Vallë ku është
flaka e zjarrit
q'e dëshiroj?
Ku të gjej shkëmb —
— ose në det,
ja në pyll malesh —
që, si të ngjitem,
vdekje të gjej

edhe të zbres
në hijet posht (1)?

Mëndesha

Pse vuan aqë?
Nuk ka në botë
asnjë njeri,
që mos ket' pasur
herët a vonë
ndonjë mynxyrë
nga perënditë.

Hermiona

Më le, o atë,
në breg të detit,
më le të shkretë
pa rrem detar (2).
Do të më vrasë,
do të më vrasë
sigurisht burri;
më s'do bamoj
në këtë strehë,
ku u martova.
Po në ç'statujë
të shkoj si lutse?
Apo t'i bie
skllaves në gjunjë

1) D.m.th., në botën e të vdekurve, në Hadi
2) «Rrem detar» lopatë për të çarë detin.

mu si një skillave?
Sikur tē bëhem
— pér t'ikur shpejt
nga tok' e Ftijes —
zog pendëkaltër
ose anije
prej druri pishe
që çau e para
gurët kyane (1)!

Mëndesha

Bijë!

As kur ke bërë gabim tē madh
kundrejt kësaj gruas trojane
nuk tē lëvdova, as tani prapë
që trembesh tepër, nuk tē lëvdoj.
S'ka sesi burri tē tē lëshojë,
duk' iu bindur fjalës së një
femre tē keqe, femre barbare.
Se s'të ka sjellë skillave nga Troja
po tē ka marrë pér grua ty,
bijën e një ati fisnik,
muse me pajë tē madhe pas
dhe prej qyteti tē pasur fort.
Yt atë, bijë, s'të tradhëtoi,
sikundër trembesh, dhe s'do lejojë
që tē tē zbojnë nga **kjo shtëpi**.

1) Gurët Kyane ose Simplegade ishin dy shkëmbinj njëri kundrejt tjetrit në hyrjen e Bosforit. Këta, duke lëvizur, dërrmonin anijet që kalonin midis tyre, gjersa kaloi aty anija Argo; q'aherë nuk lëvizin më.

Po hyrë brenda; jashtë shtëpisë
mos dil, moj bijë; ësht' turp të t'shohin
jashtë në derë.

(*Hermiona hyn nē pallat*)

Kori

Një udhëtar të huaj shoh;
ky vjen nga me me çap të shpejtë.

(*Hyn Oresti*)

SKENA E DYTE

(*Kori — Oresti — Hermione*)

Oresti (Korit)

Ky ësht' pallati, o gra të huaja,
i zotit t' vendit, birit t'Akili?

Kori

Pikërisht ky; po ti kush je?

Oresti

Un' jam Oresti, më kanë lindur
Agamemnoni me Klitemnestren.
Shkoj në Dodonë, ku ësht' orakulli
i Zeusit, atit të përendive.
Mbası kalova këtu nga Ftija,
deshë të pyes për Hermionën,
që ësht' nga Sparta dhe e kam fiis:

a rron kjo grua? A ësht' e lumtur?
Ndonëse kjo larg nesh banon,
gjithmon' e dashur na është fort.

(*Hermiona del nga pallati*)

Hermiona

Ti, o bir i Agamemnonit!
Më ërdeh sot dhe je për mua
ashtu si porti për lundërtarët
në kohë dallge. Të lutem shumë,
për këta gjunjë, më mëshiro
për këtë fat që po e sheh;
jam një e mjerë; duart e mia,
që kanë prekur gjunjët e tu,
janë në vend të asaj degës
që sjell një lutës.

Oresti

Ah!

Ç'është, ç'po shoh? Mos më bëjn' sytë,
apo vërtet po shoh të bijën
e Menelaut, që është zonja
e kësaj vatre?

Hermiona

Sheh pikërisht vajzën e vetme;
këtë Helena, bij' e Tindarit,
ia ka falur në atë vatrë
burrit të saj dhe atit tim;
tani, pra, ti i di të gjitha.

Oresti

O Feb shëronjës, këtë liroje
nga të këqijat. Por se ç'ndodh vallë?
Këto mjerime nga hyj të vijnë
apo nga mjerëz?

Hermiona

Ca nga un' vetë, ca nga im shoq
e ca të tjera nga ndonjë hyj;
siç sheh, sulmohem nga tërë anët.

Oresti

Gruas që ende fëmij' s'ka lindur,
kush mund ti sjellë fatkeqësira,
veçse martesa?

Hermiona

Ah, pikërisht nga kjo po vuaj;
ma nxore fjalën me mjeshtëri.

Oresti

Mos i pëlqen ndonjë shtrat tjetër
më fort tët shoqi se shtrati yt?

Hermiona

Skllaven e do, atë që pati
grua Hektori.

Oresti

Esht' gjë e keqe të këtë burri
dy bashkëshore.

Hermiona

Kështu ësht' puna; prandaj dhe unë
e mbrojta veten.

Oresti

Mos kundër gruas kurdise gjë
ng'ato që bëjnë zakonisht gratë?

Hermiona

Deshë të vras edhe atë,
dhe atë doç, birin e saj.

Oresti

E, pra, e vrave? Apo dikush
të ka ndaluar?

Hermiona

Më ka ndaluar plaku Pele,
që mbron, përkrah më të këqijtë.

Oresti

Kush tjeter merrte pjesë me ty
në këtë vrasje?

Hermiona

Im at', që erdhi nergut nga Sparta.

Oresti

Si, pra, u mund nga dor' e plakut?

Hermiona

Nga dora jo, po nga respekti;
prandaj dhe iku, më la të shkretë.

Oresti

Kuptova; dridhesh nga burri yt
për çka ke bërë.

Hermiona

Mir' e kuptove; porse ai
me plot të drejtë do të më vrasë.
E pse ta zgjat? Të lutem shumë,
n'emër të Zeusit, i oili mbron
farefisninë, të më dërgosh
larg, shumë larg prej këtij vendi,
a në pallat të atit tím;
sepse më duket sikur dhe dhomat
e kësaj vatre flasin dhe thonë
që të largohem; pastaj m'urren
dhe tok' e Ftijes. N'ardihtë më parë
në shtëpi burri, duke u kthyer
që nga orakull' i Apolonit,
do të më vrasë për ato plane
shumë të turpshme; ose do bëhem

skllave gruas tij ilegale,
 që s'kllavja ime ishte më parë.
 Dikush do thotë: «Po si i bëre
 këto gabime?». Ca gra të liga,
 q'erdhën tek unë, më shkatërruan;
 më ndezën fort me disa fjalë
 ja si këto: «A do durosh
 të marrë pjesë në shtratin tënd
 skllavja m'e keqe? Për perëndeshën (1),
 unë të paktën nuk do duroja
 të shohë diellin në shtëpi time
 dhe të shijojë gazet e shtratit».
 Unë aherë, sapo dëgjova
 këto Sirena (2), fjalët e tyre
 plot me dredhira, u qmenda fare.
 Vërtet, ç'më duhej se ç'bënte burri,
 po sa q'asgjë nuk më mungonte?
 Kisha një kamje shumë të madhe;
 dhe isha unë zonj' e shtëpisë;
 do lindja djem, fëmij legalë;
 këta do kishin gjysmëshërbyes
 fëmijët e saj, fëmijët doçer.
 Po kurrë, kurrë — e them dhe prapë
 kam për ta thënë — burri me mend
 s'duhet të lërë që tek 'e shoqja
 të hyjnë grá; se e mësojnë

- 1) Perëndesha Era, mbrojtëse e martesave
- 2) Simbas mitologjisë, kanë qenë vajza me krahë dhe banonin në bregdetin e Italisë së poshtme. Me zérat e tyre dhe me këngët melodike, tërhiqin udhëtarët dhe i copëtonin, gjersa kaloi Odiseu, i cili shokëve ua mbylli veshët me dyllë dhe s'i la të magjepseshin nga këngët e tyre, aherë këto u hodhën në det dhe u mbytën.

vetëm e vetëm për të këqija.
Njëra ia prish moralin gruas,
sepse e shtyn ndonjë fitim;
tjetra sepse ka bërë faj
dhe do të ketë bashkëfajtore;
një palë tjetër — q'janë të shumta —
e prishin gruan të shtyra vetëm
nga marrëzia; nga këto, pra,
vuan e prishet vatra e burrit.
Prandaj ju, burra, ruani mirë
shtëpinë tuaj, mbyllini dyert
me kyç' e lloze; se gratë q'hyyjnë
në shtëpi s'jashtmi nuk sjellin kurrë
ndonjë të mirë, po plot të liga.

Kori

Grua, ti kundër grave lëshove
gjuhën si tepër; vërtet kjo gjuhë
të falet sot, por se detyra
e gruas është të paraqitë
veset e femrës në formë t'bukur.

Oresti

Ka qen' i ditur ai që njerëzit
i ka mësuar që të dëgjojnë
fjalët që dalin nga kundërshtarët (1).

1) Oresti gjëzohet se kishte dëgjuar thashethemet që vinin nga ana e kundërshtarëve të tij (Nga Neoptolemi). Se kështu mësoi grindjen midis Hermione-s dhe Andromakës dhe mundi të përfitonë nga ky rast për të vepruar.

Kur mora vesh se sa e çrregullt
ësht' kjo shtëpi, se kishte hyrë
grindja mes teje dhe gruas Hektorit,
prisja të shoh se ç'do të bëje:
do dëshiroje të rrish këtu
apo nga frika e gruas skllave
do deshe t'ikje nga kjo shtëpi.
Erdha këtu, pa më dërguar
ti ndonjë letër, me qëllim që,
po të më thoshe, siç po më thua,
të të largoj nga kjo shtëpi.
Se ti më parë ke qen' e imja;
porse tani nga ligësia
e atit tënd rron me atë
q'ë ke sot burrë. Vërtet yt atë,
pa shkelur edhe tokën e Trojës,

premtroi se me mua ty
do t'të martonte; më vonë tha
se do të bënte dhëndër atë
që ke sot burrë, po që se ky
do prishte Trojën. Po kur u kthyte
dhe erdh këtu biri i Akilit,
ja fala fajin babait tënd
dhe iu luta Neoptolemit
të hiqte dorë ai nga ti
edhe për grua të mos të merrte,
duk' i treguar mynxyrat q'hoqa
dhe fatn' e keq që kam tani.

«Nga miqt e mi, nga farefisi,
— i thashë unë, — mund të gjej grua;
porse nga jashtë nuk është e lehtë,
si njeri q'ika nga vendi im
dhe jam tani i arratisur».

Ai më shau duke përmendur
vrasjen e nënës dhe Erinitë
me sy të gjakshëm (1). Un', i rrëzuar
ng'ato mjerimet e shtëpis' sime,
vuaja ah! vuaja shumë,
po i durova këto mynxyra
dhe, meq' u prish martesa jonë,
u nisa, ika. Tani, pra, mbasi
fati për ty u kthye keq
dhe në mjerimin që ndodhesh sot
s'di se ç'të bësh, do të të marr
nga kjo shtëpi dhe tek yt atë
do të të shpie.

Kori

Lidhjet e gjakut e të gjinisë
kanë fuqi shumë të madhe;
në rast mjerimesh askush s'itë ndih
më shumë se ai q'e ke
gjak edhe fis.

Hermiona

Sa për martesën time, im atë
do përkujdeset; s'më përket mua.
Po ti tani sa më shpejt nxirrë
nga kjo shtëpi, se mos im shoq.
më parë vjen dhe më arrin
a mos Peleu, duke mësuar
q'ika dhe lashë shtëpinë shkretë,
dërgon kalorës për të na ndjekur.

1) Thotë për vrasjen e Klitemnestrës dhe për Erinitë, q'e ndiqnin Orestin për ta dënuar si vrasës të nënës së tij.

Oresti

Nga dor' e plakut mos u tremb fare;
po edhe nga djal' i Akilit,
që m'poshtëroi më aq të shara,
të mos kesh frikë. Se unë ja,
më këto duar ia kam ngritur
rrjetën e vdekjes, rrjetë me lëqe
që s'zgjidhen dot, që nuk këputen.
Për këtë rrjetë tani s'po flas;
po kur më vonë do kryhet puna,
do ta mësojë shkëmbi Delfik (1);
dhe ai djali që vrau t'ëmën (2),
po që se mbajnë ben' aleatët
në sheshin e tokës pitike,
do t'i tregojë Neoptolemit,
se s'bëni mirë që u martua.
me atë vajzë, të cilën dikur
i ati vetëm ma kish premtuar.
Do të pendohet që ka kërkuar
nga Apoloni hakmarrje për
vrasjen e t'et; po ky pendim
s'ka për t'i ndihur: do të dënohet
prej perëndisë, keq do mbarojë
për ato shpifje që bëni kundër
hyjit dhe meje; urejtjan time
ka për ta njojur. Se perëndia
zakonisht kthen dhe e përmbyss
fatn' e atij q'e ka armik;
s'e lë të mburret.

(Del Oresti me Hermionën)

1) Shkëmbi ku ishte faltorja e Apolonit.

2) Flet për veten e tij.

Kori

Strofa I:

O Feb, që ngrite
 kështjella të fonta
 mbi kodrën e Trojës,
 dhe ti, hyj i detit,
 që dallgët i çan
 hipur mbi karrocë
 që shiqet prej kuajsh
 të shpejtë, të kaltër!
 Pse me krahun tuaj,
 që ngriti kështjellat,
 i keni ndihmuar
 hyjit Enial (1),
 heshtarit të aftë,
 dhe të mjerën Trojë
 ju e keni lënë
 pa një pikë nderi (2)?

Antistrofa I:

Aty përmbi brigjet
 e lumit Simoent (3)
 mbrejtët në karroca'
 kuaj më shumicë
 dhe kështu shkaktuat
 ndeshje, vrasje burrash,
 të cilët fitorja
 s'i kurorëzoi.

1) Enialios: mbiemër i Arít, hyjit të luftës.

2) Sipas Homerit (Iliad. XXI, 443), Apoloni dhe Poseidoni u urdhëruan t'i shërbnin Laomedontit, atit të Priamat, gjatë një viti. Në këtë kohë të dy këta ndërtuan muret dhe kështjellat e Trojës.

3) Lumi i Trojës, që buron nga malin Ida dhe derdhet në llumin e madh Skamandër.

Mbretërit e Iilit ⁽¹⁾
u vranë, mbaruan;
edhe në altaret
e hyjve të Trojës
nuk flakron më zjarri,
as nuk shpërndan më
tymin plot aromë.

Strofa II:

Vdiq Agamemnoni,
biri i Atreut;
dora e së shoqes
i ra dhe e vrau;
po dhe ajo vetë
e shkëmbeu vrasjen
me vdekjen e saj
që gjet nga i biri.
Orakull hyjnor,
vërtet hyjnor
urdhër i dha
— ahere kur biri
i Agamemnonit
nga Argosi u nis
dhe shkoi n'altar
të hyjit të Delfit —
që të bëhet vrasës
i nënës së tij.
O Feb, o hyj,
si mund ta besoj?

Antistrofa II:

Ndër mbledhjet e grekëve
shumë gra vajtonin
për fëmijët e mjerë;

1) Ili: Ka qenë i ati i Laomedontit (atit të Priamat) dhe themeluesi i Trojës, që quhej edhe Ilion pér kujtim të emrit të tij.

shumë länë vatrat
dhe kërkuan shtratin
e një burri tjetër.
Trishtime të mbrapshtë
s'ranë mbi ty vetëm
e mbi miqt e tu (1);
po sëmundja ra
mbi gjithë Greqinë;
rrufeja kaloi
edhe në Frigji
në fushat pjellore,
i goditi keq,
duke i vadirur
me një shi prej ferri.

(*Hyn Peleu me shërbëtorët pas*).

SKENA E TRETE

(*Kori — Peleu — Lajmetari*)

Peleu

Ju, gra të Ftijes, nëmni përgjigje
për këtë pyetje: në vesh më erdhë
një thashetheme, se nga shtëpia
ka ikur bija e Menelaut.
Prandaj kam ardhur, duk' u nxituar,
që të marr vesh n'ësht' e vërtetë;
se kur dikush s'ësht' në shtëpi,

1) I drejtohet, duket, Hermionës; me fjalën «miqtë» kupton Atridët.

për fatn' e tij duhet patjetër
të përkujdesen ata të tjerët.

Kori

Pele, ç'dëgjove, ësht e vërtetë;
nuk më ka hije të fsheh të keqen
që më ka rënë; pra, mbretëresha
iku, e la këtë shtëpi.

Peleu

Ç'frikë ka pasur? Thuaj, shpjegomë-

Kori

U tremb se mos e zbojë i shoqi
nga ky pallat.

Peleu

Mos pse ka dashur t'ia vrasë djalin?

Kori

Po;
pat frikë edhe nga robëresha (1).

Peleu

Me kë ka ikur? Apo me t'atin?

1) Andromaká.

Kori

Këtej e nxori i biri i
Agamemnonit

Peleu

Me ç'qellim vallë? A pér ta marrë
atë pér grua?

Kori

Po, edhe djalin e djalit tënd
kërkon ta vrashë.

Peleu

Duke i dalë ballë pér ballë
a duk' i vënë pritë, pusi?

Kori

Në tempull t'hirshëm të Apolonit,
duk' u ndihmuar nga Delfianët.

Peleu

I mjeri unë! Oh, ç'lajm i tmerrshëm!
(*Shërbëtorëve*)

Ndonjë prej jush le të vrapijë
atje në Delfi; njerëzve tanë
q'janë aty le t'u tregojë
Ç'po ndodh kötu; dhe kjo të bëhet,
para se t'vritet bir' i Akilit,
(*Hyn në skenë një lajmëtar*).

Lajmëtari

Medet! Medet!

Oh, un' i mjeri! Ç'lajm të zi erdha
të sjell, or plak, për ty dhe miqtë
e zotit tim!

Peleu

Oh, shpirti im diç parandien!

Lajmëtari

E, pra, mëso, or plak Pele,
se s'rron më biri i birit tënd;
me shpat' i ranë burri mikenas
dhe delfianët.

(*Peleut, me të dëgjuar këto, i merren këmbët*)

Kori (Peleut)

Ej, plak, ç'do bësh? Po bie; ngrehu.

Peleu

Ah, jam një hiç; vdiqa, mbarova;
zëri më là; këmbët m'u prenë.

Lajmëtari

Në do t'u ndihësh miqve të tu,
ngrehu, dëgjo se si ka ndodhur.

Peleu

Ah, tepér rëndë më re, o fat,
tani në kohën e pleqërisë!

(*Lajmëtarit*) Thuajmë si vdiq djali i vetëm
i djalit t'vetëm; vërtet nuk është
për të dëgjuar, po unë prapë
dua ta dëgjoj.

Lajmëtarri

Pasi arritëm në tokn' e famshme
të Apolonit, djelli tri herë
përshkoi rrugën e tij të ndritur (1);
në këtë kohë i ngopëm sytë
duke shëtitur e duke parë
çdo gjë që ishte në këtë vend.
Po kjo, si duket, e bëri gjindjen
t'hyj' në dyshim; prandaj banorët
e vendit t'hyjit zunë të mblidhen
edhe të ndahanë në grupe-grupe.
Aherë bir' i Agamemnonit,
duke kaluar nëpër qytet,
kujtdo për ne i fliste keq:
«A e shikoni këtë njeri
që shkon nër gropat e mbushura
me ar të hyjit, ku janë futur
ato thesaret q'janë kushtuar
nga besimtarët? Ësht' her' e dytë
që vjen këtu, për të plaçkitur
— ashtu si desh dhe herën tjetër —

1) D.m.th., kaluan tri ditë.

faltoren e Febit hyjnor».

Në çast aherë mbushi qytetin një pëshpëritje e keqe fort; autoritetet po bënин mbledhje dhe në kuvend po bisedonin; ata pastaj q'ishin emruar si kujdestarë të pasurisë së Apolonit vendosën roje nëpër kolonat rrotull faltores.

Po ne që edhe s'dinim se ç'ndodhët, muarëm dele q'i kish ushqyer mali Parnas mbushur me gjethe edhe i shpumë pranë altarit tok me proksenet edhe shortarët (1). Një nga këta, «O djale, — tha, — ç'lutje t'i bëjmë hyjit për ty?

Përse ke ardhur?»

«Dua të laj, — iu përgjegj, — mëkatn' e vjetër që un' i bëra Febit hyjnor; dikur atij shpagim i lypa për gjakn' e babës.» Porse aty rëndonte shumë fjal' e Orestit, që kishte thënë se im zot rrrente, se për qëllim të keq kish ardhur. Po ky pas pak kapërcen pragun, hyn në faltore për t'iu lutur Febit hyjnor bash atje ku jepen orakujt; ishte, pra, pranë kafshës së therur

1) Proksene (Proksenoj) quheshin ata që ishin ngarkuar të prisnin dhe të interesoheshin për një të huaj që vinte; kështu quheshin edhe ata që kryenin detyrën e konsumjve të sotëm.

q'ish duk' u djegur. Tamam aty
n'hijen e larit ish fshehur turmë
e armatosur, simbas një plani
që kish kurdisur një njeri vetëm:
ai q'ish lindur prej Klitemnestrés⁽¹⁾.
Ndërsa im zot në sy të t'gjithëve
i lutej hyjit, turma me shpata
të mprehta fort që pas i ranë
birit t'Akilit, q'ishte pa armë.
Ky menjëherë shpejt u tëahoq,
se s'ish goditur në vend të lig;
duk' u tërhequr, rërmbeu armët
ato që ishin varur në treme,
me vrap u hodh gjer në altar;
këtu qëndroi dhe tmerr u kalli
kujdo q'e shihte të armatosur.
Me zë të lartë pyeti 'djemt
e delfianve: «Përse po vrissni
një njeri q'erdhë për një qëllim
të shenjtë fort? Përse paditem?
Pse të dënohem?» Asnjë ng' ata
— ishin me mijëra dhe pran' atij —
nuk u përgjigj, po që të gjithë
zunë të hedhin gurë mbi të;
ky, që të ruhet, vinte përpara
armët, mburojën, duke e zgjatur
herë këtu, herë atje;
porse më kot; shigjeta q'hidhnin
mbi të si breshër; shtiza — disa
me rrip në mes, disa pa rrip —

1) D.m.th., Oresti.

dhe hej tē hollë me nga dy maja;
 këto tē gjitha dhe në një kohë
 binin përpara këmbëve tē tij.
 Ta shihje djalin se si kërcente,
 duk' u përpjekur tē mbronte veten
 nga ky rrebesch! Po kur armiqtë
 nga tërë anët ngusht' e rrethuan,
 aq sa s'e linin tē merrt' as frymë,
 e la altarin plot me therorët
 dhe me kërcim bash si i Trojës (1)
 iu turr armiqve; tmerr i pushtoi,
 ikën me vrap dhe u shpérndanë
 mu si pëllumbat, kur shohin qiftin.
 Gjatë rrëmujës që u shkaktua,
 shumë u vranë: disa nga plagët,
disa tē shkelur njëri prej tjetrit,
 se daljet ishin tepër tē ngushta.
 Britm' ogurzezë nëpër mermeret
 e këtij vendi tē shenjtëruar
 ushtoi fort; im zot, përkundër,
 kishte qëndruar i qetësuar
 dhe po shkëlgente me ato armë
 tē ndritshme fort, gjersa dikush
 që nga altari lëshoi zë
 fort tē tmerruar; ky i dha turmës
 fuqi, kurajë tē kthehet prapë.
 Në çast goditet, bie përdhe
 bir' i Akilit; një delfian

1) Në fushën e Trojës ishte një vend, i cili, si thuhej, quhej «Akileos pedema» (kërcimi i Akilit); ky vend mori këtë emër nga kërcimi që bëri Akili, duke u hedhur prej anijes në tokë.

me shpatë t'prehur i ra në bri
dhe, i ndihmuar nga shumë të tjera,
e vrap e djalin. Si ra përdhe,
kush nuk i ra me shpat' e gurë?
I gjithë trupi i tij i bukur
u transformua nga plagë t'egra!
Kufomën, q'ishte afër altarit,
me vrap e ngriten edhe e hodhën
jashtë faltores, ku bëhen flitë.
Po ne me duart ton' e rrëmbyem
dhe po ta sjellim që të vajtosh,
ta qash, o plak, dhe ta varrosësh.
Ja kështu hyji — q'i parathotë
tjetrit të ardhmen, që gjithë njerëzve
u ndan të drejtat — i është sjellë
djalit t'Alkilit, që kishte ardhur
t'lajë mëkatin; ndërsa ai¹)
kujtoi ankime shumë të vjetra,
pikërisht si njeri i lig.
Si, pra, ai mund t'jet' i ditur?
(*Del nga skena*).

(*Në skenë sjellin kufomën e Neoptolemit*).

SKENA E KATËRT
(Kori — Peleu — Teti)

Kori

Ja mbreti ynë
vjen në pallat

1) Hyu.

i mbartur peshë
nga tok' e Delfit.
I mjeri ky
që keq pësoi,
i mjerë je
dhe ti, o plak,
q'e pret tët nipp
në vatrën tënde
jo siç ke dashur.
Gjer tani hoqe
shumë të zeza,
sot po merr pjesë
edhe në fatim
e këtij burri.

Peleu

Strofa I:

Oh, un' i mjeri!
Ç'ësht' kjo e keqe,
që po e shoh,
q'e marr në duart,
q'e pres i mjeri
në shtëpi time?

Medet! Medet!

O ti, qytet
i Tesalisë!
Humba, mbarova.
S'është më, u shojt
ky fisi im;
asnje më s'mbet
në vatrën time.
Oh, un'i mjeri,

oh, se ç'pësova!
kujt paskëtaj
t'i shtie sytë,
që t'ëmbëlsohem
në shpirtin tim?
O goj' e dashur,
o dor' e mjekër!
Makar Demoni
të të kish vrarë
Në Trojë, n'ujrat
e Simoentit!

Kori

Po t'ishte vrarë, o plak, në Trojë,
dhe ky do kishte nder e lavdi,
dhe ti do ishe më pak fatkeq.

Peleu

Antistrofa II:

O ti, martesë,
O ti, martesë
që shkatërrrove
këtë shtëpi,
këtë qytet!
Oh, oh, o bir,
makar, o bir,
ky fisi im
q'u bë fatal
dhe për fëmijët,
dhe për shtëpinë
nga kjo martesë —
të mos kish marrë
në gjin' e tij

xhindin e keq,
at' Hermionën,
që tē shkatrroi!
Makar rrufeja
t'i kishte rënë,
ta kishte vrarë
pérpara dasmës!
Makar ti kurrë
tē mos kérkoje
shpagim nga Febi
— ti një i vdekshëm
nga një q'ësht' hyj —
pér një shigjetë,
që vau t'ët atë!

Kori

Strofa II: Medet! Medet!
Ah, pér tim zot,
që s'ësht' më gjallë,
do nis vajtimin,
siç ësht' zakon,
pér tē nëndheshmit.

Peleu

Antistrofa II: Oh, obobo!
Dhe un' i mjéri
një plak fatzi,
do tē derdh lot.

Kori

Strofa III: Ka qenë kjo
dëshir' hyjnore,

Ndonj' hyj ka dashur
këtë mynxyrë.

Peleu

Antistrofa III: O bir i shtrenjtë,
medet! të shkretë
ma le shtëpinë!
Oh, ububu,
të mjerin plak
e le pa djalë!

Kori

Makar, o plak,
të kishe vdekur
përpara djemve!

Peleu

Të mos i shkul
flokët e mi?
Të mos i bie
kokës me grusht?
Qytet, qytet!
të dy fëmijët
m'i mori Febi!

Kori

Strofa IV: O plak i mjerë,
që pe, që hoqe
plot të këqija,
ç'jetë do shkosh
që sot e tutje?

Peleu

Do rroj pa djem,
do rroj i shkretë;
vuajtjet e mia
s'do kenë fund,
gjersa të zgres
te Hadi pështë.

Kori

Antistrofa IV: Ty me martesën
më kot të bënë
të lumtur hyjtë (1)

Peleu

M'ikën të gjitha,
më fluturuan:
fluturoi dhe
ç'do mburrje kotë!

Kori

Paskëtaj ti,
do rrosh i shkretë,
në shtëpi t'shkretë!

1) Sipas Pindarit (Nem. IV, 66—8), Peleu u martua me një nga Nereidet, bijat e Nereut, hyjit të detit. Në dasmë kishin ardhur hyjtë e qellit dhe të detit me dhurata të shumta. Këta premtuan se do t'u siguronin të martuarve lumturi të përherershme.

Peleu

S'kam më qytet;
 edhe ky skeptër
 vaftë në dreq! (*E hedh skeptrin*)
 Bi' e Nereut
 nga shpell' e errët
 do të më shohësh
 të bie kufomë.

Kori

Medet! Medet!
 Ç'tundet, ç'lëviz?
 Ç'gjë vall' hyjnore
 po ndiej t'afrohet?
 Edhe ju, vajza,
 vini re, shihni;
 ja një hyjni
 po e çan ajrin,
 ajrin e bardhë
 edhe në fushat
 e Ftijes zbret,
 të kësaj Ftije
 që ushqen kuaj.
 (Teti zbret nga lart në skenë).

Teti

Jam unë Teti; erdha, Pele,
 për hir të dasmës sonë të vjetër,
 si lashë vatrën e Nere hyut.
 Së pari, pra, të këshilloj
 që jashtë masës të mos helmohesh
 për të këqijat që po të ndodhin;

dhe unë, ndonëse duhej të lindja
bij për të cilët lot të mos derdhja,
djalin që bëra me ty e humba,
Akilin, q'ishte i shpejt' nga këmbët
dhe në Greqi ka qen' i pari.

Përse kam ardhur do të të them
dhe ti dëgjo; këtij këtu,
djalit t'Akilit, q'është i vrarë,
trupin ia merr, shpjere në Delfi
dhe pran'altarit aty varrose,
që të dëshmojë turpin e kryer
nga delfianët dhe vrasjen, krimin
të kryer prej dorës s'Orestit.

E sa për skllaven — dua të them
për Andromakën — duhet të rrojë
në Molosi, pasi Helenin
të marrë burrë; (1) bashkë me gruan
duhet të shkojë edhe ky djalë,
që mbet i vetmi nga Eakidët.

Prej këtij djali ka për të dalë
një seri mbretërish që do sundojnë
njëri pas tjetrit në Molosi

plot me lavdi dhe lumturi.

Sepse nuk duhet, or plak, të shuhet
fisi im, yti edhe i Trojës;
se hyjt kujdesen edhe për Trojën;
e, në ra kjo, ra se kështu
deshi Palada. Ty, o Pele,
që të ndjesh gazin e shtratit tim,
do t'të liroj nga të këqijat

1) Heleni ka qenë bir i Priamat dhe i Hekubës; u zu rob prej Neoptolemit dhe u soll në Epir. Këtu u martua me Andromakën, të venë Hektorit dhe mbretëroi në një pjesë të Molosisë.

q'heqin tē vdekshmit dhe do t'tē bëj
 që tē mos njohësh prishje dhe vdekje.
 Dhe paskëtaj ti perëndi,
 unë hyjneshë, do tē banojmë
 në dhomat e atit Nere.
 Këtej do dalësh pa lagur këmbën (1)
 n'ujrat e detit dhe do tē shohësh
 Akilin tonë shumë tē dashur;
 banon në breg t'ishullit Leuke (2)
 në Detn' e Zi. Shko, pra, në Delfi,
 n'atë qytet, q'e ka ndërtuar
 ndo një nga hyjtë, shpjere aty
 këtë kufomë dhe, si ta kallësh
 në atë dhe, shko edhe rri
 n'spellën e zgavërt tē shkëmbit t'vjetër
 tē Sepiadës. (3) Qëndro këtu
 gjersa tē kthehem nga deti bashkë
 me Nereidet — pesëdhjet' janë —
 që do t'i kesh si udhëheqëse.
 Pastaj ç'ka thënë fati për ty,
 tē durosh duhet; ndodhën kështu,
 mbasi ka dashur Zeusi vetë.
 Për ata, pra, që kanë vdekur,
 mos u helmo; se perëndite
 vdekjen u dhanë tē gjithë mjerëzve
 dhe që tē gjithë këta do vdesin.

(Teti zhdukët)

1) Ujërat e detit tërhiqen përpara qerres së Poseidonit dhe qerrja shkon pa u lagur rrotat e saj (Iliad. XIII, 29) Kështu edhe në këtë rast ujët e detit do tē tërhiqet e Peleu nuk do t'i lagë këmbët.

2) Në këtë ishull ishte ndërtuar një faltore për nder tē Akilit; këtu ishte edhe statuja e tij. (Pausania, III, 19, 11). Ishulli quhet sot Fidoniisi.

3) Sepias: kep kundrejt malit Pelion (në Tesalii) në jug tē krahinës Magnesi

Peleu

Bij'e Nereut, fort e nderuar,
o gruaja ime nga fis i lartë,
udhë e mbarë! Sillesh, vepron
si të ka hije ty dhe fëmijve
lindur prej teje. Do pushoj lotët,
siç m'urdhëron, o perëndeshë,
dhe, si ta kall në dhe këtë,
do shkoj në shpellat e Pelionit,
ku trupim tënd të bukur fort,
me dor' e preka. E, pra, dikush
q'është me mend, edhe në s'merr
grua prej fisi, edhe të bijat
nuk i marton me djem fisnikë,
prapë të mos lakmojë kurrë
nuse të keqe, dhe në i sjelltë
pajë të madhe atij n'shtëpi.
Kështu prej hyjve kurrë s'do vuajë.

(Dalin të gjithë)

Kori

Forma të shumta marrin demonët
dhe ngjarje t'befta ata gatitin;
atë çka pritej s'e lenë të kryhet
dhe së papriturës i hapin shtegun.
Të till' fund pati edhe kjo ngjarje.

IFIGJENIA NË TAURIDË

PERSONAZHET:

*Ifigjenia, e bija e Agamemnonit,
Oresti, vëllai i Ifigjenisë,
Piladi, i shoqi i Elektrës, motrës së Ifigjenisë
dhe të Orestit.*

Kori.

Lopari.

Toanti, mbreti i Tauridës.

Lajmëtari.

Atena, hyjneshë, bija e Zeusit.

*Shfaqja bëhet në Tauridë përpëra tempullit të Artemidës.
Në vend të dukshëm është altari, i skuqur prej gjakut
të viktimave.*

AKTI I

SKENA E PARË

Ifigjenia (Del nga saltorja).

Bir' i Tantalit, Pelopsi vetë (1),
erdhi në Pisë me kuaj t'shpejtë,
aty për grua mori të bijën
e Enomaut, q'Atreun lindi (2).
Ky pat për bij Agamemnonin
e Menelaun; Agamemnoni
me Tindaridën (3) më lindën mua,
Ifigjeninë; aty ku shpesh
Euripi tund detin e kaltër (4)

-
- 1) Sipas mitologjisë, Pelopsi, biri i Tantalit, mbretit të Frigjisë, dhe i Dionës, bijës së Atlantit, erdhi në Elidë të Peloponezit dhe u martua me Hipodaminë, vajzën e mbretit të Elidës Enomaut. Mbretëroi këtu 59 vjet dhe pas vdekjes u nderua si hero prej banorëve, të cilët për nder të tij festonin edhe festë të veçanë që quhej «Pelopeia».
 - 2) Përveç Atreut, lindi edhe Tiestin, Krisipin dhe Hipalkimin.
 - 3) D.m.th. Klitemnestren, që ka qënë bijë e Tindarit mbretit të Spartës.
 - 4) Euripi: grykë në mes të ishullit Eube dhe steresë së Greqisë.

dhe i shtjell ujrat me ato erëra
shumë të shpeshta, aty im atë (për shkak t'Helenës)
më bëri fli, siç po beson, (1)
përmbi altarin e Artemidës
në gji t'Aulidës, gji famëmadh.
Se këtu mbreti Agamemnon
mblodhi një mijë anije greke
Akejve trima pér t'ju dhuruar
kurorn' e bukur t'fitores n'Trojë.
'Deshi pastaj dhe Menelaut
qe jin t'ia bëjë, duk'ua marrë
hakun atyre q'ia kishin fyer
gruan, Helenën. Po mbasi flota
edhe s'po nisej, se kish er' kundër,
pyeti faltarin se ç'thonë flitë:
aherë ja ç'i tha Kalkanti:
«Agamemnon, që prin këtë
ushtëri greke! Asnjë anije
mos prit të dalë prej këtij vendi,
pa ia bëre fli Artemidës
ti vajzën tëndë Ifigjeninë.
Kishe premtuar që të bësh fli
pérnder t'hyjneshës që na fal dritën
çdo që rreth vitit do lind' m'e bukur.
Pra, Klitemnestra, gruaja jote,
në shtëpi vajzë solli në dritë
(Dhe më dha qëmimin e bukurisë),
të cilën fli duhet ta bësh».
Dinakëria e Odiseut
më shkuli prej krahut të nënës,
duke përhapur se gjoja mua

1) Agamemnoni besonte se me të vërtetë kishte bëre fli Ifigjeninë.

m'Akil Pelidin do më martonin.
Në Aulidë erdha e mjera;
më vunë përmri zjarr të altarit;
më ran' me shpatë, po Artemida
më vodhi nga duart e Akejve,
në vendin tim la një drenushë
dhe më dërgoi përmes eterit
fort të shkëlqyer në këtë tokë
të Tauridës, ku po banoj.

Këtu mbi popull barbar sundon
një mbret barbar: është Toanti,
i shpejt' nga këmbët mu si një shpend;
kjo shpejtësi i dha dhe emrin.

Pastaj hyjnesha më vuri mua
si priftëreshë në këtë tempull,
ku sipas ligjit të një kremitimi,
që i pëlqen kësaj hyjneshe
dhe që veç emrin e ka të bukur,
(sa për të tjerat s'flas, se kam frikë
nga perëndesha) bëj fli çdo grek,
që shkel këtu, siç ish zakon
edhe më parë. Ceremoninë
e filloj unë, porse të tjerë
flit'e mistershme i bëjnë brenda
në këtë tempull të perëndeshës.
Natën që shkoi pashë një ëndërr
fort të çuditshme: Këtë eterit (1)
do t'ia tregoj, se kështu mbasse

1) Ëndrrat e liga, që shikonin natën grekrit e vjetër, ia tregonin diellit, për të zmbrapsur, siç besonin, të këqijat e paralajmëruara nga ëndrrat. Kujtonin se drita e ditës kishte fuqi të shpërndante tmerret e natës së errët.

do mund tē gjej ndonjë shërim.
M'u duk, pra, n'ëndërr se u largova
prej kësaj toke, se isha n'Argos,
mes shoqesh flija, dhe nga tërmeti
toka u tund, e jasht'shtëpisë
me vrap un'dola edhe qëndrova;
dhe n'atë çast pashë tē binin
tē tëra muret edhe tē shembej
përdhe nga shtyllat tepër tē larta
pullaz'i tërë. Siç m'u duk, mbeti
vetëm një shtyllë nga kjo shtëpi
e atit tim, ndërsa nga kryet
e kësaj shtylle vareshin poshtë
flokë tē verdhë, dhe zë njeriu
diltc prej tyre, e duk'ushtuar
detyrën time tē vras tē huajt,
po e spërkatja, si një që ndodhej
në prag tē vdekjes, dhe derdhja lot.
Ja tani ëndrrën si e shpjegoj:
Oresti vdiq; ky ish ai
që e spërkatja, se djemtë janë
shtyll' e shtëpisë; kushdo që unë
spërkat me ujë, vdes menjëherë.
S'hem dot se ëndrra mund ndonjë miku
t'i referohet, se bij s'kish Strofi,
kur mua fli do tē më bënin.
Tani, pra, unë që ndodhem larg
dua vllait, q'është larg dhe ky,
t'i bëj libata; 1) kjo më mbet vetëm
që t'ia bëj me shërbëtoret,

1) Të derdhurit e vajit, tē verës, tē qumështit e tē mjaltit, mbi varrin e tē vdekurve apo mbi altaret e perëndive.

m'ato gra greke që më dha mbreti.
Po përse edhe nuk kanë ardhur?
Brenda do hyj në këtë tempull
të perëndeshës, ku rroj dhe unë.

(*Hyn në faltore*)

SKENA E DYTE

(*Oresti—Piladi*)

Oresti

Shiko mos është ndonjë në rrugë.

Piladi

Shikoj dhe sytë i shtie kudo.

Oresti

Pilad, si thua? Ky ësht' pallati
i perëndeshës, që na ka bërë
të çajmë detin edhe të vijmë
këtu nga Argosi?

Piladi

Mua, Orest, kështu më duket;
dhe ti të njëjtin mendim me mua
duhet të kesh.

Oresti

Ky vallë është edhe altari
që po kullon nga gjak' i grekve?

Piladi

Skuqin kornizat e tij nga gjaku.

Oresti

I sheh trofetë poshtë kornizave?

Piladi

Ësht' nga të huajt q'i kanë vrarë.
Tani syt' katër duhet t'i bëjmë.

Oresti

O Feb, ti ç'kurth më ngrite prapë
m'atë orakull që më ke dhënë
në atë kohë kur vrava nënën
dhe mora hakun e atit tim?
Gjithnjë i ndjekur nga Erinitë
ika, mërgova, larg nga atdheu,
dhe në çdo anë shumë rravgova.
Pastaj te ti erdha të pyes
si do shpëtoj nga kjo mani
që s'ka pushim, si dhe nga vuajtjet
q'heq duke bredhur nëpër Greqi.
Më the të viajë në Tauridë —
ku Artemida, kjo motra jote,
i ka altaret — të marr statujën
e perëndeshës, atë statujë
që ra prej qjellit në këtë tempull,
sikundër thonë bota këtu;
dhe, si ta marr — daç me dredhi,
daç i ndihmuar prej ndonjë fati —
e të shpëtoj nga ky rrezik,

më the Athinasve t'ua dhuroj;
gjëra të tjera s'më urdhërove;
por, si ta kryej këtë detyrë,
do marrin fund hallet e mia.
Fjalës iu binda, erdha këtu
në dhe t'panjohur e jomikpritës.
Po tani ty, Pilad, të pyes,
ty që më ndih në këtë punë:
Ç'duhet të bëjmë? Muret, siç sheh,
rreth e përqark janë të larta;
mos duhet ngjitur aty me shkallë?
Po a e bëjmë pa u kuptuar?
Apo të hyjmë brenda në tempull,
pasi t'i thyejmë kyçet me llozë?
Po në na zënçin, ndërsa ne rrahim
t'i çelim portat ose të hipim
në muret sipër, do vdesim, sigur;
porse pa ardhur akoma vdekja,
le t'ikim shpejt n'anijen tonë,
që na ka sjellë në këtë vend.

Piladi

Të ikim, thua? Kjo nuk durohet,
ne as e kemi këtë zakon;
pastaj divnesa e perëndisë
s'duhet përbuzur. Po ja ç'të bëjmë:
nga kjo faltore le të largohemi,
të shkojmë të fshihemi në ndonjë shpellë,
atje ku deti sterrë i zi
me ujët vendin lag e mbulon.
Atje të shkojmë, të rrimë fshehur
dhe larg anijes, se mos dikush,
sapo ta shohë, mbretit i thotë

dhe ky me forcë na shtie në dorë.
E kur të vijë syri i natës,
natës së errët, me guxim duhet
t'hyjmë në tempull dhe ta rrëmbejmë
me çdo mënyrë këtë statujë
të perëndeshës. Shiko tani
ku mund të ketë ndonjë vend t'hapur
midis triglifve (1), prej ku të mundim
të zgresim poshtë. Rrezikut trimat
i bëjnë ballë, kurse frikashi
në asnje vend nuk vlen asgjë.

Oresti

Nuk bëmë ne kaq udh' të gjatë,
pasi e çamë me rrema detin,
që prap' të kthehem pa ia arritur
qëllimit tonë. Mirë më thua;
duhet të bindem. Duhet të gjemë
vend për t'u fshehur, që të mos mundin
të na zbulojnë. S'do bëhem shkak
që të mos kryhet fjala e hyjit;
duhet guxim; se për të rinjtë
asnje mundim s'është pretekst.

(Dalin nga skena)

1) Në arkitekturën dorike, pjesë në formë katrore me tri kanalizime vertikale.

SKENA E TRETE

(*Kori — Ifigjenia*)

Kori

Heshtni, ju që po banoni
në të dy shkëmbinjtë e ngjitur
përmbi atë Det të Zi,
det që nuk është mikpritës (1).
O Diktinë, bij' e Letos (2),
ti e maleve hyjneshë,
te pallati yt tani,
te faltorja n'ato shtylla,
me ato korniza t'arta
këmbën time virgjërore
po e sjell me respektim,
unë q'jam një shërbëtore
e së shenjtës priftëreshë,
që kam lënë kullat, muret
e Greqisë plot me kuaj
fort të mirë, fort të bukur,
dhe Evropën m'ato kopshte
të stolisura me pemë (3)
dhe shtëpin' e atit tim.
Ja ku erdha; ç'të re kemi?

1) Është fjala për Detin e Zi dhe për të dy shkëmbinjtë që quhen Simplegade. Taurianët nuk banonin në këta shkëmbinj, po poeti thotë kështu, mbasi Simplegadet ishin në ato kohë gjëja më e rëndësishme e Detit të Zi.

2) Diktina: me këtë emër adhurohej Artemida në ishullin Kretë.

3) Këto pemë janë sidomos ulliri dhe vreshti, që janë shenjat më të para të qytetërimit të një populli. Skitia, ku ishte Taurida, ishte plot me pyje të egra.

Çfar' mendimi tē mérzit?
Pse më solle, pse më solle
në faltoren ti, o bijë
e atij që u vërsul
kundër kullave tē Trojës
me një flotë famëmadhe,
flotë me një mij'anije
dhe me dhjetë mijë trima
tē Atridve tē dëgjuar?

Ifigjenia

Po më mbytin, oh, moj shoqe,
një vajtim me dhembje plot,
edhe britma e një këngë,
që s'ka fare harmoni,
dhe rënkimë ah! me lot,
që prej lirës s'shoqërohen. (¹)
Sa mynxyra po më ndodhin!
Për vëllanë tim po qaj,
që ka vdekur, siç më thotë
ëndërra e kësaj nate,
terr' i s'cilës sapo iku.
Oh, mbarova! Oh, mbarova!
S'mbet më vatra e tim eti!
Oh, u zhduk dhe fisi im!
Ç'fatkeqësi po ngajnjë n'Argos!
Ah, demon, ti që vëllanë
tim tē vetëm ma ke marrë
dhe te Hadi e dërgove!

1) Lira (vegël muzikore me shtatë tela) shoqëronte zakonisht këngët gazmore. Vajet nuk shoqëroheshin prej lirës.

Për atë tani do lag
me këto libata tokën
me kraterin e të vdekurve,
me burimet e mëshqerrave
që kullosin. nëpër malet,
me të kuqin lëng të Bakut
dhe me punën që e bëjnë
ato bletët kuqalashe,
gjëra q'u pëlqejnë fort
njerëzve që kanë vdekur

(Duke iu drejuar shërbëtores).

Nëma enën gjithë ar
dhe këto libata t'Hadit.

(Duke iu drejuar hipes së vëllait).

O bir i Agamemnonit,
që nën dhe qëndron i shtrirë,
për ty, si për një të vdekur,
po i bëj këto libata!
T'i pranosh, vëlla, të lutem,
se mbi varr nuk të sjell dot
culluf leshrash ar të verdha,
as me lot dot nuk e lag!
Se fort larg më kan'mërguar,
larg atdheut tënd e tim,
ku besojnë q'un' e mjera
u flijova, u varrosa.

Kori

Duke iu përgjigjur zonjës,
edhe unë do këndoij
m'atë zë, me atë ton

të hyjnive aziatike (1)
 këngë t'hidhur vajtimtare
 që këndohet nëpër vdekjet
 që buçet edhe te Hadi
 krejt e ndryshme nga peanët. (2)
 Ah medet! U shua drita
 e familjes së Atridve,
 drit'e skeptrit mbretëror!
 Ah! u shua dhe shkëlqimi
 i shtëpisë atërore!
 dhe pushtet' i sundimtarve
 që të lumtur rronin n'Argos.
 Një mynxyrë rrjedh prej tjetrës,
 që kur djelli, duke kthyer
 kuajt e tij të shpejtë fort
 edhe vendin duke ndërruar,
 shtiu gjetkë syn' e tij,
 syn' e kaltër e të ndritur (3).
 Dhe, për shkak të dashit t'artë,

1) Kori është formuar, siç dihet, prej femrash greke; po vaji i tyre është aziatik, sepse ndodhen në një vend barbar. Përveç kësaj, vajet e popujve t'Azisë ishin përhapur shumë në Greqi, siç mund të kuptohet nga disa drama të Eskilit.

2) Këngë gazmore, për ndër të hyjnive.

3) Sipas mitologjisë, Atreu u bë mbret i Argos dhe i Mikenës. I vëllai, Tiesti, në bashkëpunim me Eropën, gruan e Atreut, që ai e kishte bërë për vete, deshi të merrte froni, duke u përpjekur të rrëmbente më parë, i ndihmuar nga e kunata, një qengj le-shartë prej grigjës mbretërore. Qengji leshartë ishte simboli dhe mbrojtësi i pushtetit suprem. Duket se Zeusi deshi ta përforconte ligjshmërinë e sundimit të Atreut, duke shmangur një herë koçinë e diellit nga rruga e zakonshme. Tiesti u zbulua, u dëbua në mërgim, dhe që këtej (nga ngjarja me qengjin e artë) zu fill urrejtja e pasuar e Tiestit kundër Atreut, dhe shumë e shumë krime gjaku në fisin e tyre.

në pallatin mbreteror
ndodhën dhembje një pas një,
hidhërim mbi hidhërimë
edhe vrasje përmbi vrasje.
Bash q'aherë dhe hakmarrja
iu turr shtëpisë mbretit,
që, për vrasjen e dikurshme
të stërnipve të Tantalit,
vet'ajo ta marrë hakun.
Një demon vrapon mbi ty
të dërgojë fatkeqësira.

Ifigjenia

Fati im i keq filloi
pikërisht nga ajo natë,
kur i zgjidhën brezin mëmës (1) :

që në krye, q'atë natë,
tri Fatitë perëndesha, (2)
që i kryesojnë lindjet,
fëmijërin' ma ashperuan.

Bij' e Ledës, e mjeruar (3)
në pallat filiz të parë
më ka lindur dhe më rriti
për një fli të llahtarisor,
të premtuar prej tim eti,
pse hyjneshën kishte fyer.
Përmi qerre q'hiqnin kuaj

-
- 1) D.m.th., natën e parë të martesës, kur ua zgjidhnin nuseve brezin virgjëror.
 - 2) Janë të tri Fatitë (Parkat), që, sipas mitologjisë, ndodhen në çdo lindje dhe që thurin natën e tretë perin e fatit të të lindurit.
 - 3) D.m.h., Klitemnestra.

më kan'hipur dhe më shpunë
 në ranishten e Aulidës
 për fejesën time gjoja
 — ah medet! fejes' e zezë! —
 me të birin e Nerejdës (1)
 Tani unë rri e huaj
 në këto vise të egra,
 pranë detit jomikpritës,
 pa martesë, pa fëmijë,
 pa atdhe, pa miqësi,
 unë që dikur për nuse
 më kërkonin në Greqi.
 Tani Herës, perëndeshës,
 më në Argos s'i këndojo
 mbi telajon tingëlluese (2)
 dhe me penjtë ngjyra-ngjyra
 me sovajkë nuk qëndis
 as fytyrën e Paladës (3),
 as fytyrën e Titanëve,
 po me gjakun e të huajve
 i spërkat këto altare
 dhe me zemër të helmuar
 i dëgjoj kur ulërijnë,
 i shikoj kur derdhin lot.
 Po këto i kam harruar;
 sot po qaj për tim vëlla,
 tim vëlla që vdiq në Argos.

1. D.m.th. me Akilin.

2. Sovajka, duke e shpënë masurkën (perin) mbi veglën, nxjerr ca tinguj të bukur (Kalifhongos) që u pëlqejnë vajzave.

3. Është fjala për peplin e Athinasë të qëndisur prej grave të Athinës dhe të zbuluar me piktura që paraqisnin luftërat e Athinasë dhe të perëndive të tjera kundër Titanëve.

E kam lën' ende në gji,
ende foshnjë, çilimi.
filiz edhe; e kam lënë
në gji e në kraht' e nënës,
Qaj Orestin, që do merrte
skeptrin mbretëror në Argos.

SKENA E KATËRT

(*Kori — Ifigjenia — Lopari*)

Kori

Ja një lopar po vjen këtu
nga buz' e detit, që të të sjellë
ndonjë të re.

Lopari

Ti, mori bij' e Agamemnonit
dh'e Klitemnestrës! Dëgjo të rejat
që të kam sjellë.

Ifigjenia

E ç'është kjo që mendjen time
ma turbullon?

Lopari

Dy djem të rindj, pasi shpëtuan
tok me anijen nga Simplegadet,
gurët e kaltër, në tokën tonë
si mbërritën fort e pëlqyer
prej Artemidës, hyjneshës sonë.

hyj do tē jenë». Dhe atëherë
 njëri prej nesh, që ish besimtar,
 po sa i pa, ngriti lart duart,
 u fal dhe tha: «Bir i detares
 Leukote⁽¹⁾, o zot Palemon,
 mbrojtës anijesh, ti dashamirë
 ndaj nesh tregohu! Ose dhe ju,
 O Dioskurë⁽²⁾, po qe se jeni
 më breg tē detit, apo dhe ju,
 bijt e Nereut, që lindi korin
 fort tē dëgjuar t'pesdhjet' Nerejdave.
 Porse një tjetër q'ish mendjelehtë
 dhe plot guxim, q'i kishte kallur
 tē mosbesuarit në perënditë,
 zuri tē qeshte me këto lutje
 dhe tha: «Aty brenda më shkëmb
 fshihen detarë q'iub mbyt anija;
 rrinë aty në atë shpellë
 nga frik' e ligjit; kanë dëgjuar
 se ne fllojmë çdo njeri t'huaj
 që vjen këtu». Prej nesh shumica
 tha q'ai fliste mirë dhe drejt
 edhe se duhej t'i bënëm fli
 hyjneshës sonë sipas zakonit.
 Aherë një nga tē dy t'huajt

1) Sipas mitologjisë, Inoja, bija e Kadmit, e ndjekur prej tē shqit, Atamantit, ra në det bashkë me tē birin Melikert; me ndërmjetësimin e Afërditës, ata u bënë prej Poseidonit perëndi detare dhe nderoheshin si perëndi, Inoja me emrin Leukote dhe Melikerti me emrin Palemon.

2) Të dy binjakët bij tē Zeusit e tē Ledës, gruas së Tindarit. Njeri quhej Kastor dhe tjetri Polideuksi; nderoheshin si heronj ose si perëndi shpëtimtarë tē detarëve.

doli nga shkëmbi, mdenji më këmbë
dhe tundi kokën, duke rënkuar;
duart iu drodhën si një të marri
dhe si gjahitar: «Pilad, — bërtiti, —
e sheh këtë? Dhe këtë tjetrën,
kuçedër t'Hadir, a nuk e sheh?
E armatosur me ca nepërka
që kallin tmerr, po bëhet gati
të më vërsulet, të më përpjë.
Kjo tjetra prapë (1) lëshon nga rrrobat
zjarr edhe gjak dhe flatrat rreh;
në duart e saj mban nënën time,
posi një bllok të madh prej guri,
dhe përmbi mua do që ta hedhë.
Ah! do më vrasë; nga t'ia mbaj?»
Porse fanitjet e tij nuk ishin
fare të njëjta; ishin të ndryshme:
i ngatërronte lehjet e qenëve,
zërat e qeve dhe thosh q'ato
qen' imitime të Erinive.
Të gjithë ne u mblodhëm kuspull
dhe prisnim vdekjen pa nxjerrë zë;
ai aherë shpatën e nxjen,
si luan turret në mes të qeve,
shpatën e tund, u bie në brinjët,
kujton se mbrohen nga Erinitë:
deti i tërë skuqet nga gjaku.
Të gjith'aherë, si pamë prishjen,
kërdim' e qeve, u armatosëm
edhe, konkilet (2) duke i fryrë,

1) Erini e tretë.

2) Guaskë në formë briri.

u bëmë zë vendasve rrrotull
që të vraponin të na ndihmonin;
se ne, loparë të dobët, thoshim,
s'mund të luftonim me djemt' e huaj,
q'ishin të rinj e të fuqishëm.

Pas ca u mbush vendi me burra.

Si e kaloi krizën e qmendjes,
aher' i huaji u shemb përdhe,
shkumë nga goja mjekrën ia lagte.
Ne, kur e pamë djalin të rënë,
e kapëm rastin, zum' t'i qëllojmë.

Po shoku tjetër ia fshinte shkumën,
ia mbronte trupin duk' e mbuluar
me peplin endur për bukuri,
dhe kish kujdes që t'ia largonte
gurët që hidhnik dhe çdo shërbim
i bënte shokut, mikut të dashur.

Ky, si e mori veten, u ngrit;
kur pa armiqtë që, si një valë,
vinin mi ta, pa dhe rezikun
që po afrohej, rënkoj thellë;
po ne s'pushonim s'chedhuri gurë,
duke u turrur nga gjithë anët.

Në këtë çast një klithm' e tmerrshme
në vesh na erdhë: «Pilad, — bërtiti, —
ne do të vdesim; porse si burrat
duhet të vdesim; nxirr shpatën shpejt
dhe ec me muà». Aherë ne
ia dhamë vrapi, sapo u pamë
të dyja shpatat armiqve tanë;
në çast u mbushën lugjet shkëmbore.
Në vend t'atyre që kishin ikur,
vinin të tjerë; edhe këta,
duk'u vërsulur, me gur' u binin;

kur dhe këta thyheshin, iknin,
ktheheshin prapë ata që kishin
ikur më parë, edhe u binin.
Por, o çudi! Me mijra duar
u hidhnin gurë, porse asnje
nuk i qëlloi këto viktima
të perëndeshës. Mezi në fund
i shtiem në dorë dhe jo me lufitë
e trimëri, po i rrethuam
nga gjithë anët. dhe, duk' u rënë
me gurë duarve, i detyruam
që t'i lëshojnë shpatat përdhe
edhe të bien të dy në gjunjë.
Këta pastaj ia shpumë mbretit
të këtij vendi, ky, me t'i parë,
shpejt t'i dërgoi, që t'i pastrosh (1)
e t'i bësh fli. Uro, o vajzë,
të kesh përherë kësish viktima
për t'i fliuar; po të flijosh
të tillë t'huaj, Greqia fajin
ka për ta larë pér vrasjen tënde,
që të fliroi në Aulidë.

Kori

Ç'gjëra t'habitshme këto që thua
për marrëzinë e atij t'huajt,
cilio qoftë, q'erdh nga Greqia
në këtë det aspak mikpritës!

1) Sipas zakoneve fetare të asaj kohe, viktima, para se të bëhej fli, pastrohej me ujë të shenjtëuar, të bekuar.

Ifigjenia

Mirë;

ti tani silli këtu të huajt;
sa për të tjerat, mendohem unë,
(Del lopari)

E mjera zemër! Gjer sot ngahera
ke qen' e butë, mëshirëplotë
për gjith' të huajt, dhe për ata
të racës sime derdhje dhe lot,
sa herë grekët të binin n'dorë.

Po sot nga ëndrra që m'egërsloi
— pashë q'Oresti s'e sheh më djellin —
ju, kushdo qofshi, do të më gjeni
të keqe fort. Dhe un' e di,
moj shoqe, kjo ësht'e vërtetë:
njerzit e mjere s'kanë mëshire
për më të mjerët, kur vetë vuajnë.
Por er' nga Zeusi gjer sot s'ka fryrë,
as ndonj' anije nuk ka kaluar
nga Simplegadet, që të ma sjellë
këtu Helenën, që më shkatrroi,
dhe Menelaun; për t'ua marrë
të dyve hakun, do t'u tregoja
se dhe këtu ka Aulidë
bash si ajo, ku, si më zunë,
më therën grekët si një mëshqerrë;
im atë vetë që më dha dritë,
ai ka qenë prifti flijues!
E mjera unë! Ato të zeza
të asaj kohe nuk i harroj;
sa herë duart ia hodha atit
dhe ja pushtova mjekrën e gjunjët!
Duke u mbajtur në to i thosha:

«Po më marton, o at'; po ç'dasëm
 e zezë është! Kur ti më vret
 këtu tani, nëna me gratë
 atje në Argos këngë dasmore
 po më këndoijnë; pallat' i gjithë
 buçet nga fyejt; unë prej teje
 vritem, mbaroj! Hadi ka qenë,
 pra, ai burri që më premtove,
 dhe jo Akili, bir i Peleut!
 Me dhelpëri këtu më solle
 hipur në qerre për një martesë
 fort të përgjakur». Dhe, meqë sytë
 m'i kish mbuluar mbules' e hollë,
 s'mora më krahë vëllanë tim,
 atë vëlla që s'është më;
 nga turpi s'putha motrën në gojë (1),
 se në pallat t'Peleut shkoja;
 puthje të shumta i pata ruajtur
 për tjetër herë, kur, siç besoja,
 unë do vija prapë në Argos,
 Orest i mjerë! Po qe se vdiqe,
 ç'të mira humbe! Ato të mira
 q'i merr nga ati dhe për të cilat
 bota të kish zili të madhe.
 Këto sofizma të perëndeshës
 un' i qortoj; në njérën anë,
 s'i qas n'altaret, si të përlyer,
 ata që vrasin, ose që prekin

1) Nuses, kur dilte nga shtëpia e t'et për të vajtur në shtëpin' e
 burrit, ia mbulonin sytë me një mbulesë (velo) të hollë, në më-
 nyre që të mos mund të shihte, po t'i mbante sytë mbyllur nga
 turpi. Ifigjenia, pra, e mbuluar kështu, s'mundi të përqafonte vë-
 llanë, Orestin, e motrën, Elektrën.

me duart e tyre njeri tē vdekur
a një lehonë, më tjetrën anë,
kënaqet shumë me fli mortarësh!
Nuk' ka sesi tē ketë lindur
hyjnesha Leto, shoqja e Zeusit,
një tē këtillë bijë pa mend.
Unë s'besoj as në gostitë
q'u jep Tantali, siç thonë, hyjve;
dhe as besoj se perënditë
kanë shijuar mishin e djalit (1).
Po, siç më duket, këta këtu,
njerëz gjakpirës, ligsin' e tyre
ia ngarkojnë kësaj hyjneshe.

Kori

Strofa I

Të kaltër ju,
shkëmbinj tē kaltër, (2)
që mbyllni detin
ku kish kaluar
Zekthi nga Argos (3)
për tē arritur
në det tē zi,
duke shkëmbyer

1) Tantali ka qenë bir i Zeusit dhe i një nimse. Ishte mbret i Frigjisë dhe ati i Pelopit e i Niobes. Te Hadi poshtë u dënuar për jetë tē vuante prej etjes e tē mos mundte ta shuanë, ndonëse rrëth e rrrotull kishte ujëra dhe shelgje me pemë tē bukura. Mori këtë dënim se guxoi tē therte tē birin e t'ua jepte si gjellë perëndive, me qëllim që tē provonte në do tē mundnin këta tē njihnin dinakérinë e tij.

2) Flet për Simplegadet.

3) D.m.th. loja, e ndjekur prej Zekthit (shih dramën e Eskilit «Prometeu i lidhur»).

dhen' e Azisë
me Europën.
Cilët, pra, janë
këta që erdhën,
pasi e lanë
lumin Eurota (1)
m'u jë të pastër
dhe me kallama
të gjelbëruar
ose të Dirkes (2)
ujët e shenjtë
dhe në një tokë
të egër erdhën,
ku gjak mortarësh
për ndër t'hyjneshës,
bijës së Zeusit,
vadit altaret
edhe faltoret,
që i stolisin
shtylla të bukura?

Antistrofa I

A mos lundroi
mbi ujt e detit
qerrja detare
me dy seri
lopatash bredhi
zhurmëmëdha,
që rrabin valët,
dhe me pejhura,
që i hap era,

1) Lumi i Spartës.

2) Direke ishte një burim pranë Tebës. Pyet kori. Mos erdhën nga Sparta a nga Teba?

këtu i solli
të shtojnë kamjen
e shtëpis' tyre?
Se shpresë është
e shtrenjt' për njerëzit,
kur ata vuajnë,
dhe s'ngopet kurrë;
njerzit kënkojnë
të bëjnë kamje
sa më të shumta;
dhe çajnë detin
e në qytete
barbarësh shkojnë.
Këtë lakmi
të gjith' e kanë;
por më ca është
e tepëruar,
te ca të tjerë
e ruan masën.

Strofa II
Po si kaluan
të dy shkëmbinjtë
dhe anëdetjen
e fineidve (1)
— gjithnjë me valë,
që s'flenë kurrë —
duke vrapuar
përmbi tallazet
e Amfitritës (2),

-
- 1) Është fjala për në bregdetin e Salmidesë (në Trakë), ku deti trazohet vazhdimisht prej stuhive.
 - 2) Personifikimi i detit. Amfitrita është gruaja e Poseidonit dhe mbretëresha e detit.

ku Nereidet,
pesëdhjet' vajzat,
këngës ja marrin,
vallen e dredhin,
duke u sjellë
rreth e përqark?
Apo ndërsa
era u frynte,
hapte pëlhirat,
edhe timoni
i palëvizur
përsipër popës
po fërshëllente
prej erës s'jugut
a të Zefirit ⁽¹⁾
më në fund mundën
që të arrijnin
në bregn' e bardhë
të asaj toke
me shpendë plot,
dhe në të bukurin
stad të Akilit,
në Detn'e Zi ⁽²⁾
Sikur të vinte
— sipas dëshirës
së zonjës sime —

Antistrofa II

1) Zefiri: erë në Mesdhe, që vjen nga ana e perëndjimit.

2) Është fjala për ishullin e shkretë plot me shpendë të detit. Quhej «Leuke» (c bardhë) për shkak të bregdetit që është i bardhë. Sot njihet me emrin grek «Fidonisi» (ishulli i gjarpërinjve) dhe ndodhet afër grykës së Danubit. Sa për stadin e Akilit, thonë se ishte më larg, në gadishullin e Tendrës, në jug të grykës së Hipanit dhe të Boristenit (Dniepr).

këtu nga Troja
bija e dashur,
Helen' e Ledës,
edhe të vritej
nga zonja ime
për të këqijat
që i ka bërë,
pasi më parë
të venë rreth
kokës së saj
kurorë vese
krejt të përgjakur!
Sa gaz do ndjej
po të më thonë
se nga Greqia
ndonjë detar
erdhi këtu
të më shpëtojë
nga robëria
fort e trishtuar!
Sikur të mund,
qoftë në ëndërr,
të shoh sërisht
shtëpin' e atit
edhe qytetin,
të shijoj himnet,
këngët e ëmbla,
që janë gaz

*Po ja ku vijnë
me duar lidhur
të dy të rinjtë,
viktim' e re*

*Po ja ku vijnë
me duar lidhur
të dy të rinjtë,
viktim' e re*

e perëndeshës.
Heshtni, o shoqe,
se pranë tempullit
ndodhen të dy
grekët e rinj:
lopari s'pruri
lajme të rreme.
O perëndeshë!
Në të pëlqejnë
këto që bën
për ty ky popull,
pranoi flitë,
ndonëse këto
ligj'i Greqisë
i çmon të liga.

AKTI III

SKENA E PARË (1)

(*Ifigjenia — Kori — Oresti — Piladi*)

Ifigjenia

Mirë, pra;

*Unë, së pari, do përkujdesem
të plotësohen mir'e më mirë
gjërat e kultit të perëndeshës.
Tash ua zgjidhni duart të huajve;
janë të shenjtë; nuk duhet më
të jenë lidhur; hyni në tempull
dhe bëni gati ato që duhen.
në këtë rasë, sipas zakonit.*

*(Shërbëtorët hyjnë në tempull. Ifigjenia u
drejtohet të rinjve të huaj)*

Ah! Cila nënë ju lindi vallë?
E cili është babai juaj?

1) Hyjnë në skenë Oresti me Piladin, të lidhur; i sjellin rojtarët dhe loparët.

Dhe motra juaj, po qe se keni,
ç'véllezér oh, ka pér tē humbur!
Kush mund tē dijë se ç'fat do ketë?
Gjithë mendimet e perëndive
zvarrisen, shqasin në errësirë.
askush tē ligën s'e parashëh;
fati shkon para drejt së panjohurës.
O ju tē mjerë, nga vini vallë?
Patjetër shumë keni lundruar,
derisa erdhët në këtë tokë!
Tani nën dhe gjithnjë do rrini
larg tokës suaj, shtëpisë suaj!

Oresti

Përse vajton kështu, o grua,
cilado qofsh? Pse na lëndon
me këtë vaj? A s'janë mjafat
ato tē liga që do na ndodhin?
S'quaj tē ditur atë njeri,
që, duke qarë, kërkon tē mundë
tmerrin e vdekjes, kur ësht'buz'varrit,
dhe s'ka asnje shpresë shpëtimi;
se bën jo një, po dy tē liga;
së pari, quhet njeri i marrë,
pastaj dhe vdekjes s'arrin t'i shmanget;
duhet ta lëmë fatin tē lirë.
Mos qaj pér ne: flit'e këtushme
i dimë mirë dhe mir'i njohim.

Ifigjenia

Cili prej jush quhet Pilad?
Këtë, së pari, dua ta di.

Oresti

Ja ky këtu, në do ta dish.

Ifigjenia

Në ç'qytet grek ësht' lindur vallë?

Oresti

Ç'do fitosh, grua, po ta mësosh?

Ifigjenia

Mos prej një nëne jeni vëllezër?

Oresti

Nga dashuria o jo nga gjaku.

Ifigjenia

Po ty yt atë ç'emër të vuri?

Oresti

Emri i drejtë do t'ish: Fatkeqi.

Ifigjenia

S'pyes këtë, se ta dha fati.

Oresti

Po qe se vdes dhe emri im
ësht'i panjohur, nuk do më qeshin.

Ifigjenia

E pse s'ma thua? Aq krenar qenke?

Oresti

S'do flijosh emrin, po trupin tim.

Ifigjenia

Po as qytetin tënd s'ma tregon?

Oresti

C'fitim do kem? Unë po vdes.

Ifigjenia

Këtë under bëma: ç'gjë të ndalon?

Oresti

Argosi është atdheu im,
Argos i famshëm, e them me mburrje.

Ifigjenia

Për hyjt', o mik, me të vërtetë
aty ke lindur?

Oresti

Vij nga Mikena, që qe dikur
qytet i lumtur.

Ifigjenia

Ike s'andejmi pse të dëbuan
apo mos fati kështu ka dashur?

Oresti

Ësht'një mërgim dhe me dëshirë
dhe pa dëshirë.

Ifigjenia

Po, sidoqoftë, ësht'fat i mirë
q'erdhe nga Argosi.

Oresti

Për mua jo, sigurisht jo;
Në është' për ty, ti vet' e di.

Ifigjenia

A do më thuash një gjë që dua?

Oresti

Kjo do të jetë një farë shtojce
e fatkeqësisë që më ka rënë.

Ifigjenia

Mbase e di qytetin Trojë;
për të kudo të gjithë flasin.

Oresti

Nuk do të desha ta shoh as n'ëndërr.

Ifigjenia

S'ësht'më, si thonë: lufta e prishi.

Oresti

Ështëc vërtetë, s'të kan'gënjer.

Ifigjenia

Erdhi Helena, prap'në shtëpi
të Menelaut?

Oresti

Erdhi, po prishi një nga të mitë(1).

Ifigjenia

Ku është vallë? Se dhe me mua,
ka një hesap.

Oresti

Në Spartë rron me burrin e parë.

Ifigjenia

Grua e urryer! T'urren Greqia,
jo vetëm unë!

1. D.m.th. Agamemnonin. Për këtë mbret ka qënë fatal kthimi i Elenës pranë Menelaut.

Oresti

Dhe unë vetë diçka shijova
nga dasm'e saj.

Ifigjenia

A janë kthyer akejt, siç flitet?

Oresti

Si, me një pyetje pyet për të gjithë!

Ifigjenia

Dua t'i mësoj, pa vdekur ti.

Oresti

Meqë do, pyet, dhe do përgjigjem.

Ifigjenia

Kalkant Faltari erdhi nga Troja?

Oresti

Vdiq, siç po thonë, posht' në Mikenë.

Ifigjenia

Mirë iu bë, o perëndeshë!
Po ç'u bë vallë bir i Laertit ⁽¹⁾?

1. Odiseu.

Oresti

Ende s'u kthye, po rron, si thonë.

Ifigjenia

Vdekta, mos ardhë n'atdhe i gjallë!

Oresti

E ç'e mallkon?
Atij të gjitha ters po i venë.

Ifigjenia

A rron akoma djali i Tetit?

Oresti

Nuk rron; më kot bëri martesën
në Aulidë(2).

Ifigjenia

Martes'c rrème; e di viktima.

Oresti

Po ti kush je? Sa mirë pyet
për çështjet greke!

2: Oresti, në personin e Akilit, sheh njeriun që u ngatërrua me puhën e flisë së Ifigjenisë, fli që u bë shkak i vrasjes së Agamemnonit.

Ifigjenia

Oresti

Me plot tē drejtē rēnkon, moj grua,
qē tē mēsosh ç'ndodh n'atē vend.

Ifigjenia

Ҫ'bën kryeprijsi, ai që thonë
se ësht'i lumtur?

Oresti

Kush është ky? Ai që njoh unë,
s'është i lumtur.

Ifijienia

Agamemnoni, mbreti, q'e quajnë
bir' tē Atreut.

Oresti

S'e di: por lëre kët' llaf, o grua!

Ifigjenia

Për hatër thyjje, fol, o i huaj,
që të gëzohet ky shpirti im.

Oresti

Vdiq ky i mjeri! Po dhe një tjetër
hoqi me vete (1).

Ifigjenia

Vdiq? Po nga se? E mjera unë!

Oresti

Pse ky rënkim? E kishe fis?

Ifigjenia

Qaj lumturinë që dikur pati.

Oresti

Mbaroi keq; e vau gruaja.

Ifigjenia

Oh! për të qarë janë të dy:
ajo q'e vau, ai q'u vau.

Oresti

Tani pusho, mos pyet më.

Ifigjenia

Dhe këtë vetëm: këtij të mjerit
i rron e shoqja?

1) «Një tjetër» është Oresti vetë.

Oresti

Vdiq: e ka vrarë djali i saj.

Ifigjenia

Shtëpi e mjerë! Po përse vallë?

Oresti

Për ta dënuar q'i vrau t'anë.

Ifigjenia

Medet!
Dënim i keq, porse i drejtë.

Oresti

Ndonse i drejtë, s'mbrohet prej hyjve.

Ifigjenia

Agamemnoni la tjetër djalë?

Oresti

Ka lënë vetëm vajzën Elektrā.

Ifigjenia

Si? për të bijën që bënë fli
nuk thonë gjë?

Oresti

Nuk thonë gjë, po këtë vetëm;
q'ajo ka vdekur e s'sheh më dritën.

Ifigjenia

Vajzë fatzezë! Fatzi i ati
që e ka vrarë!

Oresti

Vdiq për një grua të keqe fort,
që s'meritonte një fli të tillë!

Ifigjenia

Bir' i të vrarit a ësht' në Argos?

Oresti

I mjeri djalë është kudo
dhe asgjëkund.

Ifigjenia

Pra, lamtumirë, ëndrra të rreme!
s'qenkërki gjë!

Oresti

Dhe hyjt', q'i kemi për fort të ditur,
s'janë më pak rrejtës se ëndrrat,
që fluturojnë. Rrëmuj' e madhe
është ndër gjërat e perëndive
e ndër ato të njerëzisë.
Vetëm një gjë e hidhëron;
mbasi dëgjoi, pa qen'i marrë,
fjalët q'i thanë dikur faltarët,
humbi, sikundër mund të dëshmojnë
ata q'e dinë.

Kori

Ah! Ah! Po ne? po prindët tanë?
Janë? A s'janë? Kush do na thotë?

Ifigjenia

Dëgjoni ju, o njerëz t'ë huaj!
Një mendim m'erdhi, q'ësht i dobishëm
edhe për ju, edhe për mua;
se një gjë është shumë e mirë,
vetëm aherë kur nga të gjithë
ësht' e pëlqyer (*Orestit*). Po të ta fal
jetën, or shok, a dëshiron
të shkosh në Argos, t'u shpriesh lajme
miqve nga unë edhe një letër
t'u dorëzosh? Një rob ma shkruijti;
këtij për mua i erdhì keq,
se pa që s'ishte kjo dora ime
që bënte vrasjet, po ligj' i vendit
dhe perëndesha q'i quan flitë
të drejta fare. Gjer tani s'pata
ndonjë nga Argosi, që ta shpëtoja
e ta dërgoja prapë në Argos
bashkë me letrat për miqt e mi.
Ti, pra, që dukesh djalë fisnik,
q'e di Mikenën, që njeh ata
q'i kam të dashur, shpëto nga vdekja.
Ti për këto letra të lehta
shpërblim të mirë do kesh: shpëtimin.
Sa për këtë, mbasi qyteti
na detyron, le të qëndrojë
për t'ia bërë fli perëndeshës.

Oresti

Bukur e mirë i the të tjerat,
moj vajz' e huaj, por veçse një:
po qe se vdes shoku këtu,
do t'ish për mua një barr' e rëndë;
sepse un' jam zot i anijes
q'është ngarkuar plot me mynxyra;
Kurse ky vjen si shok me mua,
të lehtësojë vuajtjet e mia.
S'ësht, pra, e drejtë, që të të bëj
unë një nder, të vdesë ky
dhe un' asgjë të mos pësoj.
Po ja ç'të bëjmë: shokut këtu
letrat ja jep t'i shpjerë n'Argos
edhe kështu të plotësojë
dëshirën tënde; e sa për mua,
le të më vrasë ai që do.
Për çdo njeri ësht' turp i madh
t'i shtjerë miqtë në fatkeqsira,
për të shpëtuar veten e tij.
Djali këtu ësht' miku im;
jetën e tij po aq e dua
sa jetën time.

Ifigjenia

O shpirt i lartë, filiz prej rrënje
fisniqe mbive! Për miq ti qenke
mik i vërtetë! U bëft'i tillë
vëllai im që më ka mbetur!
Se edhe unë, o njerëz t'huaj,
kam një vëlla, por nuk e shoh.
Mbasit kështu ti dëshiron,

këtë këtu do nisim n'Argos
të shpjerë letrën; dhe ti do vdesësh,
meqë kështu aq shum'ta kënda.

Oresti

Po mua fli kush do më bëjë?
Veprimn'e tmerrshëm kush do ta kryejë?

Ifigjenia

Unë; hyjnesha ma ka ngarkuar
këtë detyrë.

Oresti

Detyr', o vajzë, jo për t'i pasur
zili të madhe; detyr' e hidhur.

Ifigjenia

Kam rënë ngushtë, duhet të bindem.

Oresti

Femër, ti meshkujt me shpat'i ther?

Ifigjenia

Jo; unë vetëm flokët me ujë
do t'i spërkat.

Oresti

Kush do më therë, në mund të pyes?

Ifigjenia

Brenda në tempull janë ata
që përkujdesen për këtë punë.

Oresti

Kur do të vdes, ç'varr do më pres?

Ifigjenia

Zjarri i shenjtë, gropë e gjërë
brenda në shkëmb (1).

Oresti

Ah, sa do desha të më varrosin
duart e motrës!

Ifigjenia

Kot shpreh dëshirë ti, mor i mjerë,
cilido qofsh. Larg kësaj toke
barbare ndodhet! Po mbasi ti
genke nga Argosi, për ty asgjë
nuk do kursej me sa më mundet.
Për ty në varr kam për të vënë
stoli të shumta, dhe trupin tënd

1) Duket se Euripidi këtë traditë mbi flitë në Tauridë e ka marrë nga ato që thotë Diodori (XX, 14), kur flet për kartagjenasit. «Ishte thotë te kartagjenasit një statujë e Kronit, statujë prej remi; Kroni i shtrinte duart gjer në tokë dhe i mbante të hapura pëllëmbët, në mënyrë që djemtë që i lëshonin në duar të rrokulliseshin dhe të binin në një gropë plot me zjarr».

me vaj tē verdhë do ta spërkat,
mbi zjarr do derdh prej atij lëngu
që del prej lulesh, që e nxjerr bleta
e verdh'e malit. Tani po hyj
brenda nē tempull që ta marr letrën;
porse tē keqen që do t'të gjejë,
mos ma ngarko mua, tē lutem.
Ju, shërbëtorë, ruani djemtë,
por pa i lidhur. Ah, mbasse lajme
tē pashpresuara do t'i çoj n'Argos
atij prej miqve, që fort e dua!
Dhe letra ime ka pér t'i thënë
se rrojn'ata q'i kish kujtuar
gier dje tē vdekur e kështu gaz
tē pabesuar ka pér t'i kallur.

(*Hyn nē tempull*).

Kori

Strotë

Pér ty vajtojmë, që po tē pret
tē tē spërkatë ves'e përgjakur
e ujit pastrues!

Oresti

Shoqe tē huaja!
S'esht' pér tē qarë; ju lë shëndet.

Kori

Antistrofa

Ty, ore djalë, t'lumtur tē quajmë,
se nē atdhe dikur do t'shkelësh.

Piladi

Vërtet, zili s'ësht' për t'i pasur
mikut që sheh se i vdesin miqtë.

Kori

Epoda

Oh, ç'nisj'e e dhimbshme! Mjerë dhe ti,
që vdes këtu! Medet! Medet!
Kush nga të dy pëson më shumë?
Se zemra ime dyshom e s'di
për kë të qajë dhe të rënkojë.
për ty më shumë, apo, për ty.

Oresti

Për emër t'hyjve!
Pilad, dhe ti mendon si unë?

Piladi

S'e di, nuk kam si të përgjigjem.

Oresti

Cila do jetë vallë kjo vajzë?
Pyetjet i bëri si ndonjë greke:
Pyeti se ç'vuajtje pësuan grekët
në Ilion, në janë kthyer,
në rron Kalkanti, faltar' i ditur;
zuri në gojë edhe Aikilin,
edhe të shkretin Agamemnon;
për këtë shumë i erdhi keq,
pyeti për gruan, fëmijt' e tij.
Kjo grua e huaj është s'andejmi.

është nga Argosi; se ndryshe kurrë
nuk do dërgonte letra aty,
as nuk do pyeste në ësht'i lumtur
qyteti Argos, bash si njeri
që i takon kjo lumturi.

Piladi

Ato që desha të thoja unë,
i the më parë, përveç se një:
ç'pësojnë mbretrit, të gjith'e dinë
nga marrëdhëniet që kanë pasur
me njerëzinë. Po tani mua
ndër mend më erdhi një mendim tjetër.

Oresti

C'është ky mendim? Se, duk' e shfaqur,
do ta kuptosh edhe më mirë.

Piladi

Ësht' turp për mua të rroj, të shoh
dritën e djellit, pas vdekjes sate.
Bashkë me ty unë lundrova,
me ty së bashku duhet të vdes.
Pérndryshe, n'Argos e në Fokidën
plot me lugina do të më dalë
emri që jam frikash, i dobët.
Edhe shumica — se më të shumtit
janë të ligj — do të kujtojë
që un'të lashë dhe të tradhtova,
që të shpëtoj lëkurën time
dhe unë vetëm n'atdhe të kthehem:
ose do thonë që në shtëpinë

tënde të mjerë pusi të ngrita
edhe të vrava që të marr skeptrin,
si burri i ardhshëm i motrës sate,
që ish e vetmja trashëgimtare.
Ja, pra, ç'më tremb, ja pse kam turp.
Kështu që s'mund as të mos vdes,
as të mos therem, as të mos digjem
bashkë me ty, sa po që mik
të kam dhe druhem fort nga çnderimi.

Oresti

Ashtu mos fol, se unë vetë
duhet ta heq mynxyrën time.
Kur më lejohet të duroj vetëm
një hidhërim, pse të mbaj dy?
E sa për turpin dhe për qortimet
që the më parë, mbi mua do bien,
po qe se le të vdesësh ti,
ti që ke vuajtur bashkë me mua.
Për mua vetë, s'ësht' keq të vdes,
sapo që ndodhem në këtë gjendje,
ku më ka sjellë vullnet'i hyje.
Ti je i lumtur, shtëpia jote
është e pastër, pa asnjë brengë,
përkundra imja ësht' e përlyer,
ësht' e mjeruar. Kur të shpëtosh,
do bësh fëmijë me motrën time,
që ta kam dhënë për bashkëshorte;
kështu dhe emri im do të rrojë,
edhe shtëpia e atit tim
pa fëmij' kurrë nuk do të mbetet
dhe emri i saj s'do shuhet kurrë.
Shko, pra, jeto, dhe rri në vatrën

e atit tim. Kur do t'arrish
n'Helad' dhe n'Argos, q'ësht' plot me kuaj,
për dor'n e djathtë ty po të lutem
t'më ngresh një varr e përmbi të
të më vendosësh një përmendore;
Pastaj le të derdhë lot motra ime
mbi këtë varr, flok'le të vërë.
M'vrau, t'u thuash, një grua argive, 1)
më bëri fli n'altar t'hyjneshës.
As mdonjëherë, të mos e lesh,
as ta tradhtosh motrën, të lutem,
kur do ta shohësh krejt të shkretuar
shtëpin' e atit edhe familjen.
Pra, lamtumirë, o mik i shtrenjtë!
Të pata shok në foshnjëri,
shok e në gjah, shok e në vuajtjet.
Febi faltari më ka gënjer;
më porositi me një dredhi
të vete larg, sa ish e mundur
më larg Greqisë, mbasi kish turp
për profetitë që tha më parë (2).
Unë i a lashë në dorë fatin,
iu binda urdhrit; e vrava nënën,
po vdes dhe unë.

Piladi

Do ta kesh vannin; s'e tradhëtoj
shtratin e motrës, ore i mjerë,

1) argive, dmth nga qyteti i Argosit.

2) Eshtë fjala për orakullin që urdhëronte Orestin të vriste
nënën e tij.

se ty tē vdekur unë më fort
do tē tē dua, se nē tē gjallë.
Po s'të ka vrarë edhe divnesa
e perëndisë, ndonse nē buzë
tē varrit ndodhesh. Vërtet mjerimi
i tepërt sjell, kur e do fati,
ndryshime shpesh fort tē mëdha.

Oresti

Hesht; dobi s'patën fjalët e Febit: (1)
Ja tek po del kjo grua nga tempulli.

Ifigjenia (*U drejtohet shërbëtorëve*).

Ju hyni brenda dhe përgatitni
ç'duan kujdestarët e kësaj flije.

(*U drejtohet Orestit e Piladit*).

Ja, mjerëz t'huaq, kjo është letra,
letr' e palosur shumë, shum'herë (2).

Tani dëgjoni se ç'dua tjetër:

askush në botë s'është i njëjti,
si aherë kur është më vuajtje
dhe kur merr zemër, si kalon frika. (3)

1) Oresti e këshillon Piladin tē heshtë, mbasi po arrinte pri-fièresha (Ifigjenia) nga faltorja; ardhja e kësaj i jep Orestit tē kuptojë se ai është i humbur e kështu orakulli i Apolonit s'i ndihmoi fare.

2) Mbasi në ato kohëra s'kishin zarfe, letrat i dërgonin tē palosura shumë herë, që tē mbulohej përbajtja e tyre.

3) Njerëzit përgjithësisht ndryshe janë shpirtërisht, kur ndodhen në rrezik, e ndryshe, kur kalon frika e rrezikut. Në rastin e parë, turbullohen hutohen: në tē dytin rast qetësohen, marrin kurajo.

Kam frikë, pra, se mos ai,
që do ta shpjërë letrën në Argos,
pasi të dalë prej kësaj toke,
s'do çajë kryet për letrën time.

Oresti

E, pra, ç'kërkon? Ç'gjë të shqetson?

Ifigjenia

Be të më bëjë se do ta shpjërë
letrën në Argos e do t'ua japë
atyre miqve q'ua dërgoj.

Oresti

Dhe ti, si ky do të bësh be?

Ifigjenia

Ç'të them me benë? Që do bëj çfarë,
e çfar' s'do bëj? Thuaj, të lutem.

Oresti

Se do ta lësh të shkojë gjallë
prej kësaj toke, tokë barbare.

Ifigjenia

Eshtë e drejtë; përndryshe si
ka për ta shpënë letrën në Argos?

Oresti

Po mbreti vallë do të lejojë?

Ifigjenia

Do t'ia mbush mendjen: dhe unë vetë
do përkujdesem t'hipë n'anije.

Oresti

(*Piladit*): Bëj be: (*Ifigjenisë*) ti dikto një be
solemne.

Ifigjenia

«Miqve të tu, duhet të thuash, —
atyre letrën do t'ua jap».

Piladi

Miqve të tu do t'ua jap letrën.

Ifigjenia

Dhe unë ty do t'të përcjell
që t'i kalosh shëndosh' e mirë
gurët e kaltër.

Piladi

Cilin hy sjell për dëshmitar?

Ifigjenia

Sjell Artemidën, se në faltoren
e saj shërbëj.

Piladi

Unë Zeusin, mbretin august,
zotin e qiellit.

Ifigjenia

Po në më bëfsh një të padrejtë,
duke e shkelur këtë betim?

Piladi

N'atdhe mos vafsha! Po s'më shpëtove?

Ifigjenia

Mos vafsha kurrë n'Argos e gjallë.

Piladi

Dëgjo: një gjë kemi harruar.

Ifigjenia

Nuk është vonë, po qe e mirë.

Piladi

Në, goftë se anija mbyetet
dhe humbet letra ne det me plaçkat,
shpëtoj veç unë, falmë të drejtën
ta quaj benë pa asnjë vlefthë.

Ifigjenia

Po e di ti se ç'do të bëj?
Se sa më shumë masa të merren,

aqe më mirë i arrin qëllimit
Ato që janë shkruar në letër
do të t'i them edhe me gojë,
që t'ua thuash miqve të mi.

Kështu të dy jemi të sigurt:
Në shpëtofsh letrën; kjo, duke heshtur,
do t'ua thotë ç'do që kam shkruar;
po në u zhduktë letra në valët,
duke shpëtuar ti jetën tënde,
do shpëtosh edhe fjalët e mia.

Piladi

Fjalët që the janë të mira
edhe për ty, edhe për mua.
Tani më thuaj kujt t'ia shpie
letrën në Argos edhe ç't'u them
nga ana jote.

Ifigjenia

Orestit, birit t'Agamemnonit
kështu t'i thuash: «Këto t'i shkruan
Ifigjenia, q'u ther n'Aulidë;
është e gjallë, ndonse për ju
është e vdekur. . . »

Oresti

Po ajo ku është? Vdiq dhe u ngjall?

Ifigjenia

Është ajo që ke përpara;
mos ma pre fjalën, se më hutojn.

«Pa vdekur edhe, shpjermë në Argos,
o im vëlla! Hiqmë nga kjo
tokë barbare dhe nga këto
flit'e të huajve q'i bëj hyjneshës...»

Oresti

Ç'të them, Pilad? Ku jemi vallë?

Ifigjenia

... «ndryshe shtëpinë tënde, Orest,
do ta mallkoj» (*Piladit*) Dëgjoje emrin
edhe një herë dhe mbaje mend.

Oresti

O perëndi!

Ifigjenia

Pse po i fton hyjtë për punë
që më përket drejt përdrejt mua?

Oresti

S'ësht' gjë; vazhdo; unë gjetiu
e pata mendjen.
Po të të pyes, do dëgjoj mbase
gjëra që s'janë për t'u besuar.

Ifigjenia

... «Thuaj q'Artemida më ka shpëtuar;
në vendin tim vuri një sutë
q'ë ther' im atë, duke kujtar

se në krahrorin tim po e ngulte
shpatën e mprehtë; q'andej më mori
edhe më solli në këtë vend».
Ja kjo ësht' letra; këto përmban.

Piladi

O ti që mua më paske lidhur
me be të lehtë, dhe më ke bërë
një be të bukur! Një koh' e shkurtër
do të kalojë dhe do të shohësh
që do ta mbaj benë që bëra.

(*Ia jep letrën Orestit*)

Ja po ta sjell, ja po ta jep
letrën, Orest, të motrës sate!

Oresti

Letrën e marr, por s'po e hap;
sepse nuk dua të ndjej më parë
gëzim me fjalë (1), motër e shtrenjtë!
Edhe pse jam fort i hutuar
— se dëgjoj gjëra që më habitin —
dëshiroj shpirtin tim ta kënaq,
duke ta hedhur në qafë krahun,
krahun, i cili edhe s'beson.

Kori

Ti, or i huaj, nuk ke të drejtë
të prekësh peplet që s'duhen prekur

1) Oresti, i tronditur shpirtërisht, s'ka durim të lexojë letrën e së motrës e të gëzohet vetëm me fjalët e letrës. Do që të kë-naqet me punë, d.m.th. duke zënë për qafe motrën.

e itë përlyesh një shërbëtore
të perëndeshës.

Oresti

O motra ime, që na ka lindur
i njëjtë atë, Agamemnoni!
Mos e largo vëllanë tënd,
që s'kishe shpresë ta shohësh kurrë!

Ifigjenia

Ti, vëllaj im? Ç'ësht' kjo? Mbyll gojën.
Emri i tij dëgjohet sot
në Nauplia edhe në Argos.

Oresti

Vajzë, e mjerë!
Po yt vëlla nuk është aty.

Ifigjenia

Ti Tindaridën nga Lakonia
e pate mënë?

Oresti

Po, dhe im atë djali i djalit
t'Pelopit është

Ifigjenia

Ç'thua?
Po për këto ke ndonjë provë?

Oresti

Kam; ja, po deshe, pyet diçka
për më shtëpi të atit tim.

Ifigjenia

Më mir' fol ti; un' do dëgjoj.

Oresti

Do them, së pari,
se ç'kam dëgjuar, ç'di prej Elektrës.
Di gjë për grindjen që dikur lindi
midis Atreut edhe Tiestit?

Ifigjenia

E di, për qengjin e artë lindi.

Oresti

Po a e mban mend se ti këto
i ke qëndisur mbi një pëlhumë
të endur bukur?

Ifigjenia

Vëlla i shtrenjtë! Sa fare afër,
mendimit tim e kthen koçinë (1)!

1) Shprehja është marrë nga lëvizjet e manevrat që bëhen gjatë garave me kuaj dhe me koçi. Do të thotë: Ti erdhe shumë afër mendimit tim, mendimi yt është si imi, mendimet tona bashko-hen.

Oresti

Po pasqyrimin përmbi pëljurë
të daljes s'diellit nga udh' e tij (1)?

Ifigjenia

Dhe kët'e enda me penj të hollë.

Oresti

S'more nga nëna për n'Aulidë
ujë për banjën? (2)

Ifigjenia

Po, e mbaj mend, ish dasm' e fisme.

Oresti

Dhe nënës sate a s'i dërgove
flokët e tu? (3)

- 1) Siç u shënuat edhe më sipër, dalja e diellit prej rrugës së tij të zakonshme qe bërë për të treguar se Zeusi i njihet Atreut qengjin e artë, pra, edhe froni. Prandaj vajzave të shtëpisë s'Atreut u pëlgente të pikturoni mi pëljurë këtë episod.
- 2) Kur nisej nusja për në shtëpi të dhëndrit, e ëma i jepte ujë nga kroi i vendit për t'u larë në ditën e martesës.
- 3) Ifigjenia, para se të vdiste, i dërgoi s'ëmës një tufë nga flokët e saj, që t'i kishte kjo si kujtim e t'i vinte në kenotafin në vend të trupit të së bijës.

Ifigjenia

Po: që t'i vinte ata në varr
si një kujtim në vend të trupit.

Oresti

E sa për shenjat q'i pashë unë
me syt' e mi, janë këto:
shtiza e vjetër q'e pat Pelopi
dhe q'është ruajtur në shtëpi t'atit,
shtiza q'e tundte ai në duar,
kur, për të marrë Hipodamenë
vajzën nga Pisa, vrau Enomaun,
ësht'fshehur brenda në atë dhomë
ku rrije ti, kur ishe çupë (1).

Ifigjenia

Vëlla i shtrenjtë! — s'kam si them ndryshe —
Më je m'i dashur nga çdo gjë tjetër.
Të mbaj, Orest, të kam në krahët!
Nga toka jonë, nga Argosi erdhe,
o shpirti im!

Oresti

Dhe unë, motër, të zë për qafe,
ty që të quan bota të vdekur!

1) Sipas mitologjisë, Pelopi, si fitoi në garat me koçi, e mundi Enomaun dhe, pasi, e vrau mori për grua të bijën Hipodamenë. Shtiza me të cilën e vrau Enomaun Pelopi, ruhej me kujdes në dhomat e grave të pallatit mbretëror, mbasi ky vend ishte më i sigurt.

Lot, ngashërime të dy na mbytin,
lot që na sjell gëzimi ynë.

Ifigjenia

Të vogël fare, foshnjë, të lashë
në shtëpi t'atit: edhe në krahët
n'gji të mëndeshës. Sa lumturi,
o shpirti im! S'thuhet me fjalë.
Vërtet ç'të them? Një mrekulli
ësht' kjo që ndodhi; ta shfaq s'gjej fjalë.

Oresti

Paskëtaj qofshim të dy të lumtur!

Ifigjenia

Gëzim të madh ndjej, moj mikesha;
dridhem se mos m'ikë nga duart,
e mos në erë më fluturojë.
Pra, o vatra e ciklopve,
o atdhe, Miken' e dashur!
Nga zemra të falnderoj
se ti linde, ti e rrite
këtë tim vëlla këtu,
q'është drita e shtëpisë.

Oresti

Si fis, o motër, jemi të lumtur,
po jetë jonë ësht'plot mynxyra.

Ifigjenia

E mbaj mend, ah! e mjera unë,
kur ma mbështeti në qafë shpatën
im'at' i shkretë,

Oresti

Medet! Më duket se po të shoh,
ndonse aty unë s'u ndodha.

Ifigjenia

Kur me dredhi, vëlla, më shpinin
në dhomë brenda tendës s'Akilit,
ndonse s'më priste ndonjë martesë.
Ç'rënkime, ç'lotë kish rrëth altarit!
Ç'ujë pastrues ka qen'aty!

Medet! Medet!

Oresti

Dhe un' e qava guximn'e atit.

Ifigjenia

Fat të padenjë, ah të padenjë
për një at pata; edhe më erdhën
njëra pas tjetrës fatkeqësitë,
se kështu ndoshta desh ndonjë zot.

Oresti

Sikur vëllanë ta kishe vrarë;
o vajz' e mjerë?

Ifigjenia

Medet! Ç'guxim fort i tmerruar!
Të llahtarisur punë guxova,
vëlla, të bëj! Vdekjes mizore
për pak iu shmange! Nga këto duar
do ishe therur! Po ç'fund do marrin
këto të zeza? Ç'fat do më ndihë?
Ç'mjet do të gjej që të të nxjerr
prej kësaj toke, nga ky rezik
e n'atdhe, n'Argos, të të dërgoj,
para se shpata të marrë ngjyrë
nga gjaku yt? O shpirt i mjerë!
Detyra jote është të gjesh
një rrugëdalje! Si duhet bërë?
Të shkosh me det, apo nga toka,
posa që je i shpejt' nga këmbët?
Në shkofsh nga toka, do shkosh përmes
fisesh barbare e përmes rrugësh
që nuk kalohen; rezikun, vdekjen
i ke përpara! T'ikësh nga deti,
përmes ngushticës së gurve t'kaltër
është një rrugë shumë e gjatë
për me anije. E mjera unë!
E mjera unë! Cili nga hyjtë,
kush nga mortarët, ç'gjë e papritur,
do të na hapë udhën e mbyllur
për të liruar nga të këqijat
ty edhe mua, që nga atridët
jemi të vetmiit njerëz të gjallë.

Kori

Këto çudira që nuk tregohen,
i pashë vetë, nuk i dëgjova,

Piladi

Orest, kur piqen njerëz që duhen,
hije u ka të përqafohen.
Po mjaft me lot, mjaft me rënkim.
Duhet menduar të gjejm' atë
që ka një emër fort të lavdishëm.
Them për shpëtimin, duhet të ikim
prej kësaj toke, tokë barbarësh.
Burrave t'urtë nuk u ka hije
të lenë rastet q'u dërgon fati
dhe pas dëfrimesh të tjera t'jepen

Oresti

Flet shumë mirë, se, siç më duket,
me ne dhe fati do përkujdeset;
kujdesit, zellit të një mortari
ndihma e hyjve u jep fuqi.

Ifigjenia

Asgjë s'më mban të flas, të pyes
se ç'fat ka pasur në jet' Elektra;
Se ju më jeni gjith'dashuria.

Oresti

Me kët' e lumtur bashkëjeton.

Ifigjenia

Nga ç'vend ësht ky dhe bir i kujt?

Oresti

Strofi Fokidas është i ati.

Ifigjenia

Biri i bijës s'Atreut është
dhe fisi im?

Oresti

Yt kushëri e i vetmi për mua
mik i vërtetë.

Ifigjenia

Nuk ish aherë, kur ati im
desh të më vriste?

Oresti

Jo; për një kohë Strofi Fokidas
ish pa fëmijë.

Ifigjenia

Të përshëndes, o burr' i motrës!

Oresti

Dhe shpëtimtari im, jo veç fis.

Ifigjenia

Po si guxove ti kundër nënës
të bësh një punë aq të tmerruar?

Oresti

Këto t'i lëmë; e mora hakun
e atit tonë.

Ifigjenia

Po ajo pse vrau të shoqin?

Oresti

Ato të nënës lëri mënjanë;
nuk është mirë që t'i dëgjosh.

Ifigjenia

Po hesht; po n'Argos ti tash sundon?

Oresti

Jo; Menelau sundon aty;
mua më zbuani.

Ifigjenia

Mos u lëshua vall'ungji ynë
kundër shtëpisë sonë të shkretë?

Oresti

Jo; po nga frika e Erinive
u arratisa.

Ifigjenia

Prandaj, siç thanë, ti dhe këtu
në këto brigje bën si i çmendur!

Oresti

S'ësht her' e parë q'jemi të mjerë.

Ifigjenia

E mora vesh; ty, pra, hyjneshat
për shkak të nënës të kanë grahur.

Oresti

Më ven'mëgojza skuqur nga gjaku.

Ifigjenia

Po përse erdhe në këtë tokë?

Oresti

Erdha pas urdhrit të Apolonit.

Ifigjenia

Për ç'punë vallë? E thuá dot
apo s'e thua?

Oresti

Do ta them; mbasi prej këtij urdhri
rrodhën për mua shumë mjerime.
Si e dënova nënën për krimin,
— të cilin s'dua as ta përmend —
ngado i ndjekur prej Erinive,
u solla, rrojta, në arrati,

gjersa Loksia (1) më urdhëroi
 të shkoj n'Athinë për t'u gjykuar,
 se kështu deshën këto hyjnesha,
 që s'guxoj emrin t'ua zë në gojë (2).
 Një gjykatore e shenjtë është
 aty n'Athinë; e themeloi
 Zeusi dikur për hyjin Ares (3)
 se ky kish lyer duart me gjak.
 Aty kur erdha, asnje nga miqtë
 në krye s'deshi të më pranonte
 si të urrejtur prej perëndive;
 pastaj disave u erdhi keq,
 edhe më morën nëpër shtëpi;
 hanim së bashku dhe që të gjithë
 në t'mjëjtën dhomë, porse për mua
 një të veçantë tryezë vunë;
 Kështu ata gjetën mënyrë
 të mos më flasin as të mos flas,
 po i veçuar itë ha, të pi.
 Ver' ata shtinin n'enë të veçtë,
 sasi e njëjtë u zbrazej t'gjithëve
 edhe në heshtje pinin, dëfrenin.
 Unë s'guxoja t'i shaja miqtë,

- 1) Loksias. — Një nga mbiemrat e Apolonit,
- 2) Erinitë ishin aq të tmerrshme, saqë njerëzia s'guxonin as emrin e tyre ta zinin në gojë.
- 3) Flet për Areopagun. Këtë gjykatore e themeloi Zeusi për të gjykuar Aresin, i cili vrau të birin e Poseidonit, Halirrotin, mbasi ky kishte dhunuar vajzën e Aresit, Alkipën.
- 4) Zakonisht nëpër gostitë hanin në një tryezë dhe pinin duke shtënë verë në enët e tyre, prej të njëjtit crater (qyp). Vrasësi s'kishte të drejtë të fliste, para se të Castrohej sipas rregullave të caktuara.

porse në heshtje vuaja dhe bëja
sikur s'kuptoja: rënkoja thellë
se vrava nënën. Dhe në Athinë,
siç po dëgjoj, mjerimi im
ka qenë shkak që të caktohet
fest' e veçantë si për kujtim
dhe ky zakon është akoma:
në këtë festë gjindj'e Paladës
nderojnë enën që mban një hus (1)
Kur, pra, arriva në breg të Aresit, (2)
filloi gjyqi; unë qëndrova
në njërin fron, në tjetrin ndenji
ajo m'e madhja nga Erinit (3).
Dëgjova ç'thanë për gjakn' e nënës;
un' u përgjigja; aherë Febi
doli dëshmonjës e më shpëtoi;
Palada votat i numëroi:
dolën të njëjtë. Kështu fitova,
edhe m'u hoq akuz' e vrasjes.
Gjith'Erinitë që iu bindën
vendimit, ndenjën edhe pranuan
të kenë tempull pranë gjykatës.
Po pala tjetër që s'i u bind ligjit,
çdo çast më ndoqi gjersa prap'erdha
te truall' i shenjtë i Apolonit.
Këtu u shtriva para altarit

1) Në ditën e dytë të festës «Anthesteria» shtrohej një drekë apostafat për popullin e Athinës. Në këtë drekë çdo qytetari i jepej në enë të veçantë nga një hus (hoos-hous), verë, d.m.th. nga 3,25 litra.

2) Areopagu.

3) Në gjykatoren «Areopagu» ishin dy gurë në trajtë froni. Në njërin rrinte paditësi dhe në tjetrin i padituri.

dhe u betova tē mos ha gjë,
tē vdes urie, po qe se Febi,
i cili jetën ma shkatërrroi,
s'do më shpëtonte. Aherë Febi
që nga tripodi i artë foli
dhe më dërgoi këtu tē marr
atë statujë që ra nga qielli
dhe në Athinë atë ta shpie,
Ndihmomë, pra, tē gjej shpëtimin,
që hyji mua ma ka premtuar.
Po qe se marrim këtë statujë
dhe çmenduria ime mbaron,
dhe ty me anë barke tē shpejtë
do tē tē shpie prap në Mikenë.
Ti, o e dashur, o shpirt i shtrenjtë,
shpëto shtëpinë e atit tonë,
shpëto dhe mua; se po s'e morëm
këtë statujë që ra nga qielli,
mbaruam tē gjithë: si unë vetë,
si pelopidët.

Kori

Një zemërim fort i tmerruar
i perëndive mbi tē Tantalit
fisin u turr dhe e bën t'eoë
përmes mynxyrash.

Ifigjenia

Edhe pa ardhur ti, or vëlla,
pata dëshirë tē vij në Argos,
dhe tē tē shoh. Dhe unë dua,

ashtu sikundër do edhe ti,
të tē liroj nga tē këqijat
dhe, pa i mbajtur mëri atij
që më flijoi, tē nGRE sërish
shtëpin' atrore tē shkatërruar.
Kështu aherë dhe duart e mia
nuk do t'i lyej me gjakun tënd,
edhe shtëpinë do ta shpëtoj.
Veç kjo më tremb: si do gënjej
unë hyjneshën dhe mbretn' e vendit,
kur do tē shohë se përmbi bazën
e gurtë s'është, s'qëndron statuja?
Nuk do më vrasë? E çfar' t'i them?
Në mund t'i bësh tē dyja bashkë;
edhe statujën t'marrësh me vete,
dhe tē më shpriesh mua n'anjen
shumë tē bukur, do ish vërtet
një pun'e mirë; përndryshe unë
— në mos u bëfshin tē dyja bashkë —
do vdes patjetër, përkundra, ti,
si t'rregullosh punët e tua,
mund tē shpëtosh, tē kthesh n'atdhe.
Po s'do ngurroj tē tē shpëtoj
dhe me rrezik tē jetës sime,
po qe nevoja: vdekja e burrit
ësht'për familjet gjë për tē qarë;
e sa për gruan, kjo s'vlen asgjë.

Oresti

Po unë, vrasës i nënës sime,
s'bëhem dot vrasës edhe i motrës;
boll gjak' i saj; mendim tē njëjtë

me ty kam unë, bashkë të rrojmë
apo të vdesim. Do të të shpie
— në iksha dhe un'prej këtij vendi —
n'atdheun tonë, ja do të rri
e do të vdes me ty këtu.
Tani dëgjo mendimin tim;
Në qoftë se kjo (1) Artemidës
s'do t'i pëlqente, si mua divnesa
e Apolonit do m'urdhëronte
ta marr statujën e perëndeshës,
ta shpie këtë gjer në 'Athinë.
edhe fytyrën tënde ta shoh?
Kur, pra, i lidh tërë këto,
kam shpresë që n'atdhe të kthehem.

Ifigjenia

Si mund të bëjmë q'edhe nga vdekja
ne të shpëtojmë, edhe të marrim
atë që duam? Kjo na pengon
n'atdhe të vemi; s'mungon dëshira.

Oresti

A ësht' e mundur të vrashim mbretin?

Ifigjeni

Ne, njerëz t'ardhur, të vrashim mbretin,
që na ka pritur? Fjal'e tmerruar!

1. D.m.th. rrëmbimi i statujës.

Oresti

Nëse nga kjo ne gjejm' shpëtim,
duhet guxuar.

Ifigjenia

Guximin tënd e lavdëroj,
po un'këtë nuk e bëj dot.

Oresti

S'mund të më fshehësh në këtë tempull?

Ifigjenia

Pse? Që ta marrim dhe n'errësirë
të dalim jashtë e të shpëtojmë?

Oresti

Po; sepse vjedhjet natën e duan,
kurs'e vërteta e kërkon ditën.

Ifigjenia

Brenda ka ruajtës; nuk do na shohin?

Oresti

Medet, mbaruam! Si do shpëtojmë?

Ifigjenia

Gjeta, më duket, një mjet të ri.

Oresti

Cili? Ma thuaj, që ta mësoj.

Ifigjenia

Manrosjen tënde do ta përdor
si shkak të rremë.

Oresti

E zonja është femra të shpikë
dinakëri.

Ifigjenia

Do them që ti erdhe nga Argosi,
si vrave nënën.

Oresti

Përdori, pra, vuajtjet e mia,
mjaft që prej tyre të përfitojmë.

Ifigjenia

Do them që s'mund të të flijoj
n'altar t'hyjneshës.

Oresti

E ç'shkak do vesh? Diç po kuptoj.

Ifigjenia

Që s'je i pastër, q'unë flijoj
vetëm të pastrit.

Oresti

Kështu më lehtë merret statuja?

Ifigjenia

Do të kërkoj që të pastrohesh
n'ujët e detit.

Oresti

Por prap në tempull mbetet statuja,
për it'cilën erdhëm deri këtu.

Ifigjenia

Do them të lahet edhe statuja,
mbasi e preke.

Oresti

Në ç'vend të detit the që ta shpiem?

Ifigjenia

Në atë vend ku me litarë
të linte është ngulur anija.

Oresti

Kush do ta mbajë në duar statujën?
Ti a të tjerë?

Ifigjenia

Un'; se veç un' ta prek kam leje.

Oresti

Piladi ç'punë do tē na bëjë?

Ifigienia

Do them se ёсhtë, si ти, пëрlyver.

Oresti.

Mbreti do dijë c'do bësh, a jo?

Ifigienia

Kam për ta bindur; nuk fshihem dot:

Oresti

Eshtë gati barka edhe rremtarët.

Ifigienia

Sa për të tjerat, ti vetë duhet
të përkujdesesh, që t'ecin mbarë.

Oresti

Ifigjenia

Shoqe të shtrenjta! Shpresat tani
i kam në ju: se nga ju varet
të jem e lumtur ose fatkeqe;
në dorën tuaj është të shoh
a të mos shoh atdheun tim,
vëllam' e dashur, motrën e shtrenjtë.
Ne jemi gra — kështu do nis
dhe gratë, shoqe, dashuri kanë
në mes të tyre dhe zotësi
të mbrojnë mirë çdo gjë q'ato
kan' të përbashkët, Ju lutem, heshtni,
ndihnnani t'ikim; me të vërtetë,
gjuha besnikë ësht" gjë e bukur
shihni që tre veta të dashur
një fat i pret: ose të kthehen
n'atdhe të tyre, ose të vdesin.
Po të shpëtoj, do kesh dhe ti (1)
të njëjtin fat: gjall' do të shpie
dhe ty n'Heladë. Ju lutem, pra,
për dorën tënde të djathët, ty,
e ty përfaqen, për gjunjët ty,
për çdo të dashur që keni lënë
nëpër shtëpitë, për nën'e babë
dhe përfëmijët që mund të keni.
E ç'thoni pra? Kush është pro?
Kush është kundër? Flisni, ju lutem;
po që se lutjen time s'dëgjoni,
mbaruam unë, vëllaj i shkretë.

1) Shpesh personazhet, kur flasin me korin, i drejtohen me «ti», sepse bashkëbisedimin e bënin me korifeun (prijesin e korit).

Kori

E qetë rri, zonjë e dashur;
 ti vetëm shih si të shpëtosh;
 unë s'do them asgjë nga gjërat
 që m'urdhëron t'i mbaj të fshehta;
 Zeusi i madh qoftë dëshmonjës!

Ifigjenia

Ju falemnderit për këto fjalë
 dhe lumturi paçi në jetë!

(Orestit e Piladit)

Tani të dy hyni në tempull;
 se për së shpejti do vijë mbreti
 i këtij vendi për të shikuar
 në jan'fliuar të dy të huajt.

(Oresti e Piladi hyjnë në tempull)

O perëndeshë fort e nderuar! (1)
 Ti në luginat e Aulidës
 më ke shpëtuar nga dora vrasëse
 e atit tim; ti dhe tani
 shpëtomë mua, shpëto këta.
 Ndryshe mortarët s'do kenë më
 besim n'orakujt e Apolonit.
 Dëgjo të dalësh prej këtij vendi,
 vendi barbar; eja n'Athinë;
 nuk të ka hije të rrish këtu,
 kurse të pret qytet i lumtur

(Ifigjenia hyn në tempull).

1) D.m.th., Artemida.

SKENA E DYTË

Kori

Strofa I

Alkion, (1) o zog që rri
mbi shkëmbinjt e oqeanit
dhe këndon pa e pushuar
elegjinë vajtimtare,
që i thot'atij që di
se këndon ti për tët shqo,
or e çast për të vajton.
Edhe unë qaj si ti,
edhe unë, zog pa pendë,
përgjeroj për ato mbledhje,
ato festa helenike;
për hyjneshën Artemidë,
që i mbron lindjet e grave
dhe banon në malin Kint (2)
dhe për palmën fletë — butë,
për dafinën e harlisur
dhe për gjethet bojëqielli
të ullirit, drurit shenjtë,
që ka qenë për Latonën (3),
gjatë lindjes lehtësim.
për liqenin rrumbullak,
ku dhe mijellma këngëtarë
u bën Muzave shërbim.

1) Sipas mitologjisë, Alkiona, bija e Eolit dhe e Egiales, kur pa se
i shoqi, Keiku, ra në det dhe u transformua në pulëbardhë, u hodh
dhe ajo në det. Aherë Teti u mallëngjye nga dashuria e madhe
që pat Alkiona për të shoqin dhe e transformoi në shpendin e quajtur
Alkione.

2) Mali i ishullit Delos ku u lindën Apoloni dhe Artemida.

3) Latone ose Leto ka qenë nëna e Apolonit dhe e Artemidës: i lindi
me Zeusin.

Antistrofa I

Mu si breshërt lotët ranë
edhe faqet m'i imbuluan,
kur kështjellat u dërrmuani,
kur më shpunë në anijet
e armikut dhe më vunë
midis shtizash e lopatash;
kur më shitën e më blenë
me sasi të madhe ari
dhe më sollën në këtë
vend të egër dhe barbar,
ku më vunë t'i shërbej
bijës së Agamemnonit,
priftëreshës së asaj
perëndeshe sutëvrasëse,
t'u shërbej edhe altarëve,
ku viktimat s'janë qengja.
Ja, zili i kam atij
që kaloi gjithë jetën
me mynxyra, me mjerime!
Kush u nrit më vështirësi,
i duron hallet e jetës,
dhe sikur ai të ndrrojë
një mynxyrë me një tjetër,
po për njerëzit që bien
më mjerim nga lumturia,
jeta ështëvërtet e rëndë.

Strofa I

Ty, o zonjë e nderuar,
një anije bash argive
me lopata pesëdhjetë

1) Kori, me një farë smire përfytyron kthimin e Ifigjenisë në atdhe. E përcjellin dy hyj: Pani, perëndia e barinje dhe e maleve, e sho-qëron anijen duke i rënë fyellit (Zamares), dhe Apoloni — mbrojtësi i Orestit dhe shkaktari i kësaj ndërmarrjeje — rregullon lëvizjen e lopatave me tingujt e lyrës (Kitarës).

në atdhe do të të shpjerë.
Edhe fyelli i Panit,
hyjit që sundon në malet,
do t'i nxitë fort rremtarët,
Gjithashtu dhe Feb faltari;
duk' i rënë lirës tij,
lirës tij me shtat tela,
do t'të shpjer' duke kënduar
mir' e bukur në Athinë,
që i ka tokat pjellore.
Dhe këtu duke më lënë,
ti do shkosh e shoqëruar
prej lopatave plot zhurmë;
dhe konopet do të ndehin,
të ndihmuara prej erës,
velat e anijes shpejtë,
përmbi kicin, mbi bompresin;

Antistrofa II

Ah! sikur të mundja
të shkoja përmes
sheshit që shkëlqen
nga djell i ndritur!
Sikur të arrija
mbi shtëpinë time
me krahët e shpejta
që i kam mbi supet!
Ah! sikur të mundja
t'ia dridhja valles,
si ahere kur
isha virgjëreshë
dhe gati më bënin
t'më jepnin për burrë
një të ri fisnik!
Qëndroja aherë

pran' këmbve të nënës;
pastaj menjëherë
ngrihesha më këmbë,
përreth hiqja vallen
e grupit të shoqeve,
bashkëmoshatare;
duke mbuluar
fytyrën me cergë
fort të zbuluar
edhe me gërshtat,
vrapoja te shoqet,
haheshim të gjitha
kush i kishte leshrat
më të zbuluarara.

A K T I IV

SKENA E PARE

(*Kori — Ifigjenia — Toanti*)

Toanti (1)

Ku është roja e këtij tempulli,
gruaja greke? I bëri fli
ata të huajt? A digjen trupat
n'altar të shenjtë?

Kori

(*Ifigjenia del nga tempulli, duke mbajtur në
duart statujën e Artemidës*)

Ja, ajo është; kjo, mbret, të gjitha
do të t'i thotë.

1) Toanti (Thoas) ishte mbreti i Tauridës.

Toanti

Ti, bijë e Agamemnonit,
pse mban në duar këtë statujë
të perëndeshës? Përse e hoq
nga piedestali i palëvizshëm?

Ifigjenia

O mbret, mos çap përtej portikut.

Toanti

C'gjë të re ka brenda në tempull?

Ifigjenia

Pështyva; ndjemë; detyr' e shenjtë
më detyron të bëj kështu, (1)

Toanti

C'të re pra ka? Folë më qartë.

Ifigjenia

Fli të papastrat, o mbret, më sollët,

Toanti

Kush ta ka thënë? Apo e nxjerr
nga mendja jote?

1) Të vjetrit, kur ishte puna për ndonjë gjë të keqe, pështynin osc
thoshin fjalën «pështyva» (apeptysa); këtë e bënин për të larguar,
siç besonin, ndonjë ugur të keq.

Ifigjenia

Fytyrën prapa ktheu statuja.

Toanti

Vetiu apo ndonjë tërmët?

Ifigjenia

Vetiu u kthye; mbylli dhe sytë

Toanti

Po përse vallë? Mos pse urren
njërit e huaj?

Ifigjenia

Po; se këta krim kanë bërë.

Toanti

Mos buzë detit vranë këta
ndonjë barbar?

Ifigjenia

Erdhën të lyer; se kanë vrarë
njeri të tyre.

Toanti

Kë? Skam durim sa ta mësoj.

Ifigjenia

Nënë me shpatë bashkë e vranë.

Toanti

O Apolon!
Asnjë barbar nuk do ta bënte.

Ifigjenia

I ndoqn', i zbuan nga gjith' Helada,

Toanti

E prandaj jashtë e nxjerr statujën?

Ifigjenia

N'ajër të pastër, që të mos ndyhet.

Toanti

Si e more vesh q'janë përlyer
të dy të huajt?

Ifigjenia

Sapo statuja e perëndeshës
ktheu fytyrën, bëra hetime.

Toanti

Mir'e kuptove, Greqia ty
të paska rritur shumë të ditur.

Ifigjenia

Po sot më ngjallën një joshë t'embël
në zemrën time.

Toanti

Lajme të mira të suall ng'Argosi?

Ifigjenia

Më lajmëruan q'Oresti im,
vëllai i vetëm, jeton i lumtur.

Toanti

Shpresuan imbase se ti nga gazi
do t'i shpëtosh.

Ifigjenia

Më thanë që edhe im atë
rron edhe jeton me lumturi.

Toanti

Ti mbajte anën e perëndeshës;
e me të drejtë.

Ifigjenia

Po; se urrej gjithë Greqinë,
mbasi ajo ma bëri varrin.

Toanti

Ç'të bëjmë, pra, pér t'huajt? Fol.

Ifigjenia

Të respektojmë ligjin që kemi.

Toanti

A i ke gati ujët dhe shpatën?

Ifigjenia

T'i laj më parë me uj' pastrues.

Toanti

Me ujë deti, apo burimi? (1).

Ifigjenia

Deti pastron tërë të ligat
e vdekëtarëve.

Toanti

Kështu hyjneshës do t'i pëlqejë
flija më shumë.

Ifigjenia

Dhe puna ime do shkojë mbarë.

Toanti

Ujët e detit a nuk arrin
gjer te faltorja?

1) Besonin se ujët e detit kishte fuqi të pastronte dhe të shëronte.

Ifigjenia

Mua më duhet vend i veçuar;
se ca të tjera rite do bëjmë.

Toanti

Shko ku të duash; gjërat që s'thuhen,
s'dua t'i shoh.

Ifigjenia

Duhet pastruar edhe statuja
e perëndeshës.

Toanti

Po qe se është përlyer kjo
nga mëmëvrasësit.

Ifigjenia

Është përlyer; se ndryshe kurrë
nuk do ta hiqja nga piedestali.

Toanti

Është e drejtë të lavdërohesh
për shprestarin'e parashikimin;
e me të drejtë qytet'i gjithë
të admiron.

Ifigjenia

E di se ç'duhet të bëj tanë?

Toanti

Këtë ti duhet të ma tregosh.

Ifigjenia

Lidhi të huajt.

Toanti

E ku mund t'ikin?

Ifigjenia

Greqia s'di është besa.

Toanti

Ju, shërbëtorë, sillini prangat.

Ifigjenia

Dhe le t'i sjellin këtu të huajt.

Toanti

Këto do kryhen.

Ifigjenia

Kryet me pepël tua mbulojnë.

Toanti

Që të rrin'fshehur nga drit'e dielli¹⁾

1) Nuk duhej që drita e diellit të binte mbi ta para se të ishin pastruar.

Ifigjenia

Nga shpura jote më sill ca njerëz.

Toanti

Këta i ke si shoqërues.

Ifigjenia

Dhe në qytet dërgo njeri
t'i thotë gjindjes...

Toanti

Ç'tu thotë vallë?

Ifigjenia

Të rrinë gjithë nëpër shtëpitë.

Toanti

Që mos takohen me këta vrasës?

Ifigjenia

Se kush takohet me ta, përlyhet.

Toanti

Një shërbëtori)

Shko ti t'u thuash.

Ifigjenia

Të mos afrohet kush për t'i parë.

Toanti

Ti për qytetin mir'u kujdeske

Ifigjenia

Dhe për ata që fort i dua.

Toanti

Këtë patjetër e the për mua.

Ifigjenia

Ti, duke ndenjur pranë faltore...

Toanti

Ç'punë të bëj?

Ifigjenia

pastro godinën me një vravashkë.

Toanti

Që, kur të kthehesh, ta gjesh të pastër?

Ifigjenia

Kur do të dalin jashtë të huajt...

Toanti

Ç'duhet të bëj?

Ifigjenia

...duhet t'i zësh sytë me pepël.

Toanti

Që t'mos përlyhem?

Ifigjenia

Po të shikosh se vonoj shumë...

Toanti

Sa ësht'afati?

Ifigjenia

...mos u habit.

Toanti

Ato t'hyjneshës bëji me nge
edhe si duhet.

Ifigjenia

Daltë pastrimi ashtu si dua!

Toanti

Uroj dhe unë.

Ifigjenia

Shoh se të huajt dalin prej tempullit;
shoh dhe stolitë e perëndeshës:

qengja të vegjël të lindur rishtas,
për t'u pastruar gjaku me gjak,
vrvashka plot drit'e shkëlqim,
edhe të tjerat, që porosita,
për të pastruar t'huajt, hyjneshën.
Po qytetarët i porosit
të rrinë larg kësaj përdhosjeje
rojtar' i tempujve që ka detyrë
t'u shërbej' hyjnive me duar t'pastra;
ose ai që vjen në tempull
për të festuar aty martesën;
ose një grua q'është me barrë;
këta të gjithë le t'i kin larg,
që të mos lyhen nga kjo përdhosje.
O virgjëreshë, bijë e Zeusit
dhe e Latonës! Në i pastrofsha
këta nga gjaku dhe të bëj fli
për ty ku duhet, ti do të rrish
n'tempull të dilitë e ne do jemi
njerez të lumtur. S'i them të tjerat;
por për hyjnité, që dinë gjithçka,
si dhe për ty, o perëndeshë,
u shpreha qartë.

(*Dalin të gjithë përvëç korit*).

SKENA E DYTE

Kori

Strofa

I shkëlqyer është djali,
që dikur Latona leu
në luginat fort pjellore,

pemëprurëse të Delit,
 perëndia flokartë,
 kitaristi i dëgjuar
 dhe arktari i përsosur.
 Perëndesha, mën' e tij,
 duke lën' ato bregore,
 t'ishullit ku leu birin,
 atë vend plot me lavdi,
 e ka sjellë mu në majën
 ujëshumë të Parnasit (1)
 dhe të dehur nga kremitmet
 krejt zhurmë të Dionizit,
 ku dragoi kuqërrrem (2)
 dhe me shpinën vija-vija,
 i mbuluar prej dafine
 të bleruar dhe me hije,
 ky përbindsh i madh' i tokës,
 ruante tempullin e vendit.
 Ndonse edhe foshnjë ishe,
 ndonëse në krahët edhe
 hidheshe të nënës dashur,
 kët' përbindësh, o Feb, vrave,
 dhe kështu u bëre zot
 i orakullit të shenjtë.
 Paskëtaj ti, duke ndenjur
 mbi tripodin e florinjtë
 dhe mbi froni që s'gënjen,
 vdekëtarëve të ardhmen

- 1) Do të thotë për kroin Kastalia dhe për lumin e vogël Plistos.
- 2) Është fjala për draguan Piton, rojtarin në Delfi, që, sipas mitologjisë, leu nga toka, e cila u kalb pas përmbyssjes që ndodhi në kohën e Deukalionit Pitonin e vrou. Apoloni, i cili prandaj mori edhe mbiemrin «Pitios».

Antistrofa

ua thua nga altari
pranë kroit Kastali
brenda në banesën tënde,
q'është mu në mes të tokës.
Po kur erdh aty i biri
i Latonës dhe dëboi
nga orakulli i shenjtë
Temidën, bijën e Tokës,
kjo ka lindur hije èndërrash,
që në gjumë gjatë natës
shumë njerëzve u thoshin
ç' ka ngjarë, ç'do t'u ngjasë.
Toka, për të marrë hakun
e së bijës së lënduar,
ia heq Febit të drejtën
që të thotë profecira.
Po me vrap aherë hyu
në Olimp menjëherë shkoi
edhe drejt fronit të Zeusit
zgjati dorën djaloshare
duk' u lutur të largonte
që nga tempulli Pitik (1)
zemërimin e hyjneshës
edhe zhurmat që dëgjonin
njerëzia gjatë natës?
Zeusi ja krisi gazit,
duke parë që i biri
kult i lypte fitimprurës;
shkundi flokët dhe i preu
zhurmat që lëshonte nata
dhe mortarët i shpëtoi

1) Tempull Pitik quhej tempulli i Apolonit në Delfi. Edhe Homeri e quan Delfin me emrin Pitë.

prej orakujve të natës:
Apolonit i dha prapë
ato ndere që kish pasur
dhe ndaj fjalëve hyjnore.
një besim të madh u ngjalli
njerezve që vinin dendur
rrotull fronit të dëgjuar.

SKENA E TRETE

(*Kori — Toanti — Lajmëtari*)
(*Hyn me vrap një lajmëtar*)

Lajmëtari

O ju rojtarë të këtij tempulli
dhe ju që keni kujdes altarët
ku vajti vallë Toanti, mbreti
i këtij vendi? Çeleni shpejt
portën e mbyllur me reze fort!
Thirreni mbretin të dalë jashtë!

Kori

Ç'është, në mund të flas pa u pyetur?

Lajmëtari

Ikën e vanë të dy të rintjet;
i thuri bij' e Agamemnonit
planet dinake; shkuan me vrap
prej kësaj toke; edhe statujën
e perëndeshës morën me vete,
në një anije greke e vunë.

Kori

Po na sjell lajme tē pabesuara;
mbreti i vendit që ti kërkon
doli nga tempulli.

Lajmëtari

E ku ka vajtur? Duhet ai
tē dijë ç'ngjet.

Kori

Ne nuk e dimë; porse ti ecë,
vrapo pas tij dhe, si ta gjesh,
thuaja fjalët që po na thua.

Lajmëtari

Shihni se sa ësht' e pabesë
skota e gruas! Edhe ju keni
gisht në këto.

Kori

Mos u marrose? ç'faj kemi ne
se ikën t'huaqt? A s'shkon me vrap
në dyert e mbretit?

Lajmëtari

S'löz pa më thënë ndonjë faltar
në është brenda a jashtë mbreti
i këtij vendi. (*I bie portës*). Hapeni portën!
Juve ju flas që jeni brenda;

lajmoni mbretin se jam te porta
edhe sjell barrë lajmesh të liga.

(*Toanti del nga tempulli*).

Toanti

Kush po bërtet pranë faltorës
së perëndeshës? Kush i bie portës
dhe mbush me zhurmë tempullin brenda?

Lajmëtari

Këto më rrejtën; patën qëllim
të më largonin nga kjo faltore;
prandaj më thanë që ishe jashtë,
kurse ti genke brenda në tempull.

Toanti

Ç'kanë shpresuar? A ç'qëllim patën?

Lajmëtari

Të them më vonë, tani dëgjo
këto që janë me rëndësi:
Ifigjenia, vajza që muante
këto altare, që këtej iku
bashkë me t'huajt; mori me vete
edhe statujën font të nderuar
të perëndeshës; pastrimet s'ishim
jo, asgjë tjetër, veçse dredhi.

Toanti

Ç'thua? Po ç'gjë e shtyu kështu?

Lajmëtari

Ti do çuditesh: ajo Orestin do të shpëtojë.

Toanti

Cilin?

Atë që lindi bij' e Tindarit?

Lajmëtari

Atë q'hyjneshia ia kushtoi
këtij altari.

Toanti

Çudi! A si ta quaj më mirë?

Lajmëtari

Ti për këto mos e vraj mendjen,
porse dëgjomë; si t'i këqyrësh
qartazi punët, të japësh urdhër
t'i ndjekin t'huajt edhe t'i zënë.

Toanti

Mirë më thua; folë, sepse
udha që kanë për të kaluar
s'ësht' aq e shkurtër, sa t'u shpëtojnë
armëve t'mia.

Lajmëtari

Pasi në buzë të detit erdhëm,
ku kishte fshehur anijen Oresti,
menjëherë bij' e Agamemnonit

ma bëri shenjë (1) që të lëshonim
prangat e t'huajve, të cilët ne
na porosite t'i shoqërojmë —
mbasi ajo do bënte gjoja
flin' e mistershme të të pastruarit.
Pastaj ajo me duart e saj
i mori prangat dhe pas u vinte
djemve të huaj. Në dyshim ne
këto na futën, po si shërbyes
të tu, o mbret, asaj iu bindëm.
Pas ca ajo, që të besonim
se gjoja bënte diçka të madhe,
fort ulëriti edhe këndoi
këngë barbare, këngë magjike,
për të treguar se po e lante,
po e pastronte gjakun, përdhosjen.
Po pasi shkoi një koh' e gjatë,
na hyri frika, se mos e vrishnë
vajzën të huajt, — mbasi nga prangat
ishin liruar — dhe iknin fshehur.
Megjithatë, rrnim pa folur,
se kishim frikë mos shihnim gjëra
jo për t'u parë. Po, më në fund,
të gjithë thamë të njëjtën fjalë
të shkonim, ndonse nuk kishim leje,
ku ata ishin. Këtu po shohim
anijen greke; rremat e saj
ishin si pendë dhe pesëdhjetë
detarë mbanin ato në duart:
nga an' e kicët rrinin të zgjidhur

1) Në raste ceremonirash fetare kërkohet nga të pranishmit heshtje e plotë. Prandaj këtu Ifigjenia i porosit me shenja.

tē dy tē rintjtē. Ca nga detarët
 e mbanin bashin me anē trarësh,
 disa tē tjerë varnin spirancēn,
 ca pallamarët e pupës mblidhmin,
 një palë tjetër shpejt merrnin shkallët
 dhe i lëshonin nē det pér t'huajt.
 Po ne, kur pamë këto manevra
 plot me dredhi, lamë mënjanë
 çdo farë duajtjeje. dhe me vrap rendëm
 tē zinim vajzën dhe pallamarët,
 t'nxirrnim nga vrima ku ish fiksuar,
 timonin e barkës me bash tē bukur. (1)
 Këmbyem fjalë: «Ju me ç'të drejtë
 kërkoni t'ikni prej kësaj toke,
 duke grabitur statujën bashkë
 me priftëreshën? Kush je ti vallë
 dhe bir i kujt, që na rrëmben
 vajzën këtej nga toka jonë,
 me një dredhi? «Ai aherë
 ja se ç'na tha: «Në daç tē dish,
 un' jam Oresti, vëllai i vajzës
 dhe biri i Agamemnonit;
 po marr me vete un' time motër,
 që kisha humbur larg prej atdheut.
 Megjithatë, nuk e lëshonim
 vajzën e huaj dhe e shtrëngonim
 tē vinte bashkë me ne te ti,
 Kjo na shtrëngoi tē dyja palët

1) Tuarët mundohen tē marrin pallamarët, me anën e tē cilëve ani-
 ja mbahej nē buzë tē detit. Siç kuptohet, këto pallamarë i kishin
 zgjidhur grekët, po akoma s'i kishin mbledhur brenda nē anijen.
 Përvëç këtyre përpiken tē shkëputin edhe timonin, duke e nxjerrë
 këtë nga vrima e fiksimit.

t'i biem njëri-tjetrit në faqet;
se as ata, as edhe ne
nuk kishim armë, pra krisi grushti;
dhe dy të rintjtë njëkohësisht
me shkelma zunë të na qëllonin
aq fort në brinjë e në mëlçi,
saqë përleshja posa filloi,
shpejt trupat tanë u rraskapitën:
Të mbushur me plagë të tmerrshme,
ikën te shkëmbi të përgjakosur
e të plagosur, disa në kokë
disa në sy; kur, më në fund,
erdhëm te shkëmbi dhe zumë vend,
vazhduam luftën, zumë të hidhnik
gurë mbi ta, po kësaj here
me një kujdes pak më të madh.
Po shigjetarët, q'ishin mbi pupë,
shtinin mbi ne dhe me shigjetat
fort na pengonin, kështu që ne
u zhytëm prapa. Po n'atë çast
val' e tmerruar hodhi anijen
afër steresë; dhe meqë vajza
kish frikë mos lagej nga këmbët
Oresti shpejt e zu, e ngriti
mbi supn' e majtë, hyri në ujët,
hipi në shkallë dhe në anijen
e zbukuruar vuri të motrën
si dhe atë që ra nga qielli,
atë statujën e bijës Zeusit.
Një zë i fortë doli aherë
nga mes' i barkës: «Ju, lundërtarë,
t'anijes greke! Merrni lopatat,
zbardhni tallazet! Në dor' e shtimë
bash atë gjë që na shtrëngoi

të hyjnim në port jomikpritës,
pasi kaluam rrugën e ngushtë
të Simplegadëve». Ata lëshuan
britmë gëzimi dhe me lopatat
i ranë detit. Gjersa anija
ish brenda portit, shkonte përpara;
po si kaloi grykën e portit,
ra mbi një valë fort të rrëmbyer
dhe po lëkundej, se er' e fortë
që fryu befas, me forc' anijen
e shtynte prapa; ata qëndronin;
më kot; se vala në stere prapë
shpinte anijen. Aherë bija
e Agamemonit u ngrit në këmbë
dhe zu të falej: «Bij' e Latonës,
mua, priftëreshën tënde, shpëto!
Ndihmë nga kjo tokë barbare
t'ik e të kthehem n'Elladën time!
Falmë pér vjedhjen! Ti, perëndeshë,
e do vëllanë; dëgjo: dhe unë'
e dua timin» Detarët lutjes
së virgjëreshës iu përgjigjën
duke kënduar këngën pean;
pastaj, pas urdhrit, përveshën mëngët
deri te supi; morën lopatat;
mirëpo barka, sa vinte, shkëmbit
po i afrohej, disa prej nesh
aher' u hodhën brenda në det,
kurse të tjerë po ngrinin leqe.
O mbret, un' erdha këtu te ti,
që të të them ç'ngjau aty.
Po ti vrapo dhe merr në duart
pranga e leqe; se po s'pushoi
era në det, shpresë shpëtimi

s'ka për të huajt. Dhe Posejdoni,
hy' i nderuar dhe mbret i detit
e mbron Iljonin, ësht' kundërshtar
i Pelopidve; edhe tan
ai, si duket, do t'jua japë
në dorë ty dhe qytetarëve
të birim e Agamemnonit
edhe të motrën, q'harrroi shpatën
e Aulidës dhe perëndeshën

e tradhëtoi.

Kori

O moj e mjerë Ifigjeni,
me tët vëlla sërish do biesh
në duart e mbretit e do të vdesësh.

Toanti

Të gjithë ju, o qytetarë
të kësaj toke, barbare,
a nuk u vini kuajve frenat
e të vraponi mu në bregdet,
ku do të mblidhni ju mbeturinat
e anijes greke? Ecni, pra, shpejt!
Hyjnesha vetë do t'ju ndihmojë
t'i zini burrat e ligj pa shpirt.
Disa të tjerë në det lëshoni
barkat e shpejta, që t'i shtiem
në dor' ata, duke i ndjekur
në det e tokë. Këta prej shkëmbit
posht' do t'i hedhim, a në hu trupat
do t'ua shkojmë. Dhe ju, o gra,
që dinit planet, do t'ju dënoj,

kur të kem kohë; tani i qetë
nuk do të jem, gjersa të kem
këtë kujdes.

(*Shfaqet Atena*)

SKENA E KATËRT

(*Atena — Toanti — Kori*)

Atena

Për ku, për ku, o mbret Toant,
e bën gati këtë fushatë?
Un' jam Atena, dëgjo ç'të them;
Mos i nxit më val't e ushtrisë,
mos i ndiq t'huajt; sepse orakujt
e Apolonit e shtyn' Orestin
këtu të vijë, që të shpëtojë
nga zemërimi i Erinive,
të sjellë prapë të motrën n'Argos
edhe ta shpjerë në tokën time
statujën e shenjtë. Ja këto fjalë
kisha për ty. Sa për Orestin
që të shkon mendja ta zësh në det
edhe ta vrasësh, duhet të dish
që Posejdoni për hatrin tim
i zhduku valët nga sipërfaqja
e oqeanit; kështu anija
lundron e qetë. Ti, pra, Orest,
dëgjo ç'po them — se dhe së largu
e dëgjon zërin e perëndeshës —
merre statujën, merr edhe motrën

dhe shko përpara; kur do t'arrish
n'atë Athinën, q'është ndërtuar
prej perëndive, dije q'aty
ndodhet një vend, një vend i shenjtë
në dhe t'Atikës, mu në kufijtë
e saj të fundit, fqinjë me malin
e Karistisë (1) q'e quan «Halai» (2)
populli im (3). Në këtë vend
ndërto një tempull dhe në të brenda
vëre statujën; emri i saj
do përkujtojë tokën Taurike
dhe ato vuajtjet që ke pësuar,
Kur ti, i ndjekur prej Erinive,
silleshe nëpër gjithë Greqinë;
dhe në të ardhmen njerzit këtë
do ta himnojnë si Artemidë
Tauropole. Aty pastaj
vër këtë ligjë: kur do të mblidhet
gjindja për festën, për të shpërblyer
shpëtimin tënd, aherë prifti
shpatën t'afrojë edhe të prekë,
të prekë qafën e një njeriu,
aq sa të derdhen ca pika gjaku.
Kështu çdo gjë kryhet pas ritit,
dhe perëndesha do të nderohet.
Ifiqjeni, ti do t'i mbash
kyçet e tempullit të perëndeshës

-
- 1) Pranë qytetit Karistos në ishullin e Eubesë.
 - 2) Katund i vogël i Atikës pikërisht kundrejt Karistisë.
 - 3) Janë athinasit.

rreth shkallës shenjtë të Brauronës (1).
Këtu pas vdekjes do të varrosesh
dhe varrin tënd do ta stolisin
peple prej cohe të thurur bukur,
të lëna prej grave që vdesin
në lindj' e sipër (2). Sa për këto
gra nga Greqia (3), lëri të ikin
prej këtij vendi; e do e drejta.
Unë, Orest, dhe tjetër herë
të kam shpëtuar aherë, kur
n'Areopag i ndava votat
të barabarta; dhe ky zakon
ka për të mbetur; ai që merr
vota të njëjtë, gjyqin fiton.
Hiqe, pra, motrën prej këtij vendi
ti, djalë i Agamemnonit,
dhe ti, Toant, fort mos u nxeh.

Toanti

Hyjnesh' Atena! Kush dëgjon fjalët
e perëndive dhe nuk u bindet,
është i marrë. Un' as Orestit,
që iku duke marrë statujën
e perëndeshës, as motrës tij
s'u zemërohem: ç'fiton, vërtet,
t'hahesh me hyjt' e gjithfuqishëm?
Pra, le të shkojnë në tokën tënde

-
- 1) Braurona, një nga të dyshëmjetë qytetet që formonin konfederatën e vjetër të Atikës, ndodhej mbi një kodër përmbi portin e Halait. Perëndesha e Brauronës zinte një vend të rëndësishëm në kultin e Atenës.
 - 2) Rrobat e grave që vdisnin në lindje e sipër ia kushtonin Arthemidës perëndeshës që kujdesej për lindjet.
 - 3) I drejtohet Toantit; i flet për gratë që formonin korin e dramës.

tok me statujën e perëndeshës,
me fat të mirë aty ta vënë!
Do t'i dërgoj dhe këto gra
n'Heladë t'lumtur pas urdhrit tënd.
Do ndal ushtarët, që i kam mbledhur
kundër të huajve, si edhe flotën,
siç dëshiron ti, perëndeshë.

Atena

Flet shumë mirë; me të vërtetë
fati sundon edhe mbi ty,
edhe mbi hyjtë. Fryni, o erëra,
shtyni anijen dhe birin e
Agamemnonit shpjereni mirë
gjer në Athinë. Bashkë me të
do shkoj dhe unë, që të shpëtoj
statujën e shenjtë të motrës.


Kori

Shkoni me fat të mirë ju;
të lumtur jeni se po shpëtoni.
Palad'Atena, që të nderojnë
hyjt' e mortarët! Do bëjm' ashtu
siç urdhëron. Se lajm i ëmbël,
lajm' i papritur, na erdh më veshët.
Dhe ti, o Nike (1), fort e nderuar,
mbrofsh jetën time dhe pa pushim
më dhënç kurorën!

1) «Nike» (fitore), perëndeshë greke e fitores. Përfytyrohet me flatra, me kurorë mbi krye dhe me një degë palme në dorë. Kësaj i bëhej thirrje nga poetët dramatikë, që t'u jepte atyre kurorën e fitores nëpër konkurs letrare.

Ndreqje gabimesh

Rradha	Faqja	Si është	Si duhet të jetë
12	VII	vetëm për burrin e jo për gruan	vetëm për gruan e jo për burrin
2 nga fundi	109	si mbërritën fort e pëlqyer	si fli mbërritën fort e pëlqyer



Grimm leke 3.50